

Qeverisja e të drejtave të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptiane

Pasqyre e strukturave aktuale institucionale dhe ligjore,
për integrimin e tyre në shoqërin kosovare



SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

Hyrje

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur-KFOS, pasi që e mbështeti Qeverinë e Kosovës për të hartuar Strategjinë për Integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas, ka vazhduar të asistojë në krijimin e kushteve për realizim efikas të kësaj strategjie. KFOS vazhdon mbështetjen për këtë Strategji duke ndihmuar qeverinë në hartimin e Planit të Veprimit dhe duke bërë dy studimeve bazike për të ndihmuar veprimet konkrete: (1) Studimi “Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit në Kosovë, (RAE-t) në Kosovë”, dhe (2) “Potenciali i Administratës Kosovare për Realizimin e Strategjisë RAE”. Studimi i parë “Romët, Ashkalit dhe Egjiptasit në Kosovë”, është botuar në Shkurtë 2010. Në këtë raport është prezantuar studimi i dytë, i realizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë, gjatë vitit 2009.

Meqenëse Strategjia është realizuar me pjesëmarrje të plotë të komuniteteve RAE gjatë shumë workshopeve interaktive në vitet 2007 dhe 2008, të gjitha informatat e dhëna janë reale, dhe në bazë të tyre janë zhvilluar masat që duhet t’i ndërmerr qeveria për avancimin e cilësisë së jetës së këtyre komuniteteve, duke e mbrojtur pozitën dhe interesat e tyre, dhe duke i krijuar kushtet për integrim të plotë në shoqërinë kosovare. Por, edhe përkundër faktit se pjesëmarrësit RAE sollën shumë informacion, brenga, dhe sfida zhvillimore të komuniteteve që i përkasin, është dashur të studiohet më mirë gjendja aktuale socio-ekonomike e tyre, që është bërë në studimin “RAE-t në Kosovë”. Ky studim duhet të mbështes shumë organizata në teren, qoftë qeveritare qoftë OJQ lokale dhe ndërkombëtare, si dhe donatorë të shumtë që shprehin interesim t’i ndihmojnë këto zhvillime.

Një ndër sfidat më të shprehura pas hartimit të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit (aprovuar nga Qeveria e Kosovës me 25 dhjetor 2019), ishte të vlerësohet gadishmëria e resorëve përkatëse qeveritar për t’i implementuar rekomandimet e dhëna në Strategji dhe në Plan të Veprimit. Lidhur me këtë, është hartuar një pyetësor i veçanët për të mbledhur informacionin e duhur, që është dhënë në këtë raport. Qëllim parësor i këtij studimi, pra, ishte që të vlerësohet gadishmëria, kapaciteti implementues dhe ekspertiza e administratës kosovare, në të dy nivelet, qendror dhe lokal, për ta realizuar me sukses planin e veprimit. Poashtu është vlerësuar nëse njësit administrative qeveritare janë të përgatitura që të sigurojnë fonde të mjaftueshme për të punuar me këto komunitete.

Rezultatet e hulumtimit, që keni rast për t’i lexuar në vazhdim, janë interesante dhe shumë informative. Në këtë studim, para së gjithash ipet struktura e institucioneve që duhet të marrin pjesë në implementim të Strategjisë, dhe potenciali i tyre. Më tutje, mund të mësohet se sa të informuara janë këto institucione për rolin që duhet të marrin në realizimin e kësaj Strategjie, dhe se si e shohin këtë rol.

Duke ndriçuar më për së afërmi situatën reale në teren: (1) situatën socio-ekonomike të qytetarëve Rom, Ashkali dhe Egjiptas, si dhe (2) gadishmërinë e administratës kosovare që të veprojnë sipas dokumenteve strategjike, që tashmë i ka aprovuar, në avancimin e pozitës së këtyre komuniteteve, KFOS mendon të ndihmojë të gjithë ata që në periudhën e ardhshme afatmesme do të punojnë seriozisht për t’i ndihmuar këta bashkëqytetarë tanë, që sa më shpejtë të integrohen në shoqërinë tonë, dhe të kenë mundësi të barabarta me të gjithë të tjerët.

Strategjia për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës

PJESA I – Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të pakicave në nivel lokal (posaçërisht atyre që kanë të bëjnë me pakicën rome, ashkalia dhe egjiptiane)

Në vitin 2008, shtatë vite pas krijimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, UNMIK-u nxorri rregulloren për Zgjedhjet komunale në Kosovë¹ e cila vendos bazën ligjore për zgjedhjen e drejtpërdrejt të kryetarëve të komunave, me çka hapet rruga për amandamentimin e mëtejshëm të legjislacionit në fushën e qeverisjes lokale. Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30² ndryshoi Rregulloren parapake mbi Vetëqeverisjen e komunave, numër 2000/45, e cila shërbeu si bazë ligjore për organizimin dhe funksionimin e qeverive lokale prej vitit 2000. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës, në qershor të vitit 2008, janë dekretuar një numër i konsiderueshëm i ligjeve të cilat synojnë të ndërtojnë infrastrukturën ligjore në Kosovë, në përputhje me dokumentin e Ahtisaarit.

Ligji mbi vetëqeverisjen lokale përcakton statusin ligjor dhe kompetencat e komunave, parimet e përgjithshme të financimit komunal, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndër-komunal, përfshirë edhe bashkëpunimin përtej kufirit dhe raportet në mes komunave dhe nivelit qendror.³ Sipas këtij ligji, organet komunale janë kuvendi komunal dhe kryetari i komunës.⁴ Këto organe kanë të drejtë të miratojnë ligje dhe të ndërmarrin masa për implementimin e tyre në përputhje me kompetencat që kanë. Të gjitha ligjet në nivel komunal duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe sistemin ligjor të Republikës së Kosovës.⁵

1.2 Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të pakicave në nivel lokal (posaçërisht atyre që kanë të bëjnë me pakicën rome, ashkalia dhe egjiptiane)

1.2.1 Komuna e Pejës/Peć

Komuna e Pejës/ Peć ndodhet 90 km në perëndim të Prishtinës/Priştina dhe përfshin një sipërfaqe prej 603 km². Bazuar në të dhënat e Kuvendit komunal, Peja/Peć ka më shumë se 150.000 banorë, shumica dërmuese e të cilëve apo 93.62% janë shqiptarë, të pasuar nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian që përbëjnë 4.47% të popullsisë, boshnjakët (1.69%) dhe serbët (0.22%). Në Kuvendin e komunal të Pejës/Peć janë të punësuar njëzet e një (21) pjesëtarë të komuniteteve pakicë, pesëmbëdhjetë (15) nga të cilët janë boshnjakë, tre (3) serbë dhe nga një (1) malazez, ashkali dhe egjiptian.

Kuvendi komunal i Pejës/ Peć miratoi më 28 shtator të vitit 2008 statutin e komunës së Pejës/Peć, i cili garanton përdorimin e gjuhës amtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për përdorimin e gjuhëve. Mbledhjet e kuvendit, komiteteve, sikurse edhe gjitha mbledhjet tjera do të mbahen në gjuhën shqipe, serbe dhe

¹ Rregullorja e UNMIK-ut numër 2007/27 për Zgjedhjet komunale në Kosovë.

² Rregullorja e UNMIK-ut numër 2007/30- Ligi mbi Vetëqeverisjen Lokale.

³ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

⁴ Neni 10 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

⁵ Neni 11 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale.

boshnjake. Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës do të përkthehen në gjuhën shqipe, serbe dhe boshnjake.⁶ Statuti parasheh themelimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.⁷

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të kësaj komune. Komiteti për komunitete përbëhet nga shtatë (7) anëtarë (komiteti përbëhet nga anëtarë të kuvendit dhe përfaqësues të komunitetit). Çdo komunitet do të ketë të paktën një përfaqësues në këtë komitet.⁸ Në Komitetin për komunitete në Pejë/ Peć janë emëruar shtatë anëtarë: tre (3) shqiptarë, një (1) boshnjak, një (1) serb, një (1) egjiptian dhe një (1) pjesëtar i komunitetit rom.⁹

Sipas raportit¹⁰ të prezantuar nga MALG¹¹, gjatë vitit 2008 ky komitet nuk kishte raportuar asnjë mbledhje, përderisa në periudhën janar-mars 2009 komiteti ishte mbledhur tre (3) herë¹². Një nga detyrat me të cilat është ngarkuar komiteti është monitorimi i implementimit të legjislacionit, akteve nën-ligjore dhe politikave tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave në komunën e Pejës/Peć. Komiteti për komunitete gjithashtu shqyrton kërkesat dhe ankesat e dorëzuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë dhe ua paraqet ato drejtorive dhe institucioneve tjera përkatëse komunale. Këto kërkesa apo ankesa në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, infrastrukturën rrugore, rrymën dhe arsimin.

Komiteti komunal për komunitete mbledhet për çdo muaj për të shqyrtuar gjendjen e komuniteteve pakicë në komunën e Pejës/ Peć dhe për të adresuar nevojat e tyre. Komiteti për komunitete është përgjegjës për monitorimin e implementimit të të gjitha rregulloreve komunale dhe dokumenteve tjera strategjike që ndikojnë në respektimin e të drejtave të pakicave në komunën tonë.

S. C. Udhëqës i Zyrës komunale për komunitete në Pejë/Peć
Intervistë e FDH-Kosovë, 18 maj 2009.

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – është organ i përhershëm komunal, i paraparë me statutin e komunës.¹³ Kjo zyrë është përgjegjëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, sigurimin e qasjes së barabartë të komuniteteve pakicë në shërbimet publike në nivel lokal, por ka edhe detyra tjera, qëllimi i të cilave është përmirësimi i gjendjes së komuniteteve pakicë.¹⁴ Kjo zyrë ka hartuar planin trevjeçar të punës që mbulon fushën e arsimit dhe parasheh inicimin e fushatave të vetëdijesimit që synojnë inkadrimin e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në procesin arsimor. Gjithashtu, ZKK-ja është e angazhuar në projektet për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. ZKK-ja në Pejë/Peć aktualisht ka nëntë (9) të punësuar, tre (3) boshnjakë, dy (2) serbë, një (1) shqiptar, një (1) egjiptian, një (1) rom dhe një (1) malazias. Mandati i kësaj zyre është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave përmes aktiviteteve të ndryshme. ZKK-ja në Pejë/Peć, në bashkëpunim me drejtorinë komunale për arsim dhe OSBE-në, është e përfshirë në programin

⁶ Neni 7 i statutit të komunës së Pejës/ Peć.

⁷ Neni 47 i statutit të komunës së Pejës/ Peć.

⁸ Neni 55 i statutit të komunës së Pejës/ Peć.

⁹ Riza Lluca (AAK), Agime Lajçi (LDK), Gazmend Agusholli (ORA), Rustem Nurkovic (përfaqësues i komunitetit boshnjak), Momcilo Savic (përfaqësues i komunitetit serb), Shaip Gavrani (përfaqësues i komunitetit egjiptian) dhe Gani Toska (përfaqësues i komunitetit rom).

¹⁰ MALG- Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

¹¹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

¹² MALG- Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-mars 2009, mars 2009.

¹³ Neni 87 i statutit të komunës së Pejës/Peć.

¹⁴ Neni 97 i statutit të komunës së Pejës/Peć.

arsimor të quajtur “Catch up education” – program i shkollimit të shpejtuar për fëmijët që e kanë lënë shkollën gjatë dy apo tre viteve të fundit. Ky program u mundësoi atyre të përfundojnë dy klasë brenda një viti akademik dhe të vazhdojnë shkollimin më tej bashkë me moshatarët e tyre. ZKK-ja pohon se kjo është e arritura e saj më e madhe. Ata ia dolën që gjatë vitit 2008 t'i inkuadrojnë në sistemin parashkollor 130 fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Më pas, të gjithë këta fëmijë vazhduan shkollimin nëpër shkollat fillore të komunës së Pejës/Peć gjatë vitit akademik 2008/2009. ZKK-ja në Pejë/Peć ka zhvilluar një fushatë intensive të vetëdijesimit me qëllim që t'i informojë prindërit dhe familjet mbi rëndësinë që ka shkollimi i fëmijëve.

Ne ia kemi dalë të regjistrojmë në shkollat fillore 130 fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për vitin akademik 2008/2009. Kjo është arritje e madhe e zyrës tonë. Para lansimit të programit, ne zhvilluam një fushatë intensive të vetëdijesimit të prindërve dhe familjeve mbi rëndësinë e shkollimit të fëmijëve. Dihet se fëmijët e këtyre komuniteteve nuk vijnë në shkollë, por në vend të kësaj bëjnë punë të ndryshme - shesin cigare nëpër rrugë apo punojnë si hamall. Besoj se kjo do të ndihmojë edhe në integrimin e tyre më të mirë në shoqëri.

S. C. udhëheqës i Zyrës për komunitete në Pejë/Peć
Intervistë e FDH-Kosovë, 18 maj 2009

Buxheti dhe projektet –Kuvendi komunal miraton buxhetin e komunës për çdo vit. Për projektet e ZKK-së të destinuara për komunitetet pakicë janë ndarë gjithsej 154.026 euro apo 11% e buxhetit të përgjithshëm të komunës së Pejës/Peć. Në këtë shumë janë përfshirë edhe rrogat e të punësuarve, mallrat dhe shërbimet, shërbimet komunale dhe investimet kapitale.¹⁵ Këto mjete shfrytëzohen për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, projekte tjera infrastrukturore dhe për shërbime komunale në kuadër të investimeve kapitale.

Mjetet nga buxheti komunal të destinuara për komunitetet pakicë investohen në infrastrukturë- si për shembull për rekonstruktimin e rrugës në lagjen “7 Shtatori” në Pejë/Peć, e cila banohet nga pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Rruga tani është ndërtuar dhe në këtë lagje është instaluar edhe rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit. Projekt filloi në vitin 2008 dhe ende nuk ka përfunduar. Për këtë projekt komuna ka alokuar një buxhet prej 50.000 euro.

Këtë vit jemi duke punuar shumë për t'i përmirësuar kushtet e jetesës për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët që jetojnë në fshatrat Bllagojë/ Blagoje, Trebovic/ Trbovic, Zllopek/ Zlopek dhe Vitomiricë/ Vitomirica, po rindërtojmë shtëpitë, rrugët dhe po vendosim rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit në këto fshatra.

S. C. udhëheqës i Zyrës për komunitete në Pejë/Peć
Intervistë e FDH-Kosovë, 18 maj 2009.

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, komuna e Pejës/Peć akoma nuk kishte ndarë ndonjë buxhet të posaçëm për nevojat e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali. Vëmendje e posaçme u kushtohet rasteve të personave që kanë nevojë për ushqim dhe veshmbathje. Në raste të tilla, ZKK-ja zakonisht ofron ndihmë materiale në baza *ad hoc*, duke u dhënë këtyre individëve nga 100 euro.

¹⁵ Shpenzimet vjetore për rrogat e personelit (9 persona) janë 27.766 euro, kurse për mallra dhe shërbime 25.250 euro, për shërbime komunale 1.010 euro dhe për investime kapitale 100.000 euro. - G.G. Udhëheqës i departamentit për buxhet dhe financa në Pejë/ Peć, Intervistë e FDH-Kosovë, 18 maj 2009.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Komuna e Pejës/Peć nuk ka ndonjë program apo plan të veprimit për regjistrimin e personave të paregjistruar, të cilët kanë jetuar jashtë vendit dhe janë kthyer në Kosovë kohëve të fundit. Në vitin 2008, Zyra komunale për komunitete kishte informata se 15 familje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ishin kthyer në Kosovë nga Serbia, Mali i Zi apo shtetet perëndimore.

Për momentin, në komunën e Pejës/Peć ekzistojnë katër (4) vendbanime multietnike joformale. Një (1) vendbanim i tillë ndodhet në lagjen “Zastra”, dy (2) në lagjen “7 Shtatori” dhe një në (1) në lagjen “Kristal”. Në këto vendbanime jozyrtare jetojnë rreth 150 anëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Shqiptarët dhe boshnjakët banojnë gjithashtu në këto vendbanimeve. Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë hap për të legalizuar apo shpërbërë këto katër (4) vendbanime joformale.

Mungesa e dokumentacionit mbi pronën e mëhershme paraqet problemin më të madh me të cilin ballafaqohen komunitetet RAE.

Nuk kemi ndonjë plan për t'i legalizuar vendbanimet joformal në komunën tonë. Problemi është se disa pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian nuk mund të vërtetojnë se disponojnë ndonjë pronë, meqenëse nuk kanë asnjë dokument për të vërtetuar pronësinë. Komuna nuk mund t'i ndihmojë ata e as që mund të marrë mbi vete detyrat për zgjidhjen e çështjeve pronësore.

A.G. zyrtar komunal për çështje pronësore dhe urbanizëm në komunën e Pejës/Peć
Intervistë e FDH-Kosovë, 18 maj 2009.

Informimi dhe vetëdijesimi – Zyrtarët komunalë nuk janë të informuar për Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, gjatë periudhës 2009 - 2015. Për herë të parë ata dëgjuan për këtë strategji pasi pranuan dokumentin në fjalë përmes postës elektronike. Zyra komunale për komunitete është vendi ku drejtohen pjesëtarët e komuniteteve për të kërkuar ndihmë për zgjidhjen e problemeve të tyre. Zyra për komunitete në Pejë/Peć ka bashkëpunim të mirë me sektorin e shoqërisë civile. Ata punojnë së bashku në implementimin e projekteve të ndryshme në fushën e arsimit, infrastrukturës dhe shëndetësisë.

1.2.2 Komuna e Gjakovës/ Đakovica

Komuna e Gjakovës/ Đakovica mbulon një territor prej 521 km². Në bazë të të dhënave të OSBE-së¹⁶, Gjakova/ Đakovica ka një popullsi prej 150.000 banorësh, 90.000 nga të cilët jetojnë në qytete dhe 60.000 në fshatra. Shqiptarët përbëjnë shumicën dërmuese – deri në 95.30%, 0.04% janë boshnjakë, kurse 4.66% janë pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Komuniteti RAE, që numëron gjithsej 8.600 banorë, përbën pakicën më të madhe në komunë. Pesëmbëdhjetë (15) familje të komunitetit RAE janë kthyer nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, kurse njëzet e nëntë (29) familje tjera janë kthyer me dhunë nga shtetet perëndimore. Ata nuk kanë probleme të sigurisë. Udhëheqësia komunale pohon të ketë luajtur rol kryesor në kthimin e tyre, duke e ndihmuar dhe lehtësuar procesin. Sidoqoftë, mbetet edhe shumë punë për të bërë, posaçërisht sa i përket punësimit dhe arsimit, me qëllim të integritit të plotë të këtyre komuniteteve në të gjitha nivelet e shoqërisë. Kuvendi komunal i Gjakovës/ Đakovica ka të punësuar (4) pjesëtarë të komuniteteve pakicë. Të gjithë janë egjiptianë.

¹⁶ OSBE-Profillet e komunave-Gjakovë/ Đakovica.

Kuvendi komunal i Gjakovës/ Đakovica miratoi statutin e komunës më 26 dhjetor të vitit 2008. Statuti garanton përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.¹⁷ Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.¹⁸

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti për komunitete përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Secili komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga të paktën një përfaqësues.¹⁹ Anëtarët e emëruar të Komitetit për komunitete në komunën e Gjakovës/Đakovica janë: një (1) serb, një (1) rom, një (1) egjiptian dhe një (1) boshnjak.²⁰ Komiteti mban mbledhje për çdo muaj.

Sipas raportit të MALG²¹, komiteti mbajti shtatë (7) mbledhje gjatë vitit 2008, kurse gjatë periudhës janar-mars 2009 u mbajtën tre mbledhje²². Ky komitet ka për detyrë të monitorojë implementimin e legjislacionit, akteve nën ligjore dhe politikave tjera që rregullojnë të drejtat e pakicave në komunën e Gjakovës/ Đakovica. Komiteti për komunitete shqyrton kërkesat dhe ankesat e dorëzuara nga qytetarët e komuniteteve pakicë dhe ia paraqet ato drejtorive dhe institucioneve përkatëse komunale. Përpos kësaj, komiteti i jep rekomandime kuvendit për masat që duhet ndërmarrë me qëllim të implementimit të legjislacionit të zbatueshëm dhe për të përmirësuar gjendjen e komuniteteve në Gjakovë/ Đakovica. Kërkesat dhe ankesat e paraqitura nga qytetarët në shumicën e rasteve kanë të bëjnë rindërtimin e shtëpive, infrastrukturën rrugore, energjinë elektrike dhe arsimin.

Komiteti për komunitete ka mandat të monitorojë respektimin e të drejtave të pakicave dhe të shqyrtojë lutjet dhe ankesat e dorëzuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Ky organ mblidhet një herë në muaj dhe përpos detyrave të përmendura më lartë, ai i rekomandon kuvendit masat që duhet ndërmarrë për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen pakicat dhe për implementimin e rregulloreve që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare.

N. Q. udhëheqës i Zyrës komunale për komunitete në Gjakovë/Đakovica

Intervistë e FDH-Kosovë, 21 maj 2009.

Zyra Komunale për Komunitete (ZKK) – Statuti i komunës rregullon mandatin dhe funksionimin e ZKK-së.²³ Sipas statutit, kjo zyrë është përgjegjëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, qasjen e papenguar dhe të barabartë të pakicave në shërbimet publike në nivel komunal dhe promovimin e parimeve të anti-diskriminimit.²⁴ Zyra komunale për komunitete ka katër (4) të punësuar. Tre (3) nga ata janë egjiptianë dhe një (1) është shqiptar. Mandati i zyrës është të bashkëpunojë me të gjitha drejtoritë e komunës me qëllim që të mbrohen dhe të promovohen të drejtat e pakicave përmes aktiviteteve të ndryshme. Kjo zyrë harton për çdo vit planin e veprimit i cili kryesisht përqendrohet në fushën e arsimit dhe fushatat e

¹⁷ Neni 7 i statutit të komunës së Gjakovës/ Đakovica.

¹⁸ Neni 35 i statutit të komunës së Gjakovës/ Đakovica.

¹⁹ Ibid.

²⁰ Intervistë e FDH-Kosovë me Nexhip Qehaja- Udhëheqës i Zyrës komunale për komunitete në Gjakovë/Đakovica, 21 maj 2009.

²¹ MALG- Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

²² MALG- Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-mars 2009, mars 2009.

²³ Neni 48 i statutit të komunës së Gjakovës/Đakovica.

²⁴ Ibid.

vetëdijesimit për rëndësinë e përfshirjes në shkolla të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian. ZKK-ja në Gjakovë/ Đakovica mori pjesë në përgatitjen e fletushkave informative me udhëzime praktike për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali and egjiptian se si t'i marrin dokumentet zyrtare nga komuna. ZKK-ja ka bashkëpunuar me UNDP për të lehtësuar konstruktimin e shtatë (7) shtëpive për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në fshatin Brekoc/Brekoc.

ZKK-ja në Gjakovë/Đakovica ka si prioritet kthimin e qëndrueshëm të pakicave në shtëpitë e tyre dhe lehtësimin e këtij procesi. Gjithsej pesëmbëdhjetë (15) familje nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian janë kthyer deri tani në Gjakovë/ Đakovica. Kjo zyrë ishte shumë aktive në projektet nga fusha e arsimit. KZZ-ja, në bashkëpunim të ngushtë me drejtorinë komunale të arsimit, ka lansuar fushatën e vetëdijesimit e cila synon të informojë prindërit dhe fëmijët për rëndësinë që ka inkuadrimi i fëmijëve në sistemin arsimor. Duke iu falënderuar kësaj punë të palodhshme, 66 fëmijë nga radhët e komuniteteve RAE janë regjistruar²⁵ në klasën e parë të shkollës fillore për vitin akademik 2008/2009.

Prioritet i zyrës tonë është kthimi i personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Një nga të arriturat më të mëdha është kthimi i pesëmbëdhjetë (15) familjeve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Gjakovë/Đakovica. Përfshirja e fëmijëve të tyre në sistemin e obliguar arsimor është një sfidë tjetër dhe ne po punojmë me të madhe kundër analfabetizmit mes anëtarëve të këtyre komuniteteve. Ne punojmë ngushtë me drejtorinë komunale të arsimit në lidhje me këto çështje.

B.K. zyrtar për zhvillimin e komuniteteve -ZKK Gjakovë/ Đakovica

Intervistë e FDH-Kosovë, 21 maj 2009.

Buxheti dhe projektet – Kuvendi komunal miraton buxhetin e komunës për çdo vit. Shuma që ndahet për ZKK-në varet nga nevojat e saj dhe numri i banorëve.²⁶ Për ZKK-në janë ndarë gjithsej 31.696 euro apo 4.3% e buxhetit të përgjithshëm të komunës së Gjakovës/ Đakovica. Shpenzimet për rrogat e punëtorëve, mallrat dhe shërbimet²⁷ janë përfshirë në këtë shifër. Nga ky buxhet paguhen shpenzimet për rekonstruktimin e rrugëve, projektet tjera infrastrukturore dhe shërbimet komunale në kuadër të investimeve kapitale.

Gjatë vitit 2008 dhe 2009, komuna e Gjakovës/ Đakovica ka financuar rekonstruktimin e rrugëve në fshatrat e mëposhtme: Gropisht/Gropiste, Shishman/Shishman dhe një pjesë të rrugës në fshatin Janosh/ Janos. Këto lagje janë të banuara nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ne gjithashtu kemi mbështetur rekonstruktimin e shtëpive për të kthyerit dhe kemi lehtësuar regjistrimin e fëmijëve të familjeve të kthyer në shkollimin fillor, para së gjithash regjistrimin e fëmijëve nga radhët e komunitetit egjiptian.

K.K. zyrtar komunal në ZKK të Gjakovës/Đakovica

Intervistë e FDH-së, 21 maj 2009

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, komuna e Gjakovës/Đakovica nuk kishte ndarë buxhet specifik për nevojat e romëve, egjiptianëve dhe ashkalinjëve.

²⁵ Gjithsej tetëmbëdhjetë (18) fëmijë nga Kolonia/ Korlonia, njëzet e tetë (28) nga Brekoci/ Brekoc dhe njëzet (20) fëmijë nga lagja Sefë/ Sef janë regjistruar në shkollën fillore. -N.Q. Kryetar i ZKK në Gjakovë/ Đakovica.

²⁶ B.K. zyrtar për zhvillimin e komuniteteve - ZKK Gjakovë/Đakovica. Intervistë e FDH-Kosovë, 21 maj 2009.

²⁷ Shpenzimet vjetore pagat e stafit (4) janë 11,496 euro, mallrat dhe shërbimet 20,200 euro. – Buxheti i miratuar vjetor për vitin 2009.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Komuna e Gjakovës/ Đakovica nuk ka program për regjistrimin e qytetarëve të paregjistruar, të cilët pas lufte janë larguar nga Kosova dhe kanë jetuar jashtë shtetit, kurse janë kthyer në Kosovë kohëve të fundit. ZKK-ja ka përgatitur një broshurë informative me udhëzime si të regjistrohesh.

Aktualisht në komunën e Gjakovës/Đakovica ka tre (3) vendbanime jozyrtare multietnike. Lagja Kolonia/Koloni kë një (1) vendbanim jozyrtar me shtatëqind (700) banorë, Dardania/Dardani ka gjithashtu një (1) vendbanim jozyrtar ku jetojnë shtatë (7) familje me pesëdhjetë (50) anëtarë dhe një vendbanim tjetër i ngjashëm me 700 banorë që jetojnë në 115 shtëpi gjendet në Brekoc/Breko. Pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përbëjnë shumicën e banorëve që jetojnë në këto vendbanime jozyrtare, megjithëse aty ka edhe pjesëtarë të komuniteteve tjera, duke përfshirë edhe shqiptarë. Kushtet për jetë janë shumë të këqija. Komuna po përgatitet t'i legalizojë këto vendbanime. Për këtë qëllim ajo ka ndarë katër (4) hektarë tokë për ndërtimin e shtëpive për të gjithë banorët që jetojnë atje.

Shumë pjesëtarët të komunitetit RAE të kthyer në Gjakovë/Đakovica, ngjashëm me bashkëkombësit e tyre në Pejë/Peć, nuk kanë dokumentet e nevojshme për të vërtetuar pronësinë, prandaj edhe nuk mund ta shfrytëzojnë pronën e tyre. Megjithëse administrata komunale ka shprehur gatishmërinë për t'i ndihmuar këto komunitete në të gjitha mënyrat e mundshme, ajo thotë se nuk mund të bëjë asgjë sa i përket dokumentacionit pronësorë.

Ne po punojmë për t'i legalizuar vendbanimet jozyrtare në komunën tonë. Komuna ka ndarë katër (4) hektarë tokë për ndërtimin e shtëpive për qytetarët e vendbanimeve jozyrtare dhe shpresojmë se së shpejti do të fillojmë me ndërtimin e shtëpive. Kushtet për jetë në këto vendbanime janë të padurueshme. Nga ana tjetër, qytetarët romë, ashkalinjë dhe egjiptianë nuk kanë dokumentacion mbi pronësinë.

N. Q. udhëheqës i Zyrës komunale për komunitete në Gjakovë/Đakovica
Intervistë e FD-Kosovë, 21 maj 2009.

Informimi dhe vetëdijësimi– ZKK-ja në Gjakovë/ Đakovica është e informuar mirë në lidhje me Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, shkali dhe egjiptian, për periudhën 2009-2015. Një nga zyrtarët e ZKK-së për zhvillimin e komuniteteve në fushën e arsimit mori pjesë në hartimin e strategjisë. Kjo zyrë është e hapur për qytetarët që t'i adresojnë problemet dhe ankesat e tyre. Personeli i ZKK-së ofron udhëzime dhe këshilla se ku të shkohet dhe si të procedohet në raste të tilla. ZKK-ja në Gjakovë/Đakovica bashkëpunon ngushtë me OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, kryesisht me IOM-in, UNDP-në, ESCE-në dhe CARITAS-in, në projektet për kthimin e të zhvendosurve/refugjatëve, fushata e vetëdijësimit dhe iniciativat në fushën e arsimit.

1.2.3 Komuna e Klinës/Klina

Komuna e Klinës/Klina gjendet në perëndim të Kosovës dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 308 km². Komuna ka 54 fshatra dhe qendrën e vet rajonale- Klinën/Klina. Për shkak të zhvendosjeve të mëdha të popullsisë, nuk dihet numri i saktë i banorëve që jetojnë në këtë komunë,. Drejtoria komunale e administratës së përgjithshme vlerëson se kjo komunë ka rreth 60.000 banorë. Komunitetet pakicë janë serbët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët (rreth 2.000). Gjithsej 334 fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian po vijnë në mësimet në shkollat fillore dhe të mesme të komunës, përderisa shtatë fëmijë të nacionalitetit serb, familjet e të cilëve janë kthyer

në Kosovë, vijojnë mësimet në fshatrat Binxhë/Bica dhe Videjë/Vidanje²⁸, të cilat funksionojnë si pjesë e sistemit arsimor të Serbisë.

Gjatë vitit 2008, në Klinë janë kthyer tre (3) familje të komunitetit RAE nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, përderisa këtë vit komuna është duke punuar në kthimin e disa familjeve tjera. Në Kuvendin komunal të Klinës janë të punësuar katër pjesëtarë të komuniteteve: dy (2) serbë, një (1) egjiptian dhe një (1) rom.

Më 22 shtator 2008, Kuvendi komunal i Klinës/ Klina miratoi statutin e komunës. Statuti garanton përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.²⁹ Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.³⁰

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti për komunitete përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë është i përfaqësuar nga të paktën një përfaqësues.³¹ Në bazë të statutit, në këtë Komitet duhet të emërohen më së paku pesë (5) dhe më së shumti nëntë (9) anëtarë. Komiteti për komunitete në komunën e Klinës/ Klina aktualisht përbëhet nga një (1) serb, një (1) rom dhe dy (2) pjesëtarë të komunitetit egjiptian.³² Të gjithë janë të emëruar në këtë komitet. Ky organ mban mbledhje për çdo muaj.

Sipas raportit të përgatitur nga MALG³³, komuna e Klinës/ Klina nuk ka paraqitur numrin e mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2008, përderisa gjatë periudhës janar - mars 2009, ky komitet mbajti tre (3) mbledhje.³⁴ Detyra e komitetit është të monitorojë implementimin e legjislacionit, akteve nën-ligjore dhe politikave tjera të shkruara që rregullojnë të drejtat e pakicave në komunën e Klinës/ Klina. Komiteti për komunitete ua përcjell drejtorive përkatëse komunale shqetësimet e pjesëtarëve të komuniteteve. Kërkesat dhe ankesat e ngritura nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë kryesisht kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, procesin e kthimit, infrastrukturën rrugore, energjinë elektrike dhe arsimin.

Komiteti për komunitete takohet për çdo muaj; ai ka mandate të mbikëqyr respektimin e të drejtave të pakicave dhe të shqyrtojë kërkesat dhe ankesat e bëra nga qytetarët e komuniteteve pakicë, duke u përqendruar posaçërisht në shqetësimet që kanë të bëjnë me procesin e kthimit. Këto shqetësime pastaj përcillen në drejtoritë përkatëse komunale dhe nga ata kërkohet të përgjigjen në shqetësimet e ngritura nga qytetarët.

A. G. Zv. i udhëheqësit të Zyrës për komunitete në Klinë/Klina
Intervistë e FDH-Kosovë, 25 maj 2009.

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – Statuti i komunës rregullon mandatin dhe funksionimin e kësaj zyre.³⁵ Në bazë të statutit, zyra është përgjegjëse për promovimin dhe

²⁸ OSBE- profilet e komunave - Klina/Klina

²⁹ Neni 37 i statutit të komunës së Klinës/Klina.

³⁰ Neni 34 i statutit të komunës së Klinës/Klina.

³¹ Ibid

³² Intervistë e FDH-Kosovë me Agim Gashin – zv. udhëheqës i Zyrës komunale për komunitete në Klinë/Klina, 25 Maj 2009.

³³ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009

³⁴ MALG - Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

³⁵ Neni 72 i statutit të komunës së Klinës/Klina.

mbrojtjen e të drejtave të pakicave, qasjen e barabartë të pakicave në shërbimet publike në nivel komunal dhe promovimin e drejtpërdrejt të parimeve anti-diskriminuese.³⁶ Statuti kërkon që udhëheqësi i ZKK-së t'i raportojë kuvendit për çdo mbledhje që mban kjo zyrë, duke përshkruar çështjet e diskutuara, vendimet e marra dhe të arriturat e këtij organi. Aktualisht, ZKK-ja në Klinë/Klina ka një personel prej katër (4) anëtarësh, një (1) rom, një (1) egjiptian dhe dy (2) serbë. Mandati i saj është të bashkëpunojë me drejtoritë tjera komunale, me qëllim që të promovojë dhe mbrojë të drejtat e pakicave përmes aktiviteteve të ndryshme. Kjo zyrë merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Kuvendit dhe të KK. Përpos kësaj, zyra paraqet mendimet e veta gjatë përcaktimit të buxhetit për komunitete në komunën e Klinës/Klina.

Zyrë harton për çdo vit planin e veprimit me theks në procesin e kthimit dhe shkollimin e fëmijëve të komuniteteve pakicë, posaçërisht fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. ZKK-ja në Klinë/Klina ka lehtësuar procesin e kthimit nga Mali i Zi në Kosovë të tre familjeve (3) rome, ashkalie dhe egjiptiane.

Kthimi i qëndrueshëm i pakicave në shtëpitë e tyre dhe integrimi i tyre në shoqëri është prioritet për ZKK në Klinë/Klina. Herën e fundit që ndonjë familje rome, ashkalie apo egjiptiane u kthye në këtë komunë ishte në vitin 2009. Komuna është duke u përgatitur për valën tjetër të atyre që do të kthehen.

Prioritetet e zyrës tonë janë: integrimi i komuniteteve pakicë në shoqëri, procesi i kthimit, ofrimi i ndihmës për kthim të qëndrueshëm për gjithë ata që vendosin të kthehen dhe të jetojnë në shtëpitë e tyre. Shkollimi i fëmijëve të minoriteteve është një objektiv tjetër. Ne jemi duke e luftuar analfabetizmin mes pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Për këtë qëllim kemi punuar ngushtë me UNOPS-in, kemi organizuar orë kompensuese dhe i kemi përfshirë fëmijët në këto programe.

A. G. zv. i udhëheqësit të Zyrës komunale për komunitete në Klinë/Klina
Intervistë e FDH-Kosovë, 25 Maj 2009.

Buxheti dhe projektet – Kuvendi komunal miraton buxhetin komunal për çdo vit. Për nevojat e ZKK-së janë ndarë gjithsej 49.969 euro ose 3.5% e buxhetit të përgjithshëm komunal, ku përfshihen edhe shpenzimet për pagat e punëtorëve, mallrave dhe shërbimet tjera. Ky buxhet shfrytëzohet edhe për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, përmirësimin e rrjetit të rrymës elektrike dhe shërbime komunale. Për dy vite me radhë (2008 dhe 2009), komuna ka ndihmuar rekonstruktimin e rrugëve në fshatrat Binçë/Binca, Grabovc/Grabovc, Vida/Vida dhe rrugën kryesore të Mahallës së romëve në Klinë/ Klina³⁷.

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, komuna e Klinës/Klina ende nuk kishte ndarë buxhet për nevojat e komunitetit RAE.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Komuna e Klinës/ Klina nuk ka ndonjë program të posaçëm për regjistrimin e personave të paregjistruar. Sipas zyrtarëve të ZKK-së, Programi i Kosovës për të drejta civile (CRPK)³⁸ ka mbështetur regjistrimin e pjesëtarëve të

³⁶ Ibid.

³⁷ A.G. –zv. i udhëheqës it të Zyrës për komunitete në Klinë/Klina- Intervistë e FDH-Kosovë, 25 maj 2009.

³⁸ OJQ kosovare që mbështet regjistrimin e PZH në Kosovë, duke përfshirë edhe pjesëtarët e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali.

komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. ZKK-ja nuk ka të dhëna për numrin e personave që CRPK-ja ka ndihmuar të regjistrohen, e as që ka njohuri për numrin e kërkesave për regjistrim.

Në komunën e Klinës/Klina nuk ka vendbanime jozyrtare.

Mungesa e dokumenteve të pronësisë paraqet problemin më të madh për pjesëtarët e komunitetit RAE. Administrata komunal pohon se ajo nuk është përgjegjëse për zgjidhjen e këtyre çështjeve, por thekson se është e përkushtuar të ndihmojë pjesëtarët e këtyre komuniteteve në çfarëdo mënyre tjetër.

Informimi dhe vetëdijesimi – ZKK-ja në Klinë/Klina nuk është e informuar mbi Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, gjatë periudhës 2009-2015. Komuna ka ndërmarrë hapa dhe masa në përputhje me kornizën legislative dhe politikat e shkruara. Komuna e Klinës/Klina është e njohur për kthim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të personave të zhvendosur brenda Kosovës.³⁹ Ajo ka pasur një bashkëpunim të frytshëm me organizata të ndryshme, lokale dhe ndërkombëtare, që merren me procesin e kthimit. Zyra është e hapur për gjithë qytetarët që t'i prezantojnë problemet dhe shqetësimet e tyre. Staf i ZKK-së i udhëzon dhe këshillon qytetarët ku të lajmërohen dhe si të procedojnë më tej. ZKK-ja në Klinë/ Klina bashkëpunon afër me IOM-in, UNDP-në, OSBE-në, UNHCR-në dhe Kryqin e kuq ndërkombëtar në projektet e kthimit si dhe në fushatat e vetëdijesimit dhe çështjet që kanë të bëjnë me arsimim.

1.2.4 Komuna e Prishtinës/ Prishtina

Komuna e Prishtinës/Priština ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin një sipërfaqe prej 572 km². Prishtina është qendra administrative, politike, ekonomike dhe kulturore e Kosovës. Ajo gjithashtu është komuna me popullsi më të madhe. Graçanica/Gračanica, qendra kulturore e serbëve që jetojnë në pjesën qendrore të Kosovës, është pjesë e komunës së Prishtinës/ Priština. Si komuna e Prishtinës/ Priština ashtu edhe strukturat paralele serbe kryejnë funksionet administrative në Graçanicë/Gračanica. Strukturat paralele të Serbisë funksionojnë në këto sektorë: arsim, shëndetësi, administratë dhe sistemin gjyqësor.⁴⁰ Kjo komunë ka një popullsi prej rreth 500.000 banorësh. Sipas UNMIK-ut, shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën e popullsisë (rreth 475.000); sipas vlerësimeve të vitit 2005, numri i komuniteteve pakicë është si vijon: 12.510 serbë, 4.550 ashkalinjë dhe rom dhe 450 boshnjakë dhe goran.⁴¹ Pakicat tjera, duke përfshirë këtu edhe komunitetin turk, nuk janë më shumë se 3.950.⁴² Sipas UNHCR, nga viti 2000 e deri tani, në këtë komunë janë kthyer rreth 1.150 pjesëtarë të komunitetit serb të zhvendosur brenda Kosovës, 292 rom dhe 296 ashkalinjë. Kthimi i tyre ishte kryesisht spontan. Për momentin në Graçanicë/Gračanica ka dy qendra kolektive të banuara nga serbët e zhvendosur brenda Kosovës. Në komunën e Prishtinës/ Priština gjatë viteve 2008-2009 janë kthyer shtatë (7) familje serbe, dy (2) ashkalinje dhe një (1) rome.⁴³ Pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom kryesisht trajtohen në spitalet që janë pjesë e strukturave paralele. Në rast të ndonjë

³⁹ Raport i UNDP, shkurt 2009- Procesi i kthimit në Klinë/Klina “Po të kishte më shumë komuna të tilla procesi i kthimit do të ishte shumë më i suksesshëm”

⁴⁰ Raporti i OSBE-së –Profili i komunave- Prishtina/Priština.

⁴¹ Ibid.

⁴² Strategjia e komunës së Prishtinës/ Priština për kthimin e të zhvendosurve 2007.

⁴³ P.V. drejtor i zyrës komunale për komunitete në Prishtinë/ Priština, Intervistë e FDH-Prishtinë, 12 maj 2009.

problemi më serioz shëndetësor, ata kërkojnë ndihmë në Spitalin e Mitrovicës së veriut/ Mitrovica. Qasja në shërbimet primare shëndetësore akoma është e vështirësuar në vendbanimet rurale.

Në Kuvendin komunal të Prishtinës/Priştina janë të punësuar tre pjesëtarë të komuniteteve pakicë: një (1) serb, një (1) turk dhe një (1) ashkali.⁴⁴

Më 3 mars 2008, Kuvendi i komunës së Prishtinës/ Priştina miratoi statutin e komunës. Statuti garanton përdorimin e gjuhëve amtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.⁴⁵ Përpos kësaj, më 12 shkurt 2009, Kuvendi komunal miratoi rregulloren mbi përdorimin e gjuhëve, me të cilën caktohen kushtet dhe procedurat për marrjen e dokumentacionit në gjuhët zyrtare dhe krijohet njësia për përkthim. Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.⁴⁶

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti për komunitete përbëhet nga këshilltarët komunalë dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Secili komunitet që jeton në komunë është përfaqësuar me një përfaqësues.⁴⁷ Sipas statutit të komunës, KK duhet të ketë (9) anëtarë të emëruar. Aktualisht ky komunitet ka tre (3) serbë, një (1) rom, një (1) turk, një (1) ashkali, një (1) boshnjak dhe dy (2) shqiptarë⁴⁸, të gjithë këta të emëruar në këtë komitet. Komiteti për komunitete ka mandat të promovojë respektimin e të drejtave të pakicave dhe politikave jo-diskriminuese sa i përket qasjes në shërbime komunale dhe punësim. KK gjithashtu monitoron punën e Zyrës komunale për komunitete, përgatitë rekomandime për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave për kuvendin komunal dhe kryetarin e komunës. Ky komitet mban mbledhje për çdo muaj. Mbledhjet monitorohen nga përfaqësuesi komunal i OSBE-së. Komuna nuk ka miratuar ndonjë politikë të posaçme apo dokument për të adresuar nevojat e komunitetit RAE.

Raporti i MALG⁴⁹ nuk ka të dhëna për numrin e mbledhjeve të mbajtura nga Komiteti për komunitete sepse ky i fundit nuk ka raportuar asnjë mbledhje gjatë vitit 2008, përderisa gjatë periudhës janar - mars 2009 komiteti është takuar katër herë.⁵⁰ Komiteti ka për detyrë të monitorojë implementimin e legjislacionit, akteve nën-ligjore dhe dokumenteve tjera që rregullojnë të drejtat e pakicave në komunën e Prishtinës/ Priştina. KK gjithashtu përcjell shqetësimet e komuniteteve në drejtoritë përkatëse komunale. Lutjet dhe ankesat e qytetarëve, të drejtuara Komitetit për komunitete, kryesisht kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, procesin e kthimit, infrastrukturën rrugore, energjinë elektrike dhe arsimin.

Komiteti për komunitete takohet çdo muaj; mbledhjet e tij monitorohen nga monitoruesit komunal të OSBE-së. Kjo zyrë ka mandat të mbikëqyrë aktivitetet e Zyrës komunale për komunitete, të promovojë respektimin e të drejtave të komuniteteve pakicë në nivel komunal dhe

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ Neni 14.5 dhe 14.6 i statutit të komunës së Prishtinës/ Priştina.

⁴⁶ Neni 42 i statutit të komunës së Prishtinës/ Priştina.

⁴⁷ Neni 44 i statutit të komunës së Prishtinës/ Priştina.

⁴⁸ Neni 5 (b) rregullores komunale mbi përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme, lëshuar në korrik të vitit 2008 dhe Intervistë e FDH-Kosovë me Faton Marollin- zyrtar komunal në Zyrën për komunitete në Prishtinë/Priştina, 12 maj 2009.

⁴⁹ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

⁵⁰ MALG - Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-mars 2008, mars 2009.

të ofrojë rekomandime dhe këshilla për kuvendin komunal dhe kryetarin e komunës mbi politikat e ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave. Zyra gjithashtu shqyrton lutjet dhe ankesat e dorëzuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë.

F. M. zyrtar komunal i Zyrës për komunitete në Prishtinë/ Priština
Intervistë e FDH-Kosovë, 12 maj 2009.

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – mandati dhe funksionimi i kësaj zyre si pjesë integrale e komunës është rregulluar me statutin komunal.⁵¹ Sipas statutit, kjo zyrë është përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave, qasjen e barabartë të pakicave në shërbimet publike në nivel komunal dhe promovimin e drejtpërdrejt të parimeve anti-diskriminuese.⁵² Statuti përcakton se kryetari i ZKK-së është gjithashtu anëtar i bordit të drejtorëve. Kryetari i ZKK-së merr pjesë në mbledhjet e KK dhe raporton rregullisht për punë e kryer. Statuti parasheh gjithashtu edhe krijimin e nën-zyrave për komunitete. Në ZKK-në e Prishtinës/ Priština për momentin ka katër (4) të punësuar: një (1) ashkali, një (1) serb, një (1) turk dhe një (1) shqiptar. Kjo zyrë ka mandat të bashkëpunojë me të gjitha drejtoritë komunale dhe të lehtësojë aktivitetet që kanë për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave në fushën e sigurisë, lirisë së lëvizjes, përdorimit të gjuhës dhe përmirësimit të kushteve të jetës. ZKK-ja ka mbështetur disa projekte që synojnë përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shërbimeve shëndetësore, arsimit, aktivitete kulturore dhe rekonstruktimin e shtëpive. ZKK-ja në Prishtinë/ Priština ka dhënë ndihmën e saj në kthimin e shtatë familjeve (7) serbe, dy (2) familjeve ashkallie dhe një (1) familje rome. Prioriteti i saj për vitin 2009/2010 është të lansojë një fushatë për vetëdijësimin e prindërve dhe fëmijëve të komunitetit rom për rëndësinë e shkollimit, me qëllim që të arrihet një shkallë më e lartë e regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom në sistemin arsimor.

Qeveria qendrore dhe ajo lokale e konsiderojnë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme punën e ZKK-së në Prishtinë/ Priština. Sipas tyre, detyra jonë është të kontribuojmë në promovimin e të drejtave të pakicave, përmirësimin e sigurisë, lirisë së lëvizjes, përdorimit të gjuhës dhe aktivitete tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në kushtet e jetës së komuniteteve pakicë në Prishtinë/ Priština. Ne e kemi bërë këtë në të kaluarën dhe planifikojmë të vazhdojmë angazhimin tonë për këtë qëllim edhe në të ardhmen.

P.V. drejtor i Zyrës komunale për komunitete në Prishtinë/Priština
Intervistë e FDH-Kosovë, 12 maj 2009.

Buxheti dhe projektet – Kuvendi komunal miraton për çdo vit buxhetin e komunës dhe ndan fonde për ZKK-në dhe aktivitetet e saj. Komuna përgatit plani vjetor të punës dhe cakton buxhetin për implementimin e tyre. Ajo ka përgatitur planin vjetor të punës në fushën e arsimit, infrastrukturës dhe aktiviteteve kulturore-sportive. Gjithsej 4.1% e buxhetit komunal është caktuar për ZKK-në, ku përfshihen rrogat për personelin e zyrës dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime. Nga ky buxhet mbështeten projektet që kanë të bëjnë me rekonstruktimin e rrugëve, shtëpive dhe financohen ngjarjet e ndryshme kulturore, të organizuara nga komunitetet. Deri më tani, komuna e Prishtinës/ Priština nuk ka alokuar ndonjë buxhet të posaçëm për nevojat e komuniteteve RAE.

⁵¹ Neni 47 i statutit të komunës së Prishtinës/Priština.

⁵² Ibid.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Komuna e Prishtinës/Priština nuk ka program apo politikë të posaçme për regjistrimin e qytetarëve nga radhët e komuniteteve pakicë të cilët nuk janë regjistruar në regjistrin civil.

Në komunën e Prishtinës/Priština nuk ka vendbanime jozyrtare. Problemet pronësore janë shqetësim i vazhdueshëm për pjesëtarët e komunitetit RAE. Ata nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar se janë pronarë të pronave të veta. Komuna nuk përzihet në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pronësore.

Informimi dhe vetëdijesimi – Komuna dhe ZKK-ja në Prishtinë/Priština janë mirë të informuara mbi Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, gjatë periudhës 2009-2015. ZKK-ja bashkëpunon ngushtë me shoqërinë civile, para së gjithash në fushën e arsimit. Në të kaluarën kjo zyrë kishte bashkëpunim më të ngushtë me OJQ-të. Zyra është e hapur çdo ditë për gjithë qytetarët që kanë ndonjë problem apo shqetësim. Personeli i komunës i udhëzon dhe këshillon ata se si të veprojnë.

Në të kaluarën kishim bashkëpunim më të mirë me shoqërinë civile. Kemi arritur që t'i përmbushim me sukses një varg projektesh të ndryshme që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe problematikën e shkollimit. Më duhet të pranojë se bashkëpunimi i tashëm me shoqërinë civile është i pamjaftueshëm. OJQ-të nuk janë më të interesuara për bashkëpunim. ZKK-ja aktualisht është duke punuar vetëm me OJQ-të lokale që merren me adresimin e problemeve dhe çështjeve që kanë të bëjnë me shkollimin e fëmijëve rom, ashkalinjë dhe egjiptian.

P.V. drejtor i Zyrës komunale për komunitete në Prishtinë/ Priština
Intervistë e FDH-Kosovë, 12 maj 2009.

1.2.5 Graçanica/Gračanica

Gračanica/Gračanica është enklava më e madhe serbe dhe rome brenda komunës së Prishtinës/Priština. Fshati shtrihet rreth 13 km në jug të Prishtinës/Priština. Nuk ka statistika të sakta për popullsinë e Graçanicës/Gračanica. Para konfliktit të vitit 1999, Priština/Priština ishte qytet multietnik. Pas konfliktit, pjesëtarët e komunitetit rom dhe serb u larguan nga qyteti dhe pjesa më e madhe e tyre u vendos në Graçanicë/Gračanica, e cila dikur ishte një qytezë e vogël ndërsa tani është shndërruar në një nga vendbanimet më të mëdha serbe jashtë veriut të Kosovës. Në rrethinat e Graçanicës/Gračanica ka vendbanime të vogla me popullsi serbe dhe rome, siç është Laplja Sella/Llapje Selo, Preoqa/Preoce.⁵³ Si shteti i Kosovës ashtu edhe strukturat paralele serbe të arsimit ofrojnë të gjitha nivelet e shkollimit (parashkollor, fillor, të mesëm dhe universitar). Por, komunitetet kanë hasur shumë vështirësi dhe sfida kur bëhet fjalë për shkollimin e tyre. Problemi më i madh është infrastruktura e keqe shkollore (mungesa e objekteve shkollore; ka raste kur i njëjti objekt shërben si shkollë fillore, e mesme dhe universitet), mungesa e pajisjeve (librave shkollore, kompjuterëve etj). Studentët kanë probleme për të udhëtuar nga fshatrat përreth deri në Graçanicë/Gračanica sepse nuk ka numër të mjaftueshëm të autobusëve shkollorë. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit serb dhe rom kërkojnë ndihmë dhe përkujdesje mjekësore në institucionet paralele shëndetësore serbe në Laplje Selë/Llapje Sello dhe Graçanicë/Gračanica. Komunitetet tjera trajtohen në institucionet zyrtare shëndetësore. Të gjithë pacientët, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare, kanë qasje

⁵³ ECMI- <http://www.ecmi-map.commap.com>.

në shërbimet shëndetësore. Sidoqoftë, ka pasur disa raporte se disa pjesëtarë të komunitetit serb dhe rom që jetojnë në pjesët rurale të komunës kanë pasur probleme për të arritur deri te institucionet shëndetësore, për shkak të mungesës së transportit publik.⁵⁴

Zyra nën-komunale në Graçanicë/Gračanica punëson njëzet e një (21) zyrtarë, nëntëmbëdhjetë (19) prej të cilëve janë serbë, një (1) është shqiptar dhe një (1) ashkali.⁵⁵

Sipas statutit të komunës së Prishtinës/Priština, zyra komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica është themeluar dhe funksionon si nën-zyrë⁵⁶ për komunitete.

Komiteti për komunitete (KK) i komunës së Prishtinës/ Priština mbulon edhe Graçanicën/Gračanica. Zyra nën-komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica përcjellë shqetësimet dhe problemet që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të pakicave dhe përmirësimin e gjendjes së tyre. KK i Kuvendit komunal të Prishtinës/Priština luan rol të posaçëm në adresimin e nevojave të pakicave. Komiteti për komunitete në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën nën-komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica ka lehtësuar mbarëvajtjen e disa projekteve që synojnë përmirësimin e gjendjes së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, duke përmirësuar infrastrukturën rrugore, përmes projekteve në fushën e arsimit dhe iniciativave të ndryshme kulturore. Komuna ka mbështetur rekonstruktimin e rrugëve, instalimet e sistemeve të kanalizimit dhe furnizimit me ujë në Mahllën e romëve /Romska Mahala. Dy mësues janë punësuar në nivelin para-shkollor në Graçanicë/ Gračanica.

KK i Prishtinës/Priština është organi i vetëm që merret me rregullat, rregulloret dhe politikat e shkruara që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave në nivel komunal. Ky organ bënë rekomandime gjatë hartimit të këtyre rregulloreve dhe monitoron implementimin të tyre më pas.

P.V. drejtor i Zyrës nën-komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica

Intervistë e FDH-Kosovë, 3 qershor 2009.

Zyra nën-komunale për komunitete (ZKK) – statute i komunës⁵⁷ rregullon themelimin, mandatin dhe funksionimin e kësaj zyre si pjesë përbërëse e komunës. Zyra mbështetet nga buxheti komunal. Sipas statutit, zyra punon në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave, sigurimin e qasjes së barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivel komunal dhe promovimin e drejtpërdrejt të parimeve anti-diskriminuese.⁵⁸ Kjo zyrë ka rol shumë të rëndësishëm kur trajtohen çështjet e të drejtave të pakicave në Komitetin për komunitete dhe Kuvendin komunal të Prishtinës/ Priština. Zyra nën-komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica ka tre (3) të punësuar- një (1) shqiptar dhe dy (2) serbë. Mandati i saj është të bashkëpunojë me KK dhe drejtoritë komunale dhe të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve për problemet që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave në fushat e sigurisë, lirisë së lëvizjes, përdorimit të gjuhës dhe përmirësimit të kushteve të jetesës në Graçanicë/ Gračanica. Zyra ka ndihmuar në implmentimin e projekteve të ndryshme, të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe gjendjes së përgjithshme të pakicave. E arritura më e madhe e kësaj zyre është krijimi i Qendrës kulturore, qëllimi i së cilës është

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ P.V. drejtor i nën-zyrës komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica ,Intervistë e FDH-Kosovë, 3 qershor 2009.

⁵⁶ Neni 47.5 i statutit të komunës së Prishtinës/ Priština.

⁵⁷ Neni 47.5 i statutit të komunës së Prishtinës/ Priština.

⁵⁸ Ibid.

bashkimi i njerëzve me prejardhje dhe kultura të ndryshme, posaçërisht njerëzve të rinj, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndër-etnik përmes organizimit të ngjarjeve kulturore. Zyra gjithashtu ofron ndihmë edhe në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për pensionim, ndihmë sociale dhe përkujdesje shëndetësore.

Të arriturat e zyrës tonë janë të dukshme dhe të prekshme në Mahallën e romëve/Romska Mahala, ku zyra ka ndihmuar rekonstruktimin e rrugëve dhe instalimin e rrymës elektrike dhe ujësjellësit. Themelimi i Qendrës kulturore në Graçanicë/Gračanica ishte projekt i rëndësishëm së veçantë, jo vetëm për ne por edhe për gjithë qytetarët. Jemi shumë të lumtur që ia dolëm ta përfundojmë projektin në fjalë. Tash, rinia e këtij rajoni mund të marrë pjesë në aktivitetet kulturore dhe sportive.

P.V. drejtor i Zyrës nën-komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica
Intervistë e FDH-Kosovë, 3 qershor 2009.

Buxheti dhe projektet – Kuvendi komunal i Prishtinës/Priština ndanë buxhet për Zyrën nën-komunale për komunitete, sikurse edhe për të gjitha projektet tjera që kanë të bëjnë me minoritet në Graçanicë/Gračanica. Buxheti i nën ZKK-së në Graçanicë/Gračanica është 0.4% e buxhetit të përgjithshëm komunal të Prishtinës/Priština. Ky buxhet ndahet për nevojat e gjitha komuniteteve. ZKK-ja në Graçanicë/Gračanica këtë vit planifikon të shpenzojë 20% të buxhetit të saj për adresimin e shqetësimeve dhe përmirësimin e gjendjes së komunitetit RAE.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Autoritete komunale të Graçanicës/ Gračanica nuk janë të përfshira në ndonjë program të posaçëm apo në hartimin e ndonjë politike për regjistrimin e qytetarëve të paregjistruar në regjistrin civil.

Për momentin në Graçanicë/Gračanica ka dy qendra kolektive të banuara nga serbët e Kosovës (IDPs). Zyra e komuniteteve dhe autoritetet komunale janë duke punuar për legalizimin e këtyre qendrave. Në Graçanicë/Gračanica ekzistojnë edhe rreth 200-300 vendbanime më të vogla joformale.

Sikurse gjithkund tjetër nëpër Kosovë, problemet më të mëdha me të cilat ndeshen pjesëtarët e komunitetit RAE edhe në këtë komunë janë papunësia dhe mungesa e dokumenteve të pronës. Autoritete komunale nuk janë përfshirë në kontestet pronësore.

Informimi dhe vetëdijesimi – Autoritetet komunale në Graçanicë/Gračanica nuk janë të informuar për Strategjinë mbi integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, gjatë periudhës 2009 - 2015. Nën-zyra komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica organizon mbledhje të rregullta mujore me qytetarët e këtij rajoni. Nën-zyra komunale për komunitete ia përcjell Komitetit për komunitete dhe Kuvendit komunal problemet, shqetësimet dhe konkluzionet që dalin nga këto mbledhje. Zyra bashkëpunon ngushtë me shoqërinë civile, në radhë të parë me OJQ-të vendore. Kjo zyrë është e hapur çdo ditë për qytetarët që t'i paraqesin problemet dhe shqetësimet e tyre.

Për punën tonë janë shumë të rëndësishme mbledhjet e rregullta me qytetarë. Këto takime janë burim i informatave të drejtpërdrejta për ne; këtu njoftohemi për të reja, problemet dhe të arriturat e qytetarëve të Graçanicës/Gračanica. Në përpiqemi vazhdimisht që t'i adresojmë nevojat dhe shqetësimet e tyre duke ia përcjellë ato institucioneve përkatëse. Mbledhjet kanë

zgjuar interesin e një numri të konsiderueshëm të qytetarëve, gjë që paraqet arsye shtesë për të vazhduar me këtë praktikë edhe në të ardhmen.

P.V. drejtori i nën-zyrës për komunitete në Gracanice/Gracanica

Intervistë e FDH-Kosovë, 3 qershor 2009.

1.2.6 Komuna e Obiliqit/Obilić

Komuna e Obiliqit/Obilić gjendet në veriperëndim të Prishtinës/Priština, në rrugën kryesore për në Mitrovicë/ Mitrovica. Komuna është themeluar në vitin 1989. Me herët, Obiliqi/ Obilić ishte pjesë e komunës së Prishtinës/Priština. Komuna përbëhet nga 19 fshatra dhe qyteza e Obiliqit/Obilić. Numri i banorëve vlerësohet të jetë 30.000. Shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën e popullsisë (rreth 25.000), kurse pjesën tjetër e përbëjnë serbët e Kosovës (rreth 3.400), romët (550), ashkalinjtë (300), boshnjakët (70) dhe të tjerët. Pjesa më e madhe e komuniteteve jo-shqiptare jetojnë në fshatrat Babin Most/Babimoc, Milloshevë/Miloševo, Plemetin/Plemetina, Caravodicë/Crkvena Vodica dhe qytezën e Obiliqit/Obilić. Përkundër faktit se ende ka mjaft rrugë të paasfaltuara, infrastruktura rrugore megjithatë është përmirësuar. Sa i përket furnizimit me ujë, duhet thënë se fshatrat e largëta akoma nuk janë lidhur me rrjetin kryesor të ujësjellësit. Shumë fshatra, duke përfshirë edhe Plemetin/Plemetina, nuk janë të kyçura në sistemin e kanalizimit.⁵⁹

Qendra kryesore e Mjekësisë familjare në Obiliq/Obilić kujdeset për gjithë popullsinë e komunës; sidoqoftë, serbët e kësaj komuna zakonisht kërkojnë ndihmë mjekësore në qendrat shëndetësore të Babin Mostit/Babimoc dhe Plemetinës/Plemetina, sikundër edhe në institucionet tjera paralele shëndetësore.⁶⁰ Shkollat në komunë janë të ndara etnikisht, me përjashtim të shkollës fillore në Caravodice/Crkvena Vodica, ku nxënësit shqiptarë dhe serbë shfrytëzojnë të njëjtin objekt, por vijojnë mësimin në ndërrime të ndryshme. Komuna ka nëntë shkolla fillore dhe një të mesme, ku mësojnë gjithsej 5.512 student, duke përfshirë edhe dy klasët e integruara të shkollës së mesme ekonomike dhe të mjekësisë në Plemetin/Plemetin, për nxënësit serbë. Kjo komunë ka rreth 485 nxënës serbë, 45 rom dhe 98 ashkali.⁶¹

Në Kuvendin komunal të Obiliqit/Obilić janë punësuar shtatëmbëdhjetë (17) pjesëtarë të komuniteteve pakicë, katërmëdhjetë (14) nga të cilët janë serbë, një (1) boshnjak, një (1) shqiptar (1) dhe një (1) rom. Gjatë vitit 2008 dhe 2009, në komunën e Obiliqit/ Obilić janë kthyer nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia tre (3) familje serbe, dy (2) familje rome dhe dy (2) familje ashkalie.

Në shtator të vitit 2008, Kuvendi i komunës së Obiliqit/Obilić miratoi statutin komunal. Statuti rregull përdorimin e gjuhëve zyrtare, në përputhje me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve. Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera.⁶²

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti përbëhet nga anëtarët e komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Secili komunitet që jeton në komunë ka të paktën një përfaqësues.⁶³ Sipas statutit, në komitet duhet të ketë më së paku pesë

⁵⁹ OSBE-Profillet e komunave- Obiliqi/ Obilić.

⁶⁰ Departamenti komunal për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

⁶¹ Burimi: Departamenti i arsimit, sportit dhe kulturë.

⁶² Neni 40 i statutit të komunës- Obiliqi/ Obilić.

⁶³ Ibid .

(5) dhe më së shumti nëntë (9) anëtarë. Në këtë komitet janë caktuar dy (2) serbë, një (1) rom, një (1) boshnjak dhe një (1) shqiptar⁶⁴. Komiteti takohet për çdo muaj.

Në bazë të raportit të përgatitur nga MALG⁶⁵, Komiteti për komunitete i komunës së Obiliqit/Obilić gjatë vitit 2008 ka mbajtur dy (2) mbledhje, përderisa gjatë periudhës janar – mars 2009 komiteti nuk ka raportuar ndonjë mbledhje.⁶⁶ Ky komitetet ka për detyrë të monitorojë implementimin e legjislacionit, akteve nën-ligjore dhe politikave tjera që rregullojnë të drejtat e pakicave në komunën e Obiliqit/Obilić. Komiteti për komunitete gjithashtu ua përcjell shqetësimet e komuniteteve drejtorive përkatëse të komunës. Në të shumtën e rasteve kërkesat dhe ankesat e qytetarëve kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, procesin e kthimit, infrastrukturën rrugore, rrymën elektrike dhe arsimin. Mandati i komitetit është të këshillojë dhe të japë rekomandime për çështje të ndryshme. Ky organ nuk ka të drejtë të vendosë për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave dhe problemet tjera.

Komiteti për komunitete mblidhet për çdo muaj; ai ka mandat të monitorojë gjendjen e të drejtave të pakicave dhe të rishikojë kërkesat dhe ankesat që vijnë nga komunitetet pakicë. Komiteti nuk ka të drejtë të vendosë në lidhje me ankesat në fjalë, por i adreson shqetësimet e ngritura nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë në drejtoritë përkatëse komunale.

M.P.M. zyrtar i Zyrës komunale për komunitete në Obiliq/Obilić

Intervistë e FDH-Kosovë, 27 maj 2009.

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – statuti i komunës rregullon themelimin, mandatin dhe funksionimin e kësaj zyre, e cila është pjesë përbërëse e komunës. Sipas statutit, zyra është përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave dhe sigurimin e qasjes së barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivel komunal. Për momentin, ZKK-ja në Obiliq/Obilić ka një personel prej katër anëtarësh, dy (2) serbë, një (1) rom dhe një (1) boshnjak. Kjo zyrë ka mandat të bashkëpunojë me të gjitha drejtoritë komunal dhe të mbrojë dhe promovojë të drejtat e pakicave përmes aktiviteteve të ndryshme. Kjo zyrë merr pjesë rregullisht në mbledhjet e Komitetit për komunitete dhe Kuvendit komunal. Kryetari i ZKK-së në Obiliq/Obilić është edhe anëtarë i Bordit komunal të drejtorëve, në përputhje me kërkesat që dalin nga statuti i komunës.⁶⁷

Për çdo vit zyra përgatit planin e saj të veprimit, i cili mbulon fushat e arsimit, kulturës dhe çështjet që kanë të bëjnë me rekonstruktimin dhe infrastrukturën. ZKK-ja i propozon kuvendit buxhetin e nevojshëm për implementimin e planit të saj të veprimit dhe buxhetin për funksionimin e zyrës. ZKK-ja në Obiliq/Obilić kishte si prioritet ndërtimin dhe furnizimin e dy (2) soliterëve në lagjen e Plemetit/Plemetin. Në këto dy ndërtesa janë akomoduar gjithsej 59 familje rome, egjiptiane dhe ashkalie. ZKK-ja ka ndihmuar gjithashtu edhe procesin e kthimit.

Akomodimi i (59) familjeve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në këto dy soliterë ka përmirësuar në mënyrë të drejtpërdrejt kushtet e jetesës së këtyre qytetarëve fatlum. Të gjithë ata u janë mirënjohës autoriteteve komunale. Ne jemi të vetëdijshëm se kjo nuk i zgjidh të gjitha

⁶⁴ Myrvete Paluji-Mjekiqi – zyrtare në Zyrën për komunitete të Obiliqit/Obilić, Intervistë e FDH-Kosovë, 27 maj 2009.

⁶⁵ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar - djeto2008, mars 2009

⁶⁶ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar- mars 2009, mars 2009.

⁶⁷ Neni 60.1 i statutit të komunës së- Obiliqit/Obilić.

problemet, por jemi të mendimit se realizimi i këtij projekti është e arritura më e madhe e ZKK së Obiliqit/Obilić.

M.P.M. zyrtar i Zyrës për komunitete të Obiliqit/ Obilić

Intervistë e FDH-Kosovë, 27 maj 2009

ZKK-ja gjithmonë përgatit projekt buxhetin për nevojat e veta dhe për implementimin e projekteve të ndryshme që synojnë përmirësimin e gjendjes së pakicave që jetojnë në komunë. Deri tani, Kuvendi komunal e ka pranuar buxhetin e propozua nga zyra jonë.

E.D. drejtor për buxhet dhe financa në Obiliq/ Obilić

Intervistë e FDH-së, 27 maj 2009

Buxheti dhe projektet- Kuvendi komunal për çdo vit miraton buxhetin komunal. Për funksionimin e ZKK-së është ndarë një buxhet prej 214.328 euro ose 19% e buxhetit të përgjithshëm të komunës së Obiliqit/Obilić. Këtu janë llogaritur edhe rrogat e personelit, mallrat dhe shërbimet.⁶⁸ Buxheti i lartpërmendur gjithashtu shfrytëzohet edhe për rekonstruktimin e rrugëve, riparimin e rrjetit elektrike dhe projektet që kanë të bëjnë me shërbimet komunale. Gjatë vitit 2008/2009, komuna ka mbështetur rindërtimin e rrugëve, instalimin e rrymës elektrike dhe sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatrat e banuara nga anëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto fshatra janë Palaj/Palaj, Janina/Janina, Banjofc/Banjofc, Milloshevë/Milosevo dhe Mazgit/Mazgit.⁶⁹

Komuna e Obiliqit/Obilić nuk ka ndarë buxhet të posaçëm për nevojat e romëve, egjiptianëve dhe ashkalinjëve. Sidoqoftë, duket se përmirësimi i gjendjes së këtyre komuniteteve është prioritet për autoritete komunale.

E drejta në pronë dhe vendbanimet joformale – Komuna e Obiliqit/Obilić nuk ka program të posaçëm për regjistrimin e personave të paregjistruar. Në këtë komunë ka disa vendbanime jozyrtare. Të gjitha ato janë multi-etnike ku jetojnë shqiptarët, romët, ashkalinjtë, serbët dhe boshnjakët.

Autoritetet komunale të Obiliqit/Obilić po punojnë në drejtim të identifikimit të numrit të saktë të vendbanimeve jozyrtare dhe në të njëjtën kohë po hartojnë planin për përshejtimin e procesit të legalizimit të këtyre vendbanimeve.

Shkalla e lartë e papunësisë dhe mungesa e dokumenteve mbi pronësinë janë problemet më të mëdha të komunitetit RAE. Administrata komunale pohon se ajo nuk ka për detyrë zgjidhjen e problemeve pronësore.

Informimi dhe vetëdijësimi – ZKK-ja dhe autoritetet komunale në Obiliq/Obilić janë të njohur me Strategjinë për integrimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve, gjatë periudhës 2009-2015. Komuna ka ndërmarrë hapa dhe masa në përputhje me kornizën ligjore dhe planet e veprimit. Zyra është e hapur për çdo ditë për të gjithë qytetarët për t'i ngritur shqetësimet dhe problemet e tyre. Personeli i ndihmon ata duke i udhëzuar dhe këshilluar se si t'i zgjedhin problemet. ZKK-ja në Obiliq/Obilić bashkëpunon ngushtë me shoqërinë civile. Ato kanë punuar

⁶⁸ 42.728 euro- shpenzime për rrogat e personelit (17 të punësuar), 18.100 euro mallra dhe shërbime, 1.500 euro – shpenzime komunale, 152 euro- investime kapitale- Buxheti komunal i Obiliqit/Obilić për vitin 2009.

⁶⁹ M.K. – drejtor i drejtorisë për urbanizëm në komunën e Obiliqit/ Obilić – Intervistë e FDH-Kosovë, 27 maj 2009.

së bashku në projekte të ndryshme në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe kanë mbështetur procesin e kthimit. Kjo zyrë bashkëpunon me UNDP, Mercy Corp, OSCE dhe UNHCR.

1.2.7 Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje

Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje ndodhet 8 km në jugperëndim të Prishtinës/ Priština. Ajo përbëhet nga 17 fshatra dhe qyteza e Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Tre fshatra janë të banuara nga komuniteti serb (Ugljarja/Uglar, Kuzmini/Kuzmin dhe Batusha/Batuše), përderisa fshatrat Bresje/Bresje dhe qyteza e Fushë Kosovës/Kosovo Polje janë multietnike. Kjo komunë ka 50.000 banorë. Përpos shqiptarëve që përbëjnë shumicën dërmuese të popullsisë (85%), në Fushë Kosovë/Kosovo Polje jeton edhe një numër i konsiderueshëm i komuniteteve pakicë: 3.800 ashkalinjë, 2.800 serbë, 600 rom, 200 egjiptianë, 40 boshnjakë dhe 30 goranë. Para konfliktit të vitit 1999, serbët përbënin 25% të popullsisë. Sidoqoftë, vlerësohet se ata sot përbëjnë 8% të popullsisë së komunës. Sipas UNHCR-së, nga vitit 2000 në Fushë Kosovë/Kosovo Polje janë kthyer 1452 persona të zhvendosur brenda Kosovës (888 ashkalinjë dhe egjiptianë, 382 serbë dhe 182 rom). Bazuar në informatat nga Zyra komunale për komunitete, gjatë vitit 2009 në komunën e Fushë Kosovë/Kosovo Polje janë kthyer për të jetuar dy (2) familje rome dhe katër (4) familje ashkalie.

Përkundër përpjekjeve që ka bërë komuna për të unifikuar sistemin shëndetësor, institucionet shëndetësore ende janë të ndara. Shqiptarët, ashkalinjtë dhe egjiptasit kërkojnë përkujdesje dhe trajtim mjekësor në Qendrën e mjekësisë familjare në Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe 11 qendrat tjera shëndetësore nëpër fshatrat përreth. Serbët dhe romët e Fushë Kosovës/Kosovo Polje trajtohen në Qendrën shëndetësore të fshatit Ugljar/ Uglare, sikurse edhe në qendrat tjera të sistemit primar shëndetësor në Kuzmin/Kuzmin dhe Batushë/ Batusha. Komuna, komuniteti serb dhe UNMIK-u⁷⁰ janë duke zhvilluar bisedime për ngritjen e një qendre të re shëndetësore në fshatin Bresje/ Bresje.

Sistemi arsimor në komunë është gjithashtu i ndarë. Në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje ka një objekt për fëmijët para-shkollor, gjashtë shkolla fillore dhe tre shkolla të mesme ku mësojnë fëmijët shqiptarë, ashkalinjë dhe egjiptianë. Sistemi paralel arsimor serb përbëhet nga një objekt për fëmijët parashkollor dhe pesë shkolla fillore, të cilat financohen nga Qeveria e Serbisë. Në këto shkolla mësojnë nxënësit serbë dhe romë. Ekziston vetëm një shkollë multi-etnike në këtë komunë, e cila u shkatërrua gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, por që u rindërtua përsëri, e cila grumbullon fëmijët e të gjitha komunitetet.⁷¹

Në Asamblenë komunale të Fushë Kosovë/Kosovo Polje janë punësuar gjashtë (6) anëtarë të komuniteteve pakicë: tre (3) serbë, dy (2) ashkali dhe një (1) rom.

Kuvendi komunal i Fusha Kosovës/Kosovo Polje ka miratuar statutin e komunës më 15 tetor 2008. Statuti garanton përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunikim verbal dhe të shkruar me organet komunale, në përputhje me kërkesat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.⁷² Me statut është

⁷⁰ Drejtori për shëndetësi, kryetari i Kuvendit komunal dhe zyrtari komunal për komunitete.

⁷¹ Drejtori për arsim dhe zyrtari komunal për komunitete.

⁷² Neni 8 i statutit të komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

paraparë krijimi i komiteteve të përhershme⁷³ dhe drejtorive për komunitete, të cilat e kanë zëvendësuar Zyrën komunale për komunitete.⁷⁴

Komiteti për komunitete (KK) – është një prej komiteteve të përhershme të komunës. KK përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe nga përfaqësuesit e komuniteteve që jetojnë në këtë komunë. Secili komunitet i kësaj komune është përfaqësuar me të paktën një përfaqësues.⁷⁵ Statuti i komunës nuk e përcakton numrin e anëtarëve të Komitetit për komunitete. Në Komitetin për komunitete të Fushë Kosovës/Kosovo Polje janë caktuar shtatë (7) anëtarë: tre (3) shqiptarë, dy (2) serbë, një (1) rom dhe një (1) egjiptian.⁷⁶ Ky komunitet takohet varësisht nga zhvillimet dhe nevojat e komuniteteve. Bazuar në zyrтарin e Zyrës komunale për komunitete, komiteti nuk mban mbledhje të rregullta.⁷⁷

Sipas raportit të MALG-ut⁷⁸ Komiteti për komunitete i Fushë Kosovë/Kosovo Polje u mbledh vetëm një (1) herë gjatë vitit 2008, përderisa gjatë periudhës janar-mars 2009 komitet u mbajti dy (2) mbledhje.⁷⁹

Mandati i tij është të mbrojë dhe promovojë të drejtat e pakicave në nivel komunal. Detyra kryesore e KK është të sigurojë se të gjitha politikat dhe vendimet e komunës që rregullojnë fushën e të drejtave të pakicave janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe interesat më të mira të komuniteteve që jetojnë në këtë komunë. Komiteti për komunitete rekomandon masat që duhet ndërmarrë komuna, me qëllim të promovimit të identitetit etnik, kulturor, religjioz dhe gjuhëve të të gjitha komuniteteve.⁸⁰ Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve në përgjithësi kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, procesin e kthimit, infrastrukturën rrugore, energjinë elektrike dhe arsimimin.

Nuk ka ndonjë rregull të caktuar sa i përket mbledhjeve të komitetit për komunitete. Detyra e tyre është monitorimi i të drejtave të pakicave. Komiteti gjithashtu shqyrton kërkesat dhe ankesat e dorëzuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë, pjesa më e madhe e të cilave ka të bëjë me problemet ditore si papunësia, problemet me furnizim me energji elektrike, procesin e kthimit, arsimimin, etj. Më pas, këto probleme të shtruara diskutohen me përfaqësuesit e drejtorive komunale.

H.Q. zëvendës i udhëheqësit të Zyrës komunale për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje
Intervistë e FDH-Kosovë, 29 maj 2009.

Drejtoritë për komunitete – Ish Zyra komunale për komunitete (ZKK) – përkundër faktit se sipas statutit të komunës ajo tani është riemëruar nga Zyra komunale për komunitete në Drejtori komunale për komunitete, administrata komunale dhe publiku vazhdojnë t'i referohen si ZKK. Statuti i komunës rregullon mandatin dhe funksionimin e zyrës.⁸¹ Kjo zyrë mbështet dhe

⁷³ Neni 37 i statutit të komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

⁷⁴ Neni 73 i statutit të komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

⁷⁵ Neni 39.1 i statutit të komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

⁷⁶ H.Q. zyrtar komunal i Zyrës për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje – Intervistë e FDH-Kosovë, 29 maj 2009.

⁷⁷ Ibid.

⁷⁸ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

⁷⁹ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-mars 2009, mars 2009.

⁸⁰ Neni 39.2 i statutit të komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje.

⁸¹ Neni 73 i statutit të komunës së Fushë Kosovë/ Kosovo Polje.

lehtëson integrimin e minoriteteve në shoqëri dhe ndihmon në implementimin e legjislacionit që ka të bëjë me të drejtat e pakicave, bashkëpunon me të gjitha drejtoritë e komunës në implementimin e projekteve të ndryshme që kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së pakicave, përcakton prioritetet komunale për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave. Momentalisht, ZKK në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ka pesë (5) të punësuar, tre (3) serbë, një (1) rom dhe një (1) ashkali.

Kjo zyrë ka për detyrë të bashkëpunojë me të gjitha drejtoritë komunale dhe të kontribuojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave përmes aktiviteteve të ndryshme. Ajo i inkurajon qytetarët t'i paraqesin problemet dhe shqetësimet e tyre.

H.Q. zëvendës i udhëheqësit të Zyrës për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje
Intervistë e FDH-Kosovë, 29 maj 2009.

Zyra harton planin e veprimit për çdo vit, i cili kryesisht përqendrohet në fushën e arsimit, infrastrukturës, mbrojtjes shëndetësore dhe kulturës. Vitin e kaluar, shumica e projekteve kishin të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe instalimin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Prioritete e zyrës tani janë përqendruar në fushën e arsimit, më konkretisht në përfshirjen e fëmijëve të komunitetit rom në shkolla. Komuna deri më tani nuk ka përgatitur ndonjë politikë të posaçme për integrimin më të mirë të komunitetit rom, ashkai dhe egjiptas në shoqërinë kosovare.

Gjatë vitit të kaluar ne kemi bërë përpjekje të mëdha dhe kemi shpenzuar shuma të mëdha në rindërtimin e rrugëve, instalimin e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe riparimin e rrjetit elektrik. Projektet në ndihmë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian tani janë përqendruar në fushën e shkolllimit. Ne kemi organizuar ngjarje të ndryshme kulturore për të rinjtë, siç janë dramat. Kemi vendosur bashkëpunim shumë të mirë me OSBE-në dhe UNICEF-in në fushën e implementimit të programeve arsimore që kanë të bëjnë me luftën kundër analfabetizmit në mesin e këtyre komuniteteve.

M. B. zyrtar komunal në Zyrën për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje
Intervistë e FDH-Kosovë, 29 maj 2009.

Buxheti dhe projektet – asambleja komunale miraton për çdo vit buxhetin komunal. Rreth 19% e buxhetit komunal ndahet për nevojat e komuniteteve pakicë. Buxheti në fjalë shfrytëzohet për rindërtimin e rrugëve, përmirësimin e rrjetit elektrik dhe shërbimeve komunale. Vetëm për funksionimin e ZKK është ndarë një buxhet prej 19.982 euro, ku janë përfshirë edhe rrogat e punëtorëve dhe mallrat/shërbimet. Investimet kapitale nuk janë përfshirë në këtë buxhet. Gjatë viteve 2008 dhe 2009, komuna ka mbështetur rindërtimin e rrugëve në lagjen “Mahalla e romëve 07”. Përmes këtij projekti janë rregulluar rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe u rinovua sistemi elektrik në “Rrugën 29”. Të dyja këto lagje janë të banuara nga pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.⁸² Zyrtarët e ZKK në Fushë Kosovë/Kosovo Polje janë përfshirë në fushatën për vetëdijësimin femrave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian sikurse edhe fushatën për planifikimin e familjes dhe kundër dhunës në familje.

⁸² R.J. drejtor i drejtorisë për buxhet, financa dhe ekonomi në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Intervistë e FDH-Kosovë, 29 maj 2009.

Gjatë vitit 2008 dhe 2009 ne kemi ndërmarrë dy fushata. Fushata e parë është organizuar në bashkëpunim me UNICEF-in dhe kishte të bëjë me të drejtat e fëmijëve dhe qasjen e tyre në sistemin arsimor, e cila kishte për synim regjistrimin e sa më shumë fëmijëve në shkollë. Grupet e caktuara të fushatës ishin prindërit dhe fëmijët e këtyre komuniteteve. Fushata e dytë është lansuar dhe implementuar në bashkëpunim me organizatën “Ballkan Sun-Floëers” dhe kishte për qëllim arsimimin shëndetësor të grave dhe vajzave të këtyre komuniteteve mbi kujdesin shëndetësor gjinekologjik, çështje të higjienës personale, planifikimin.

M. B. zyrtar komunal në Zyrën për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje

Intervistë e FDH-Kosovë, 29 maj 2009.

Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje nuk ka ndarë buxhet të veçantë për nevojat e komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje nuk ka program të posaçëm për regjistrimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të cilët nuk janë regjistruar. Në këtë komunë nuk ka vendbanime jozyrtare.

Shkalla e lartë e papunësisë dhe mungesa e dokumenteve të pronësisë janë problem kryesor i komuniteteve pakicë. Administrata komunale nuk e ka obligim e as që ka dëshirë të përfshihet në mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me çështje të pronësisë, megjithëse e kanë bërë të qartë se ato janë të gatshme të mbështesin pjesëtarët e këtyre komuniteteve në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me komunën.

Informimi dhe vetëdijesimi – personeli i ZKK në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ishte aktiv në hartimin e Strategjisë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, gjatë periudhës 2009 - 2015. ZKK është e informuar mirë në lidhje me standardet dhe prioritetet e kësaj strategjie. Zyrtarët e ZKK-së besojnë se është me rëndësi organizimi i debateve dhe informimi i komuniteteve për strategjinë në fjalë. Kjo zyrë është e hapur për të gjithë qytetarët që t'i adresojnë problemet dhe shqetësimet e tyre. Zyrtarët e ZKK-së i udhëzojnë dhe këshillojnë qytetarët se si të veprojnë në procedimin e ankesave të tyre. ZKK-ja në Fushë Kosovë/ Kosovo Polje bashkëpunon ngushtë me shoqërinë civile sikurse edhe me organizatat lokale dhe ndërkombëtare. Vlen të përmendet bashkëpunimi që kanë pasur me OSBE-në, UNICEF-in, Qendrën kulturore-rinore dhe Luledielli i Ballkanit, në realizimin e projekteve të ndryshme dhe fushatave të vetëdijesimit.

1.2.8 Komuna e Lipjanit/ Lipljan

Komuna e Lipjanit/Lipljan ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshinë një sipërfaqe prej 422 kilometra katrorë. Komuna përfshinë qytezën dhe 71 fshatra; 52 fshatra banohen ekskluzivisht nga shqiptarët, gjashtë nga serbët, kurse 13 fshatra sikurse dhe qyteza e Lipjanit/Lipljan kanë popullsi të përzier. Kjo komunë ka një popullsi prej 76.000 banorësh, shumica e të cilëve janë shqiptarë (83% apo 64.600), përdërisa komunitetet pakicë përbëjnë 17 % të popullsisë; llogaritet se në këtë komunë jetojnë rreth 9.500 serbë, 1.500 ashkalinjë, 360 kroatë, 330 rom dhe të tjerë. Ka pasur disa raste të kthimit spontan/individual të serbëve të Kosovës, përdërisa kthimi i refugjatëve romë, ashkalinjë dhe egjiptian ka qenë më i organizuar dhe ka dhënë fryte.⁸³

⁸³ Raport i OSBE-së-Profilet e komunave- Lipjan/ Lipljan.

Në komunën e Lipjanit/Lipljan janë aktive dy sisteme shëndetësore. Shqiptarët kërkojnë ndihmë dhe përkujdesje mjekësore në Qendrën e mjekësisë familjare në Lipjan/Lipljan, përderisa serbët shfrytëzojnë shërbimet që ofrojnë institucionet shëndetësore të kontrolluara nga serbët. Këto qendra shëndetësore ofrojnë shërbime të kufizuara, prandaj në rast të urgjencave mjekësore shqiptarët dhe ashkalinjtë referohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë/Priština, kurse serbët dhe romët në spitalin e Laplja Sellës/Llapje Sello ose të Mitrovicës/Mitrovica. Komuna ka dy kopshte (njëri shfrytëzohet nga shqiptarët dhe tjetri nga serbët), 20 shkolla fillore ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, tre shkolla ku mësohet në gjuhë serbe dhe një shkollë për komunitetin kroat në Janjevë/Janjevo. Komuna ka tre shkolla të mesme: Gjinnazin dhe Shkollën e mesme profesionale (me dy nëndegë) ku mësojnë nxënësit shqiptarë dhe një shkollë të mesme për nxënësit serb me një nëndegë. Dhjetë (10) serbë dhe dyzetë e tre (43) egjiptian dhe ashkalinjë janë kthyer në Lipjan/Lipljan⁸⁴ nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, gjatë viteve 2008 - 2009.

Më 26 shtator 2008, Kuvendi komunal i Lipjanit/ Lipljan miratoi statutin e komunës. Statuti garanton parimet anti-dikriminuese dhe shfrytëzimi e gjuhëve zyrtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me Ligjin kundër diskriminimit dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve.⁸⁵ Administrata komunale e Lipjanit/ Lipljan gjithashtu ka lëshuar rregulloren komunale⁸⁶ e cila rregullon detajisht përdorimin e gjuhëve në nivel komunal. Statuti parasheh krijimin e komuniteteve të përhershme dhe komuniteteve tjera.⁸⁷ Në Kuvendin komunal të Lipjanit/Lipljan janë të punësuar shtatëmbëdhjetë (17) serbë, katër (4) romë, pesë (5) pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe egjiptian dhe një (1) boshnjak.

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve. çdo komunitet që jeton në komunë është përfaqësuar nga të paktën një përfaqësues.⁸⁸ Komiteti i tanishëm përbëhet nga tre (3) serbë, tre (3) shqiptarë, një (1) rom, një (1) ashkali dhe një (1) kroat⁸⁹. Komiteti mblidhet për çdo muaj sikurse, kurse sipas nevojës edhe në baza ad-hoc.

Sipas MALG raportit⁹⁰, KK i komunë së Lipjanit/Lipljan gjatë vitit 2008 mbajti dy (2) mbledhje, përderisa gjatë periudhës janar-mars 2009 komiteti u takua pesë (5) herë.⁹¹

Ky komitet bënë monitorimin e implemenimit të legjislacionit dhe dokumenteve të shkruara që sigurojnë respektimin e të drejtave të pakicave në komunën e Lipjanit/Lipljan. Detyra e saj kryesore është të sigurojë se të gjitha politikat dhe vendimet e komunës që rregullojnë fushën e të drejtave të pakicave janë në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe interesat më të mira të komuniteteve të kësaj komune. Komiteti për komunitete gjithashtu rekomandon masat e nevojshme që duhet ndërmarrë komuna me qëllim që të promovojë identitetin etnik, kulturor, religjioz dhe gjuhësor të komuniteteve të ndryshme.⁹² Përpos kësaj, KK i Lipjanit/ Lipljan është i

⁸⁴ Ibid.

⁸⁵ Neni 3 dhe 12 i statutit të komunës së Lipjanit/Lipljan.

⁸⁶ Rregullorja e brendshme mbi përdorimin e gjuhëve në komunë- 29 maj 2009.

⁸⁷ Neni 33 dhe 35 i statutit të komunës së Lipjanit/Lipljan.

⁸⁸ Ibid.

⁸⁹ Intervistë me L.J, udhëheqës i Zyrës për komunitete në Lipjan/Lipljan, Intervistë e FDH-Kosovë, 25 maj 2009.

⁹⁰ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

⁹¹ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-mars 2009, mars 2009.

⁹² Neni 35 i statutit të komunës së Lipjanit/ Lipljan.

përfshirë në përgatitjen e buxhetit për nevojat dhe funksionimin e ZKK dhe projektet e saja që kanë të bëjnë me gjendjen dhe të drejtat e komuniteteve pakicë në komunë.

Komiteti ia përcjellë drejtorive përkatëse shqetësimet e ngritura nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Në përgjithësi, kërkesat dhe ankesat e qytetarëve kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, procesin e kthimit, infrastrukturën rrugore, furnizimin me energji elektrike dhe arsimimin.

Komiteti për komunitete mbledhet rregullisht për çdo muaj, nganjëherë edhe më shpesh. Mandate i saj është të sigurojë se të gjitha aktivitetet e komunës janë në përputhje me standardet për të drejtat e njeriut dhe legjislacionin e zbatueshëm. Komiteti ka për qëllim të përmirësojë e gjendjen e pakicave në komunën tonë dhe të promovojë dhe mbrojë këto të drejta. Procesi i kthimit ishte barrë e madhe jo vetëm për punën e këtij organi, por edhe për komunën në përgjithësi. Komiteti gjithashtu ndihmon pjesëtarët e komuniteteve duke i këshilluar apo udhëzuar se si dhe ku t'i adresojnë shqetësimet e tyre..

L.J. kryetar i Zyrës për komunitete në Lipjan/Lipljan
Intervistë e FDH-Kosovë, 4 qershor 2009.

t

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – Në bazë të statutit, ZKK ka status special dhe funksionon brenda Zyrës së kryebashkiakut⁹³, pa përcaktuar strukturën dhe mandatin e saj. Sipas zyrtarëve të ZKK-së, kjo zyrë është përgjegjëse për monitorimin e të gjitha projekteve që kanë të bëjnë me çështjet e pakicave, promovimin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe sigurimin e qasjes së barabartë të minoriteteve në shërbimet publike të nivelit komunal në arsim, shëndetësi dhe punësim. Në ZKK-në e Lipjanit/Lipljan janë të punësuar 15 persona: trembëdhjetë (13) serbë dhe një (1) ashkali. Mandati i kësaj zyre është të monitorojë implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes së komuniteteve pakicë dhe promovimin e të drejtave të pakicave në komunë. Kjo zyrë ishte e përfshirë në procesin e kthimit, duke mbështetur autoritetet komunale dhe palëve tjera me interes në përpjekjet e tyre për të arritur kthim të qëndrueshëm të refugjatëve apo personave të zhvendosur brenda Kosovës, përmes rindërtimit të shtëpive dhe stimulimit të mikro-bizneseve. Kjo zyrë harton planin e saj të veprimit për çdo vit dhe cakton prioritetet e aktiviteteve vjetore. Zyra ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në infrastrukturë, përkujdesje shëndetësore dhe arsim. Për momentin, kjo zyrë është duke hartuar strategjinë për kthim të qëndrueshëm, e cila i kushton më shumë vëmendje sigurimit të ambientit miqësor dhe krijimit të parakushteve për jetë normale të të kthyerve, siç janë mundësitë e punësimit dhe shërbimet publike kualitative.

Buxheti dhe projektet – Kuvendi komunal vendos për çdo vit për ndarjen e buxhetit komunal. Ai ka ndarë 16% të buxheti të përgjithshëm për të mbuluar shpenzimet e të gjitha aktiviteteve komunale që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave. Ky buxhet mbulon shpenzimet për rrogat e punëtorëve, mallrave dhe shërbimeve. Buxheti i ndarë shfrytëzohet gjithashtu edhe për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, riparimin e rrjetit elektrik, përkujdesjen shëndetësore dhe rrjetin elektrik. Sipas autoriteteve komunale të Lipjanit/Lipljan, gjatë periudhës 2002-2007, janë ndërtuar apo rindërtuar më shumë se njëqind (100) shtëpi në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në bashkëpunim me donatorët e jashtëm. Komuna ka mbështetur rindërtimin e rrugëve, instalimin e rrjetit elektrik, renovimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.⁹⁴

⁹³ Neni 46 i statutit të komunës së Lipjanit/Lipljan.

⁹⁴ F. G. zyrtar në zyrën komunale për komunitete në Lipjan/Lipljan, intervistë e FDH--Kosovë, 4 qershor 2009.

Deri më tani aktivitetet tona kanë qenë të fokusuara në rindërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës. Në vitit 2009 ne kemi ndërtuar një shkollë për pjesëtarët e komunitetit rom të fshatit Dubrajë/ Dubraja. Gjatë vitit 2008 dhe 2009 kemi rregulluar rrugët në fshatrat Hallaq/ Hallaq dhe Mahallën e Romëve/Romska Mahalla në Lipjan/ Lipljan. Ne kemi rinovuar ambulancën në Gadime/ Gadime. Këto projekte ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e gjendjes dhe mirëqenien e komuniteteve pakicë në komunë.

F. G. Zyrtar në Zyrën komunale për komunitete në Lipjan/Lipljan

Intervistë e FDH-Kosovë, 4 qershor 2009.

Komuna e Lipjanit/ Lipljan nuk ka ndarë buxhet të posaçëm për nevojat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

E drejta në pronë dhe vendbanimet joformale – Komuna e Lipjanit/Lipljan nuk ka program për regjistrimin e popullsisë së paregjistruar. Sipas zyrtarëve të ZKK-së, Program i Kosovës për të drejta civile (CRPK)⁹⁵ ka mbështetur regjistrimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. ZKK—ja nuk ka të dhënë për numrin e personave që CRPK-ja ka ndihmuar të regjistrojë e as numrin e kërkesave për regjistrim.

Në komunën e Lipjanit/Lipljan ka dy (2) vendbanime joformale multietnike. E para gjendet në hyrje të fshatit Magurë/Magura, përderisa vendbanimi i dytë ndodhet në brendësi të qytetit, në lagjen Mostima/Mostima. Banorët e këtyre vendbanimeve janë pjesëtarë të komuniteteve RAE dhe shqiptarë. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë hap për t'i legalizuar apo për t'i shpërbërë ato, e as që ka buxhet për të trajtuar këtë problematikë.⁹⁶

Mungesa e dokumenteve pronësore është problem më i madh me të cilin ndeshet komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Ne nuk kemi ndonjë plan e as që kemi buxhet t'i legalizojmë vendbanimet joformale në komunën tonë. Përveç kësaj, disa pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian as që kanë dokumente për të provuar se janë pronarë. Komuna nuk mund t'i ndihmojë ata në këtë çështje.

L.J. udhëheqës i zyrës komunale për komunitete në Lipjan/Lipljan

Intervistë e FDH-Kosovë, 4 qershor 2009.

Informimi dhe vetëdijesimi – ZKK-ja në Lipjan/Lipljan nuk është e informuar për Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, për periudhën 2009 - 2015. Komuna ka punuar me përkushtim drejt promovimit dhe përmirësimit të statusit të komuniteteve pakicë, të bazuar në kornizën ligjore dhe prioritetet.

Komuna e Lipjanit/Lipljan është shembull i mirë i kthimit të suksesshëm të personave të zhvendosur brenda Kosovës. Ekziston një bashkëpunim i ngushtë me organizata të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare që merren me procesin e kthimit. Kjo zyrë është e hapur çdo ditë për të gjithë qytetarët që të paraqesin shqetësimet e tyre. ZKK-ja në Lipjan/Lipljan bashkëpunon ngushtë me IOM, UNDP, OSBE, UNHCR, DRC, CRPK në projektet që kanë të bëjnë me kthimin e refugjatëve, fushatës së vetëdijesimit dhe arsimin.

⁹⁵ OJQ kosovare e përfshirë në mbështetjen e regjistrimit të personave të zhvendosur brenda Kosovës duke përfshirë edhe anëtarët e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali.

⁹⁶ F.G. zyrtar në zyrën komunale për komunitete në Lipjan/Lipljan, intervistë e FDH--Kosovë, 4 qershor 2009.

1.2.9 Komuna e Ferizajit/ Uroševac

Komuna e Ferizajit/Uroševac shtrihet në pjesën jugore të Kosovës dhe mbulon një territor prej 345 kilometra katrorë. Kjo komunë përfshinë qytetin e Ferizajit/Uroševac dhe 44 fshatra. Kryesisht është komunë bujqësore. Ferizaji/Uroševac ka një popullsi prej rreth 170.000 banorësh, shumica e të cilëve, rreth 160.000, janë shqiptarë. Komunitetet tjera që banojnë në këtë komunë janë ashkalinjtë (3.758), romët (260), goranët (230), boshnjakët (68), serbët (70), turqit (40), sikurse edhe disa familje egjiptiane. Shumica e serbëve të kësaj komune janë kthyer në Kosovë pasi kanë kaluar disa vite si refugjatë apo persona të zhvendosur dhe tani jetojnë në fshatrat Bablak/Babljak, Babushi Serb/Srpski Babuš dhe Talinoc i Muhaxherëve/Muhadžer Talinovac, përderisa romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët jetojnë kryesisht në fshatin Dubravë/Dubrava dhe vendbanimet Halit Ibishi/Halit Ibiši, Sallahane/Salahane dhe Koçi Xoxe/Koçe Zoze⁹⁷.

Vlerësohet se nga dhjetori i vitit 2007 e deri më tani në këtë komunë janë kthyer 211 serbë dhe 178 pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, përderisa mendohet se rreth 150 serbë, pas një qëndrimi të shkurtër, janë larguar përsëri nga Kosova. Përpos kësaj, nga viti 2001 në Kosovë janë kthyer me dhunë nga shtetet perëndimore 125 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian⁹⁸.

Komuna e Ferizajit/Uroševac ka rrjetin e institucioneve të mjekësisë primare që përbëhet nga Qendra kryesore e Mjekësisë familjare dhe tre punkte shëndetësore. Fshatarët kërkojnë ndihmë mjekësore në nëntë punkte shëndetësore, por edhe nga ekipet mobile. Komuna ka 31 shkolla fillore. Vijimi i shkollës nga fëmijët e komunitetit ashkali, rom dhe goran është më i ulët në krahasim me vijueshmërinë e fëmijëve shqiptarë, por gjatë vitit akademik 2007/2008 janë vënë re përmirësime (904 prej 30.431 nxënësve janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë). Në komunë ka një çerdhe me 258 fëmijë. Sipas drejtorisë komunale të arsimit dhe shkencës, në sistemin arsimor të kësaj komune është punësuar personeli prej 1.770 profesionistëve dhe stafit mbështetës, duke përfshirë edhe nëntë pjesëtarë nga radhët e komuniteteve pakicë⁹⁹.

Më 26 nëntor 2008, Kuvendi komunal i Ferizajit/Uroševac miratoi statutin e komunës. Me këtë statut garantohen parime e mos-diskriminimit dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me Ligjin kundër diskriminimit dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve¹⁰⁰. Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera¹⁰¹. Në Kuvendin komunal të Ferizajit/Uroševac punojnë tetëmbëdhjetë (18) pjesëtarë të komuniteteve pakicë: dymbëdhjetë (12) ashkalinjë, tre (3) romë, një (1) serb, një (1) goran dhe një (1) turk.

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti për komunitete përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë do të përfaqësohet nga të paktën një përfaqësues¹⁰². Aktualisht, Komiteti për komunitete i komunës së Ferizajit/Uroševac përbëhet nga dy (2) shqiptarë, një (1)

⁹⁷ Departamenti i administratës dhe personelit dhe Zyra komunale për komunitete –Raport i OSBE-së – Profilët e komunave

⁹⁸ UNHCR-ja dhe Zyra komunale për komunitete – Raport i OSBE-së –Profilët e komunave

⁹⁹ Departamenti komunal për arsim dhe shkencë dhe Zyra komunale për komunitete

¹⁰⁰ Neni 10 dhe 12 i statutit të komunës së Ferizajit/Uroševac.

¹⁰¹ Neni 48 dhe 49 i statutit të komunës së Ferizajit/Uroševac.

¹⁰² Ibid

serb dhe një (1) rom.¹⁰³ Ky komitetet mban mbledhje të rregullta një herë në muaj, por mund të takohet edhe më shpesh, varësisht nga zhvillimet apo nevojat.

Bazuar në raportin e MALG¹⁰⁴, Komiteti për komunitete i komunës së Ferizajit/Uroševac u takua dy (2) herë gjatë vitit 2008, përderisa gjatë periudhës janar- mars 2009 ky komitet nuk raportoi të ketë mbajtur ndonjë mbledhje¹⁰⁵.

Komitetit ka për detyrë të sigurojë se pjesëtarët e komuniteteve pakicë nuk diskriminohen në baza etnike apo gjuhësore nga zyrtarët komunal. Krahas kësaj, komitetit siguron se të gjitha politikat dhe vendimet e komunës që rregullojnë fushën e të drejtave të pakicave janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe në interesin më të mirë të komuniteteve pakicë të kësaj komune. Komiteti për komunitete gjithashtu shqyrton shkeljet e pretenduara të të drejtave të komuniteteve pakicë dhe ia raporton ato Kuvendit komunal. Komiteti për komunitete në Ferizaj/Uroševac ishte i përfshirë në projektet nga fusha e arsimit dhe shëndetësisë.

“Komiteti për komunitete nuk mblidhet rregullisht për shkak të disa pengesave administrative që kanë ardhur si pasojë e mos kompensimit të anëtarëve të tij. Ky organ ka për detyrë të luftojë për përmirësimin e gjendjes së pakicave në komunën tonë dhe të kontribuojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.”

H.H. Kryetar i zyrës komunale për komunitete në Ferizaj/Uroševac
Intervistë e FDH-Kosovë, 14 maj 2009.

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – sipas statutit, kjo zyrë është pjesë përbërëse e administratës komunale dhe mbështetet nga buxheti komunal. Pozita e udhëheqësit të Zyrës komunale për komunitete është e barabartë me pozitën e drejtorëve të drejtorive komunale. Udhëheqësi i ZKK-së i raporton drejtpërdrejt kryetarit të komunës. Sipas statutit¹⁰⁶ dhe pohimeve të zyrtarëve të ZKK-së, zyra është përgjegjëse për monitorimin e të gjitha projekteve që kanë të bëjnë me çështjet e pakicave, promovimin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave, qasjen e papenguar dhe të barabartë të pakicave në shërbimet publike në nivel komunal në fushën e arsimit, përkujdesjes shëndetësor dhe punësimit.

Në ZKK-në e Ferizajit/Uroševac aktualisht punojnë dymbëdhjetë (12) punëtorë, shtatë (7) ashkalinjë, dy (2) romë, një (1) serb, një (1) goran dhe një (1) turk. Detyra e saj është të iniciojë dhe ndihmojë projektet e ndryshme që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave të pakicave në komunë. Pjesa më e madhe e punëve është përqendruar në procesin e kthimit dhe hartimin e strategjisë për kthim të qëndrueshëm. Të arriturat kryesore të kësaj zyre janë përmirësimi i gjendjes së sigurisë dhe integrimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare. Në bashkëpunim me drejtorinë komunale për arsim, ZKK-ja ka bërë të mundur përfshirjen në procesin arsimor të 1000 fëmijëve nga radhët e këtyre komuniteteve. Detyrë tjetër e ZKK-së është të promovojë përfaqësimin e pakicave në komunë.

Të arriturat tona më të mëdha që bien në sy janë: përmirësimi i lirisë së lëvizjes dhe re-integrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqëri. Në ia kemi dalë të regjistrojmë më shumë

¹⁰³ Intervistë me H.H. kryetar i zyrës për komunitete në Ferizaj/Uroševac, Intervistë e FDH-Kosovë, 14 maj 2009.

¹⁰⁴ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009.

¹⁰⁵ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar- mars 2009, mars 2009.

¹⁰⁶ Neni 69 i statutit të komunës së Ferizajit/Uroševac.

se 1000 fëmijë në sistemin e arsimor. Në sistemin parashkollor janë regjistruar 42 fëmijë, në shkollat fillore 840 fëmijë, në shkollat e mesme 66 fëmijë dhe në Universitet janë regjistruar 7 studentë nga radhët e komuniteteve të sipërpërmendura.

H.H. kryetar i Zyrës për komunitete në Ferizaj/Uroševac
Intervistë e FDH-Kosovë, 14 maj 2009.

ZKK-ja për çdo vit harton planin e saj të veprimit duke caktuar prioritetet e veta. Aktivitetet e kësaj zyre janë të fokusuara në fushën e infrastrukturës, përkujdesjes shëndetësore, mirëqenies sociale dhe arsimit. Prioritetet e planit të veprimit përcaktohen në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe komunitetet.

Buxheti dhe projektet- Asambleja komunale vendos për mënyrën e shpërndarjes së buxhetit komunal në baza vjetore. Komuna e Ferizajit/Uroševac ka ndarë një buxhet prej 56.710 euro për funksionimin e ZKK-së dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave. Ky buxhet mbulon shpenzimet e rrogave të punëtorëve, mallrave dhe shërbimeve¹⁰⁷. Buxheti i caktuar shfrytëzohet edhe për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, riparimin e rrjetit elektrik, përkujdesjen shëndetësore dhe aktivitetet në fushën e arsimit.

Sipas autoriteteve komunale të Ferizajit/Uroševac, gjatë periudhës 2004-2007 përparësi i është dhënë rekonstruktimit të rrugëve në lagjet e banuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë. Prej vitit 2007 e këtej, komuna nuk ka investuar më në projekte kapitale për komunitetet pakicë. Aktualisht, administrata komunale është përqendruar në zhvillimin e politikave për shkollimin e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Komuna e Ferizajit/Uroševac ka ndarë nga 500 euro në muaj për nevojat elementare (ushqime dhe veshmbathje) të pjesëtarëve më të varfër të këtyre komuniteteve. ZKK-ja stimulon vijimin e mësimin të fëmijëve nga radhët e këtyre komuniteteve përmes ndihmës financiare prej 30-40 euro në muaj, të cilat mbulojnë shpenzimet e transportit. ZKK-ja gjithashtu ofron mbështetje financiare në baza ad hoc në lartësi prej 100 euro, për individë apo familje, në rast të sëmundjeve të rënda apo aksidenteve.

“ZKK-ja dhe drejtoria komunale për arsim po punojnë bashkërisht për të përmirësuar nivelin e arsimit të anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Me mbështetjen e UNDP-së dhe Caritas-it ne po ndihmojmë familjet e fëmijëve që vijnë shkollën me nga 30-40 euro në muaj. Përveç kësaj, komuna mbështet iniciativat kulturore dhe sportive të komuniteteve”.

A.G. udhëheqës i drejtorisë së administratës komunale në Ferizaj/Uroševac
Intervistë e FDH-Kosovë, 14 maj 2009

Komuna e Ferizajit/Uroševac nuk ka ndarë buxhet të posaçëm për nevojat e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali.

E drejta në pronë dhe vendbanimet joformale- Komuna e Ferizajit/Uroševac nuk ka program të veçantë për regjistrimin e pjesëtarëve të paregjistruar nga radhët e komuniteteve pakicë. Në komunën e Ferizajit/Uroševac nuk ka vendbanime joformale.

Papunësia dhe mungesa e dokumentacionit mbi pronën janë problemet më të mëdha për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Administrata komunale pohon se ajo nuk

¹⁰⁷ Rrogat (13 anëtarë të personelit) - 29.930 euro, mallra dhe shërbime 25.771 euro, shërbime komunale 1000 euro.- H.H. Kryetar i ZKK-së në Ferizaj/Uroševac- Intervistë e FDH-Kosovë, 14 maj 2009.

mund të marrë përgjegjësinë për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve pronësore, por përpiket t'i ndihmojë pjesëtarët e komuniteteve në çfarëdo mënyre tjetër.

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas hasin vështirësi të shumta kur përpiqen t'i zgjidhin problemet e tyre pronësore. Shumica dërmuese nuk disponojnë me dokumentacion që vërteton pronësinë. Nxjerrja e një ligji të ri mbi pronësisë ndoshta do t'i ndihmojë komunës që t'i zgjidhë mosmarrëveshjet pronësore.

A.M. drejtor i i drejtorisë për çështje pronësore dhe kadastër në Ferizaj/Uroševac

Intervistë e FDH-Kosovë, 14 maj 2009

Informimi dhe vetëdijesimi- Personeli i ZKK-së në Ferizaj/Uroševac është mirë i informuar me Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, gjatë periudhës 2009-2015.

ZKK-ja bashkëpunon me organizatat e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare që merren me problematikat e arsimit. Kjo zyrë është e hapur në baza ditore për të gjithë qytetarët që duan t'i shtrojnë problemet dhe shqetësimet e tyre. ZKK-ja në Ferizaj/Uroševac bashkëpunon ngushtë me IOM-in, UNDP-në, OSBE-në, UNICEF-in dhe OJQ-të lokale në programet arsimore, procesin e kthimit dhe fushatat e vetëdijesimit.

1.2.10 Komuna e Gjilanit/Gnjilane

Komuna e Gjilanit/Gnjilane shtrihet 47 km në juglindje të Prishtinës/Priştina dhe përfshinë një territor prej 515 kilometra katror. Kjo komunë numëron 130.000 banorë, pjesa dërmuese e të cilëve janë shqiptarë (116.000), pas të cilëve vijnë serbët (11.800), romët (370) dhe disa qindra turq. Ekzistojnë disa vendbanime me popullsi të përzier, duke përfshirë edhe vet qytetin e Gjilanit/Gnjilane dhe pesë fshatra. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë lëvizin lirisht në qytet dhe gjithkund tjetër nëpër komunë¹⁰⁸. Deri në fund të janarit të vitit 2008, në komunë ishin kthyer tetë familje serbe me 27 anëtarë. Në qytetin e Gjilanit/Gnjilane jetojnë rreth 40 familje serbe. Gjatë vitit 2007 janë kthyer në qytet 19 familje rome me 87 anëtarë, si pjesë e Fazës së II-të të projektit të kthimit “Abdullah Presheva”.

Gjilani/Gnjilane ka Spitalin rajonal me 538 të punësuar. Niveli primar shëndetësor është i organizuar përmes rrjetit të Qendrave të mjekësisë familjare, 13 *ambulancave* dhe 18 klinikave më të vogla¹⁰⁹ ku punon një personel prej 326 punëtorëve shëndetësor pjesëtarë të të gjitha komuniteteve- shqiptarë, serbë, turq dhe romë, të cilët ofrojnë përkujdesje, trajtim dhe edukim shëndetësor për popullsinë e këtushme. Sistemi arsimor është i ndarë qartë në shkollat shqipe (nën kontrollin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe shkollat serbe (të kontrolluara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë). Kjo komunë ka 21 shkolla fillore me 20.372 nxënës që vijnë në mësimet në gjuhën shqipe (ku përfshihen edhe 25 nxënës të komunitetit turk) dhe 16 shkolla fillore me mësim në gjuhën serbe, me rreth 1.700 nxënës (përfshirë edhe 90 nxënës rom të kësaj komune). Gjilani/Gnjilane ka gjashtë shkolla të mesme me mësim në gjuhën shqipe me 6.587 nxënës (përfshirë 35 nxënës të komunitetit turk) dhe tetë shkolla të mesme me mësim në gjuhën serbe, me rreth 900 nxënës (shtatë nga të cilët pjesëtarë të

¹⁰⁸ UNHCR- Raport i OSBE-së, Profilet e komunave - Gjilani/Gnjilane

¹⁰⁹ Ibid

komunitetit rom). Universiteti i Prishtinës/Priština ka një degë në Gjilan/Gnjilane- Fakultetin e Mësuesisë¹¹⁰.

Në Kuvendi e komunës së Gjilanit/Gnjilane punojnë njëmbëdhjetë (11) anëtarë nga radhët e komuniteteve pakicë. Katër (4) nga ata janë serbë, katër (4) romë, dy (2) ashkalinjë dhe një (1) pjesëtar i komunitetit turk.

Kuvendi komunal i Gjilanit/Gnjilane miratoi statutin komunal më 21 nëntor 2008. Statuti garanton përdorimin e gjuhëve zyrtare në komunikim të shkruar dhe me gojë me organet komunale, në përputhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve¹¹¹. Kuvendi komunal shpalli gjuhën turke “gjuhë në përdorim zyrtar” në vitin 2007. Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe zyrës komunale për komunitete¹¹².

Komiteti për komunitete (CC) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Komiteti për komunitete përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve që jetojnë në Gjilan/Gnjilane. Çdo komunitet që jeton në komunë do të përfaqësohet me të paktën një përfaqësues¹¹³. Sipas statutit të komunës, Komiteti për komunitete duhet të ketë shtatë anëtarë. Aktualisht, ky komitet përbëhet nga tre (3) shqiptarë, dy (2) serbë, një rom dhe një (1) turk, të gjithë këta të emëruar¹¹⁴. Komitet mbanë mbledhje në bazë të nevojave të komuniteteve dhe zhvillimit të situatës. Sipas zyrtarëve të ZKK-së, komiteti nuk mban mbledhje të rregullta¹¹⁵.

Sipas raporti të MALG¹¹⁶, Komiteti për komunitete i komunës së Gjilanit/Gnjilane u takua nëntë (9) herë gjatë vitit 2008, përderisa gjatë periudhës janar-mars 2009 ky komitet u mbledh dy (2) herë¹¹⁷.

Mandati i KK është të mbrojë dhe promovojë të drejtat e pakicave në nivel komunal. Në bazë të statutit të komunës, detyra kryesore e komitetit është të sigurojë se të gjitha politikat dhe vendimet komunale që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare janë në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe në interesin më të mirë të komuniteteve që jetojnë në këtë vend. Komiteti për komunitete gjithashtu rekomandon masat që duhet ndërmarrë nga Kuvendi komunal për të promovuar identitetin etnik, kulturor, religjioz dhe gjuhësor të komuniteteve¹¹⁸. Kërkesat dhe ankesat e parashtruara nga qytetarët kryesisht kanë të bëjnë me rindërtimin e shtëpive, procesin e kthimit, infrastrukturën rrugore, energjinë elektrike dhe arsimin

“Komiteti për komunitete takohet rregullisht, në baza mujore. Ne i shqyrtojmë të gjitha ankesat e bëra nga qytetarët dhe ia prezantojmë shqetësimet e tyre Kuvendit komunal, së bashku me rekomandimet për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare në komunën tonë.

¹¹⁰ Departamenti komunal për arsim dhe Zyra komunale për komunitete- Raport i OSBE-së, Profilet e komunave Gjilani/Gnjilane

¹¹¹ Neni 47 i statutit të komunës së Gjilanit/Gnjilane.

¹¹² Neni 62 dhe 89 i statutit të komunës së Gjilanit/Gnjilane

¹¹³ Neni 71.1 i statutit të komunës së Gjilanit/Gnjilane

¹¹⁴ K.SH, anëtar i Komitetit për komunitete në komunën e Gjilanit/Gnjilane –Intervistë e FDH-Kosovë, 1 qershor 2009.

¹¹⁵ Ibid

¹¹⁶ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009

¹¹⁷ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar- mars 2009, mars 2009.

¹¹⁸ Neni 71.2 i statutit të komunës së Gjilanit/Gnjilane

K.SH, anëtar i Komitetit për komunitete në komunën e Gjilanit/Gnjilane
Intervistë e FDH-Kosovë, 1 qershor 2009.

Zyra komunale për komunitete (MCO) – mandati i zyrës në Gjilan/Gnjilane nuk është rregulluar me statut. Sipas deklaratave të zyrtarëve komunal natyra e punëve të kësaj zyre është e ngjashme me mandatin e ZKK-ve tjera anë e kënd Kosovës. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të pakicave është alfa dhe omega e aktiviteteve të kësaj zyre. Përmirësimi i kushteve të jetesës për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas që jetojnë në lagjen Abdullah Presheva/Abdullah Presheva ka qenë synimi i ZKK-së në Gjilan/Gnjilane. Gjatë viteve 2004-2006, komuna ka ndihmuar në riparimin e infrastrukturës rrugore, rrjetit të energjisë elektrike dhe instalimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Bazuar në ato që deklarojnë zyrtarët e ZKK-së, Zyra ka prioritet procesin e kthimit. Ata po bëjnë të pamundurën për ta arritur kthim të qëndrueshëm të refugjatëve. ZKK në Gjilan/Gnjilane ka punësuar tre pjesëtarë nga radhët e komuniteteve pakicë, një (1) serb, një (1) rom dhe një (1) turk.

ZKK-ja në Gjilan/Gnjilane ka dëshmuar se është mjaft e suksesshme në procesin e kthimit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Sipas planit të veprimit, ne do të merremi shumë intensivisht me këtë çështje edhe në të ardhmen. Përveç procesit të kthimit, ZKK-ja ka qenë e përfshirë edhe në projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me arsimin dhe mbrojtjen shëndetësore.

K.SH, anëtar i Komitetit për komunitete në komunën e Gjilanit/Gnjilane
Intervistë e FDH-Kosovë, 1 qershor 2009

Zyra për çdo vit harton planin e punës. Planet e punës mbulojnë fushën e procesit të kthimit dhe arsimin. Zyrtarët e ZKK-së në Gjilan/Gnjilane janë të shqetësuar për faktin se autoritet komunale nuk kanë caktuar buxhet për komunitetet pakicë për vitin 2009¹¹⁹. Komuna nuk ka hartuar projekte kapitale për komunitetet pakicë që nga viti 2007. Deri më tash, shumica e projekteve komunale të dedikuara për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët janë përqendruar në rikonstruktimin apo ndërtimin e shtëpive për të kthyerit, përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe sistemin e ujësjellës-kanalizimit. Deri më tani nëpër shtëpitë e tyre në këtë komunë janë kthyer gjithsej 51 familje me 243 anëtarë. Procesi i kthimit është mbështetur edhe nga UNHCR, UNDP, Mercy Corps, CRPK dhe DRC. Prioritetet e tanishme të zyrës janë fokusuar në arsim, përkatësisht në përfshirjen e fëmijëve të komunitetit rom në procesin e arsimit. ZKK-ja në Gjilan/Gnjilane, në bashkëpunim me drejtorinë komunale të arsimit, është duke përgatitur plan-programin e mësimi në gjuhën rome për fëmijët rom. Këta fëmijë, deri tani kanë ndjekur mësimet në shkollat që janë pjesë e sistemit paralele të arsimit të organizuar nga Republika e Serbisë.

Komuna e Gjilanit/Gnjilane ka krijuar dhe implementuar projekte për kthim të qëndrueshëm dhe projekte në mbështetje të integritetit të refugjatëve. Ne kemi përgatitur një projekt që do t'u mundësonte fëmijëve rom të mësojnë në gjuhën e tyre, në të njëjtat shkolla me shqiptarët. Gjithashtu, i kemi kërkuar Kuvendit komunal që të organizojë kurse intensive të gjuhës shqipe për të gjithë pjesëtarët e komunitetit rom. Kjo kërkesë është duke u shqyrtuar.

E.K.- zyrtar komunal në Zyrën komunale për komunitete në Gjilan/Gnjilane
Intervistë e FDH-Kosovë, 1 qershor 2009.

Buxheti dhe projektet – Kuvendi komunal miraton buxhetin komunal dhe ndanë fonde për çdo vit. Pothuajse 20% e buxhetit komunal për vitin 2008 është ndarë për funksionimin e ZKK-së,

¹¹⁹ K.SH, anëtar i Komitetit për komunitete dhe E.K.- zyrtar komunal në ZKK-në e Gjilanit/Gnjilane. Intervistë e FDH-Kosovë, 1 qershor 2009

procesin e kthimit dhe projektet që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave. Zyrtarët e ZKK-së në Gjilan/Gjilan nuk janë informuar për mënyrën e ndarjes së mjeteve për këtë vit.

Gjatë periudhës 2002-2007 komuna e Gjilanit/Gnjilane ka ndihmuar në ndërtimin apo rindërtimin e 51 shtëpive të dedikuara për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian. Gjatë vitit 2008, komuna ka ndihmuar ndërtimin e 10 shtëpive tjera për të kthyerit nga radhët e këtyre komuniteteve. Këto shtëpi janë ndërtuar në lagjen rome të qytetit të Gjilanit/Gnjilane. Projektet për shkollimin e fëmijëve rom ishin prioritet për administratën komunale, posaçërisht gjatë dy viteve të fundit.

Komuna e Gjilanit/Gnjilane deri më tani nuk ka ndarë buxhet special për nevojat e romëve, egjiptianëve dhe ashkalinjëve.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Në komunën e Gjilanit/Gnjilane nuk ka vendbanime jozyrtare. ZKK-ja në Gjilan/Gnjilane ka bashkuar forcat me organizatën Programi për të drejtat civile, me qëllim që të lehtësojë regjistrimin e popullatës RAE që nuk është regjistruar më parë.

Papunësia dhe mungesa e dokumenteve pronësore janë problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Administrata komunale është duke i ndihmuar pjesëtarët e këtyre komuniteteve për t'u pajisur me dokumentet e nevojshme pronësore përmes dëshmive të dëshmitarëve dhe verifikimeve të tyre në drejtorinë për kadastër.

Informimi dhe vetëdijesimi- Personeli i ZKK-së në Gjilan/Gnjilane nuk është i njoftuar me Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, gjatë periudhës 2009-2015. Atyre u mungojnë njohuritë për ligjet dhe rregulloret e zbatueshme që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave¹²⁰. Anëtarët e ZKK-së janë të mendimit se është shumë me rëndësi të organizohen fushata për informimin e këtyre komuniteteve në lidhje me strategjinë e përmendur më lartë. Zyrtarët e ZKK-së i udhëzojnë dhe këshillojnë qytetarët se ku t'i drejtojnë dhe si t'i zgjidhin problemet e tyre. Kërkesat e qytetarëve zakonisht kanë të bëjnë me problemet për pajisje me dokumente personale, çështjet pronësore, papunësinë etj. ZKK-ja në Gjilan/Gnjilane bashkëpunon ngushtë me shoqërinë civile, si dhe me organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Ata kanë bashkëpunuar me UNHCR-në, UNDP-në, OSBE-në, UNICEF-in, DRC-në dhe CRPK-në në projekte që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe fushatat për vetëdijesimin mbi rëndësinë e shkollimit. ZKK në Gjilan/Gnjilane gjithashtu ka bashkëpunuar edhe me organizatat vendore në përgatitjen e trajnimeve profesionale për të kthyerit, me qëllim që ta bëjë sa më të lehtë integrimin e tyre në shoqëri. Në këtë kuadër, ata kanë mundësuar organizimin e trajnimeve për floktar/frizer, zdrukthëtar dhe ngjarje të shumta kulturo-sportive.

1.2.11 Komuna e Prizrenit/Prizren

Komuna e Prizrenit/Prizren gjendet në pjesën jugore të Kosovës dhe përbën rreth 6% të territorit të saj. Në vet qytetin e Prizrenit dhe në 76 fshatrat e shpërndara përreth tij jetojnë 240.000 banorë. Përpos shqiptarëve, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë së komunës, Prizreni është shtëpia e një komuniteti të madh të boshnjakëve – 22.000, turqve-9.000 (këtu nuk përfshihen qytetarët turq që jetojnë në Pilot komunën e Mamushës/Mamuşa/Mamuşa) dhe komunitetit rom,

¹²⁰ Ibid

ashkali dhe egjiptian - 5,300. Në këtë komunë jeton edhe një numër i vogël i serbëve - 196¹²¹. Prizreni është i njohur për diversitetin e tij etnik dhe gëzon traditë të gjatë të tolerancës dhe bashkëpunimit ndëretnik. Prizreni/Prizren është komuna më heterogjene etnike dhe kulturore e Kosovës.

Kjo komunë ka 31 qendra të shërbimit primar shëndetësor. Spitali i vetëm rajonal në Prizren/Prizren ofron shërbime mjekësorë për rreth 400.000 banorë. Komunitetet pakicë, duke përfshirë edhe serbët, kanë qasje të papenguar në sistemin shëndetësor të komunës së Prizrenit/Prizren. Përpos kësaj, serbët shfrytëzojnë edhe institucionet paralele shëndetësore në fshatin Mushnikovë/Mušnikovo, që janë pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë së Serbisë. Në rast të sëmundjeve serioze dhe emergjencave mjekësore, pjesëtarët e komunitetit serb referohen për trajtim në Shtërpçë/Štrpce apo Mitrovicë/Mitrovica.

Komuna ka 42 shkolla fillore dhe 5 të mesme. Ka dy shkolla speciale për personat e hendikepuar, një për personat me dëgjim të dëmtuar dhe një tjetër për ata me çrregullime mendore. Në komunën e Prizrenit/Prizren ka dy degë të Universitetit të Prishtinës/Priština: Fakulteti i edukimit dhe ai për Teknologji informative, ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke. Në shkollat fillore dhe të mesme të komunës mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke, në bazë të plan-programeve të ndara. Në komunë nuk ka nxënës nga radhët e komunitetit serb, rrjedhimisht nuk ka as shkolla në gjuhën serbe¹²².

Kuvendi komunal i Prizrenit/Prizren ka miratuar statutin e komunës më 15 tetor 2008. Statuti garanton përdorimin e gjuhës amtare në komunikim me organet komunale, në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Kuvendi komunal ka miratuar rregulloren¹²³ e cila e njeh gjuhën boshnjake si gjuhë tjetër zyrtare në Prizren/Prizren. Ky akt ligjor rregullon në detaje përdorimin e gjuhëve që fliten në këtë komunë, gjatë komunikimit verbal apo me shkrim me autoritetet komunale. Mbledhjet e kuvendit, komitetit dhe të gjitha mbledhjet tjera mbahen në gjuhët e cekura më lartë. Gjithë dokumentacioni zyrtar i komunës duhet të përkthehet në gjuhët e sipërpërmendura. Një vendim i tillë i kuvendit komunal është reflektuar edhe në statutin e komunës¹²⁴. Statuti parasheh krijimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera¹²⁵.

Komiteti për komunitete (KK) – është një nga komitetet e përhershme të komunës. Ky komitete ka shtatë (7) anëtarë dhe përbëhet nga anëtarët e kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në këtë komunë do të ketë të paktën një përfaqësues¹²⁶. Anëtarët e emëruar në Komitetin për komunitete nga radhët e komuniteteve pakicë në komunën e Prizrenit/Prizren janë si më poshtë: një (1) boshnjak, një (1) serb, një(1) turk, dhe një (1) rom.

Sipas MALG-raportit¹²⁷ ky komitet u mbledh dhjetë (10) herë gjatë vitit 2008, kurse gjatë periudhës janar- mars 2009 komiteti është takuar dy (2) herë¹²⁸. Detyra e tij është të sigurojë se të

¹²¹ Zyra komunale për komunitete në Prizren – OSBE Profili i komunave -Prizreni

¹²² Ibid

¹²³ Rregullorja mbi përdorimin e gjuhëve Nr. 01/011-1051- lëshuar nga Kuvendi komunal i Prizrenit/Prizren

¹²⁴ Ndeni 8 dhe 12 i statutit të komunës së Prizrenit/Prizren.

¹²⁵ Neni 58 dhe 62 i statutit të komunës së Prizrenit/Prizren.

¹²⁶ Islam Elshani, zyrtar komunal i Zyrës për komunitete në Prizren/Prizren- Intervistë e FDH-së, 15 maj 2009.

¹²⁷ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar-dhjetor 2008, mars 2009

gjitha politikat dhe aktivitetet e komunës janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe mbrojnë interesat më të mira të komuniteteve pakicë. KK gjithashtu rekomandon hapat dhe masat që duhet të ndërmarrë kuvendi komunal, me qëllim që të sigurohet respektimi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave. Të gjitha këto veprimtari do të mundësojnë respektimin e plotë të të drejtave etnike, kulturore dhe religjioze. Komiteti për komunitete gjithashtu rishikon kërkesat dhe ankesat e bëra nga qytetarët e komuniteteve pakicë dhe ua paraqet ato drejtorive përkatëse dhe institucioneve tjera komunale.

“Komiteti për komunitete ka mandatin të mbikëqyrë mbledhjet e kuvendit dhe të përcjellë aktivitetet e Zyrës komunale për komunitete. KK paraqet raport në kuvendin komunal për aktivitete e ZKK-së dhe mbikëqyrë çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, lirinë e lëvizjes, rindërtimin, mirëqenien sociale dhe shëndetin publik. Komiteti për komunitete është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të të gjitha rregulloreve komunale dhe dokumenteve tjera strategjike që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave në komunën tonë”.

I.E. –zyrtar komunal i Zyrës për komunitete në Prizren/Prizren

Intervistë e FDH-së, 15 maj2009.

Zyra komunale për komunitete (ZKK) – statuti i komunës nuk e rregullon themelimin e as e përcakton mandatin e ZKK-së në Prizren/Prizren. ZKK-ja është future në listë së bashku me drejtoritë komunale dhe aktivitetet e kësaj zyre janë përshkruar mirë në ueb faqen e komunës. ZKK-ja ka regjistruar kthimin e 30-40 familjeve rome, ashkalie dhe egjiptiane nga shtetet perëndimore dhe një (1) familje rome nga Serbia.

Sipas zyrtarëve komunal, misioni i kësaj zyre është të lehtësojë integrimin e pakicave në administratën komunale, në proceset e vendimmarrjes dhe në shoqëri në përgjithësi. ZKK-ja gjithashtu shërben edhe si urë lidhëse në mes komuniteteve dhe autoriteteve, duke vendosur komunikime dhe duke krijuar marrëdhënie të mira mes dy palëve. Komuna e Prizrenit/Prizren e ka miratuar planin e vet të zhvillimit, përderisa ZKK-ja ka përgatitur planin vjetor të veprimit i cili përqendrohet në fushën e arsimit. Aktivitetet kryesore të kësaj zyre përfshijnë ndërlidhjen në mes autoriteteve komunale (kryetarit të komunës) dhe komuniteteve pakicë, me qëllim të informimit të tyre në lidhje me problemet e përditshme të pakicave; shpërndarjen e ndihmës së huaj (të mira) për komunitetet nëpër fshatra; lehtësimin e procesit të kthimit; organizimin e tryezave të punës për pakicat; regjistrimin provues të qytetarëve dhe financimin e rindërtimit të rrugëve, renovimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në lagjet e banuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë. ZKK-ja në Prizren/Prizren ka personel prej shtatë (7) punëtorëve: dy (2) boshnjakë, dy (2) serbë, një (1) pjesëtar i komunitetit RAE¹²⁹ dhe dy (2) pjesëtarë të komunitetit turk.

Në bashkëpunim me autoritetet komunale dhe organizatat ndërkombëtare, ZKK-ja në Prizren/Prizren ka implementuar projekte të ndryshme gjatë gjithë periudhës 2000-2009. Fushatat e vetëdijesimit për rëndësinë e shkollimit dhe përfshirja e rreth 80 fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme konsiderohen suksese të mëdha të ZKK-së. Gjatë kësaj periudhe, ZKK-ja është përqendruar në përmbushjen e nevojave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Ndër projektet tjera mund të përmenden: rindërtimi i rrugës në lagjen e romëve, instalimi i rrymës elektrike dhe rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërtimi i qendrës rinore për aktivitete

¹²⁸ MALG -Raport mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës, janar- mars 2009, mars 2009.

¹²⁹ Hulumtuesi i FDH-së nuk mundi të marrë informata të detajuara.

kulturore dhe sportive në Prizren/Prizren etj. ZKK-ja gjithashtu monitoron gjendjen e të drejtave të pakicave në këtë komunë.

Gjatë vitit 2009, ne kemi arritur të regjistrojmë më shumë se 80 fëmijë romë, ashkalinjë dhe egjiptianë në shkollat fillore dhe të mesme. Me ndihmën e vazhdueshme të drejtorisë komunale për arsim, mbështetjen nga OJQ-të lokale dhe në bashkëpunim me prindërit, kemi zhvilluar një fushatë shumë intensive të vetëdijesimit për t'i informuar familjet mbi rëndësinë e shkollimit të fëmijëve. Ne zotohemi se do ta vazhdojmë këtë aktivitet edhe në të ardhmen, deri sa t'i regjistrojmë të gjithë fëmijët në sistemin arsimor. Aktivitetet për vetëdijesim janë të domosdoshme.

A.A. – kryetar i zyrës komunal për komunitete në Prizren/Prizren

Intervistë e FDH-Kosovë, 15 maj 2009.

Buxheti dhe projektet – Asambleja komunale miraton për çdo vit buxhetin komunal. Për funksionimin e ZKK-së, projektet që kanë të bëjnë me pakicat dhe nevojat tjera të komuniteteve pakicë në komunën e Prizrenit/Prizren janë ndarë 777.331 euro apo 22.8% të buxhetit të përgjithshëm komunal. Në këtë shumë janë përfshirë edhe pagat e punëtorëve, mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale¹³⁰. Buxheti i ndarë gjithashtu shfrytëzohet edhe për rekonstruktimin e rrugëve. Sipas drejtorit të departamentit të financave, ata gjithmonë konsultohen me ZKK-në gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin në vijim.

Investimet kryesore gjatë periudhës 2005-2008 ishin përqendruar në infrastrukturë. Prej vitit 2000 deri më sot janë ndërtuar më shumë se 90 shtëpi të familjeve romë, ashkalie dhe egjiptiane¹³¹. Komuna ka mbështetur rindërtimin e rrugëve, instalimin e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit dhe atë elektrik në lagjet e banuara nga romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët: “Jeta e Re”, “Tezi mahalla”, “Durmish Asllan” dhe “Rruga e Ulqinit”. Projektet e ZKK-së gjatë vitit 2008-2009 janë përqendruar kryesisht në fushën e arsimit, me qëllim të përfshirjes së fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë nëpër shkolla. KFOS-i dhe CARITAS-i zviceran kanë mbështetur projektet për shkollimin e fëmijëve të komuniteteve pakicë. KFOS-i ka implementuar projektin tre-fazësh që ofron “catch up” orë për të gjithë fëmijë e larguar nga shkolla. Si rezultat i këtyre përpjekjeve 80 fëmijë janë regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme gjatë vitit 2009. Caritas-i zviceran ka ndihmuar hapjen e dy klasave në shkollën fillore “Matillo Gorelli” dhe dy klasave në shkollën e mesme, gjatë viteve 2007 - 2008. Më shumë se 40% e fëmijëve që vijnë në shkollën në këtë klasë janë pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

“Ne besojmë fuqishëm se projektet komunale duhet të koncentrohen në fushën e arsimit. Komuna duhet të bëjë përpjekje që të përfshijë sa më shumë nxënës në sistemin arsimor, me qëllim që të lehtësojë drejtpërdrejt integrimin e tyre në shoqëri. Komuna do të zhvillohet vetëm kur të përparojnë të gjithë banorët e saj. Ne do t'i vazhdojmë projektet tona si në fushën ekonomike/sociale ashtu edhe në atë të arsimit.

Z.A. udhëheqës i departamentit për buxhet dhe financa në Prizren/Prizren

Intervistë e FDH-Kosovë, 15 maj 2009

Komuna e Prizrenit/Prizren deri më tani nuk ka caktuar buxhet të veçantë për nevojat e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali. Vëmendje e posaçme po i kushtohet rasteve specifike të

¹³⁰ Z.A. kryetar i departamentit për buxhet dhe financa në Prizren/Prizren, Intervistë e FDH-Kosovë, 15 maj 2009.

¹³¹ Ibid

personave që kanë nevojë për veshmbathje dhe ushqim. Në raste të tilla ZKK-ja u del në ndihmë këtyre individëve në baza *ad hoc*.

E drejta në pronë dhe vendbanimet jozyrtare – Komuna e Prizrenit/Prizren nuk ka program të posaçëm për regjistrimin e pjesëtarëve të paregjistruar nga radhët e komuniteteve pakicë. Sipas zyrtarëve të ZKK-së, Programi i Kosovës për të drejtat qytetare (CRPK)¹³² me mbështetjen e UNHCR-së ka ndihmuar në regjistrimin e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. ZKK-ja nuk ka informatë sa i përket numrit të individëve që CRPK-ja ka ndihmuar të regjistrohen apo numrit të kërkesave për regjistrim. Sipas mendimit të tyre procesi është duke u zhvilluar në mënyrë shumë të ngadalshme.

Në komunën e Prizrenit/Prizren nuk ka vendbanime jozyrtare. Pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian kanë problem me dokumentacionin e pronësisë. Ky është problem shumë i përhapur te pjesëtarët e komunitetit RAE. Administrate komunale nuk merr përgjegjësi për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me pronësinë.

Shumë pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian e kanë të vështirë të vërtetojnë se kanë diçka në pronësinë, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës. Komuna nuk mund t'i ndihmojë ata në këtë çështje dhe nuk mund të përzihet në konteste pronësore.

I.E. –zyrtar komunal i zyrës për komunitete në Prizren/Prizren
Intervistë e FDH-Kosovë, 15 maj 2009.

Informimi dhe vetëdijesimi– Autoritetet komunale në Prizren/Prizren janë të njoftuar me Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, gjatë periudhës 2009-2015. Zyra komunale për komunitete është e pranishme në mesin e komuniteteve pakicë në qytet dhe fshatra për shkak të rolit të saj ndërlidhës. Pjesëtarët e komuniteteve kërkojnë nga ZKK-ja që t'i ndihmojë në zgjidhjen e problemeve dhe përmbushjen e kërkesave të tyre. Zyra për komunitete në Prizren/Prizren ka bashkëpunim të mirë me shoqërinë civile dhe punojnë së bashku në implementimin e projekteve të ndryshme në fushën e arsimit, infrastrukturës dhe shëndetësisë. Zyra ka pasur bashkëpunim të frytshëm posaçërisht me UNDP-në, KFOS-n, CARITAS-in zviceran, UNHCR-në, CRPK-në dhe UNICEF-in.

¹³² OJQ kosovare e përfshirë në mbështetjen e regjistrimit të personave të zhvendosur brenda Kosovës, përfshirë edhe pjesëtarët e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali.

Programi për të Drejtat Civile –Kosovë (CRPK) dhe regjistrimi pjesëtarëve të komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptas

Projekti i CRPK-së ka filluar në vitin 2006, mandati i tij është të parandalojë mungesën e shtetësisë për çdo person i cili jeton në Kosovë. Në kohën kur projekti ka filluar afërsisht 30-40% e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas nuk ishin të regjistruar, çka do të thotë se ata ligjërisht nuk kanë ekzistuar. Në atë kohë kishte afërsisht 10.000 persona të cilëve u mungonte dokumentacioni. Sot, afërsisht 6000 persona janë pajisur me dokumentacion personal dhe personat e zhvendosur po vazhdojnë të kthehen nga vendet e ndryshme. Është menduar që procesi i regjistrimit të përfundojë në vitin 2010 mirëpo është herët të thuhet nëse do të arrihet qëllimi që të regjistrohen të gjithë personat e pa regjistruar.

Procedura:

1. identifikohen vendet ku pjesëtarët e komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptas nuk janë regjistruar ;
2. lista e personave pa dokumente u jepet juristëve;
3. juristët marrin listën dhe caktojnë takime me pjesëtarët e komuniteteve;
4. pas takimeve, juristët fillojnë grumbullimin e informative dhe kërkesave. Marrin autorizimet që CRPK t'i përfaqësojë rastet e tyre (ky është fundi i aktiviteteve të outreach);
5. kërkesat paraqiten në zyrat komunale për regjistrim civil në emër të personave pa dokumentacion;
6. krijohet dosja dhe rasti si dhe regjistrohet rasti në bazën e shënimeve;
7. juristët rishikojnë të dhënat e marra në teren;
8. juristët ngarkohen me raste;

Statusi civil dhe regjistrimi civil janë dy gjëra të ndryshme. Procesi i regjistrimit fillon me statusin civil kur edhe lëshohet certifikata e lindjes. Faza e dytë fillon kur bëhet regjistrimi dhe lëshohet letërnjoftimi apo pasaporta. Nëse nuk mund të gjejmë certifikatën e lindjes, kërkesa duhet t'i adresohet komisionit të ankesave për të vazhduar me procesin e regjistrimit pa dokumentacion. Nëse kjo nuk është e mundur, personi pa dokumentacion apo avokati i tij duhet t'i drejtohet gjykatës. Afërsisht 80% të kërkesave nuk janë të kompletuara në bazë të ligjit mbi regjistrimin civil pasi që 70-80% e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas nuk posedojnë dokumente. Regjistrimi duhet të bëhet gjeneratë pas gjenerate duke filluar nga gjyshi, babai dhe pastaj fëmiju.

Procedurat për të dokumentuar një foshnje të porsalindur janë të ndryshme varësisht nga fakti nëse fëmiju ka lindur apo jo në spital. Ekzistojnë zyrat e regjistrimit civil në spital dhe foshnjat e porsalindura regjistrohen automatikisht edhe në rastet kur prindërit nuk janë të regjistruar. Nëse fëmiju lind në shtëpi, fillimisht duhet të regjistrohen prindërit e pastaj mund të regjistrohet fëmiju.

CRPK kryen funksionin e konsulentit nga rradhët e shoqërisë civile gjatë procedurës së hartimit të ligjeve e posaçërisht ligjit mbi shtetësinë, azilin, ligjin mbi të drejtat e të huajve etj. Në shumicën e rasteve shteti nuk i pranon rekomendimet e shoqërisë civile, mirëpo CRPK vazhdon të nënvizojë qështjet në lidhje me të drejtat e njeriut si pjesë e legjislacionit kosovar. Implementimi i këtyre standardeve ende mbetet problem i madh. OSBE-ja po monitoron se si po shpenzohet buxheti në këto përpjekje.

CRPK ka realizuar katër dokumentarë në partneritet me UNHCR. Dy nga këta dokumentarë kanë në fokus rëndësinë e statusit civil dhe regjistrimin e minoritetëve. Këta dokumentarë janë transmetuar në RTK dhe stacionet televizive që u përkasin minoritetëve. Qëllimi i dokumentarëve ishte që grupet minoritare që jetojnë në Kosovë të mësojnë procedurat e regjistrimit civil, si dhe ku të kërkohet ndihmë, si dhe të nënvizohet rëndësia e regjistrimit të gjithë qytetarëve që jetojnë në një vend. Dokumentarët janë transmetuar gjatë kohës së piku-t. Dokumentari i tretë sapo është përfunduar dhe i katërti është në produksion. Të dy këta dokumentarë fokusohen në të drejtat e çdo qytetari e posaqërisht në të drejtën në pronë/pronësi, në kthim, shitblerje etj.

Materialet e fushatës (dokumentarët, broshurat, revistat) përgaditen në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. Punëtorët e CRPK-së kanë shprehur frustrimet e tyre për shkak të mungesës së përkthimit dhe kjo pamundëson komunikimin dhe qasjen në audiencën e tyre. Përveç me materiale të shtypura CRPK është mjaft e pranishme të komunitetet pasi që edhe zyrtarët janë të vendosura aty ku zyrtarët e habitatit punojnë. CRPK është me pak e pranishme në Prishtinë/Pristina mirëpo realizohen vizita të shpeshta në administratën komunale dhe kanë organizuar trajnime të ndryshme.

Komunat nuk kanë buxhet apo plan veprimi për të adresuar nevojat e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Një nga synimet e CRPK është që të ngritet vetëdija e publikut që ata vetë të mund të regjistrohen pa u mbështetur në ndihmën e CRPK-së apo ndonjë organizate tjetër.

Pjesa e II - Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Komuniteteve me theks të veçantë ato të komuniteteve Romë. Ashkali dhe Egjiptas në nivelin qendror

2.1 Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal

Zyrtarët e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL), pohojnë se ata janë të informuar në lidhje me Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Sipas tyre, departamenti i të drejtave të njeriut ka bërë shpërndarjen e strategjisë në të gjitha komunat. MAPL nuk ka hartuar ndonjë plan veprimi për të implementuar strategjinë për integrimin e këtyre komuniteteve. MAPL as nuk ka buxhetuar apo alokuar mjete të veçanta për adresimin e nevojave të Romëve, Ashkalinjve apo Egjiptasve.

“ Ne kemi shpërndarë strategjinë në të gjitha komunat dhe te zyrtarët për komunitetet. Qershori ka qenë muaji i promovimit të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave në Kosovë. Ne, gjithashtu kemi organizuar konferenca në Prishtinë dhe në të gjitha rajonet duke avokuar për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave.

F.K. shef i departamentit për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Intervistë e FDH--Kosovë, 21 qershor 2009

MAPL po negocion me OSBE-në për të fituar fondet për implementimin e projekteve të cilat janë fushata informative me qëllim që të inkurajohen dhe stimulohen anëtarët e komuniteteve të

marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes. Masa në të cilën pakicat marrin pjesë në procesin e vendim marrjes mund të matet vetëm me numrin e të punësuarve në administratën lokal.

Departamenti i të drejtave të njeriut pranë MAPL ka zhvilluar programin e trajnimit të 20 moduleve trajnuese për të trajnuar zyrtarët për të drejtat e njeriut në nivel lokal. Ky trajnim ka filluar të realizohet nga qershori i vitit 2008 deri në janar të vitit 2009. Të gjithë zyrtarët për të drejtat e njeriut kanë qenë pjesëmarrës në këtë trajnim duke përfshirë stafin e zyreve për komunitete në komuna. MAPL po përgaditet që të fillojë implementimin e një programi tjetër trajnues për të ndërtuar kapacitetet e zyrtarëve komunal për të drejtat e njeriut.

MAPL nuk ka krijuar ndonjë mekanizëm monitories për të observuar kualitetin e shërbimeve që ofrohen për komunitetet pakicë. Efikasiteti i administratës komunale vlerësohet në bazë të raporteve që vetë komunitat i hartojnë dhe i dërgojnë në këtë ministri.

2.2. Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Instituti Për Shëndet Publik

Qeveria e Kosovës duhet që, në përputhje me ligjin, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të sigurohet që pjesëtarët e komuniteteve të kenë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore, pa diskriminim. Shërbimet e qendrave shëndetësore të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës i shfrytëzojnë të gjitha komunitetet etnike, përveç serbëve të cilët kryesisht shërohen në qendrat paralele shëndetësore që janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë. Përveç serbëve, në ambulancat serbe shërohen edhe pjesëtarët e komuniteteve tjera, siç janë goranët dhe romët. Në vendimin e tyre për të marrë shërbime shëndetësore në ambulancat serbe ndikon edhe gjendja e tyre sociale, pasi që në ambulancat serbe nuk paguhet participimi ndërsa në ato shqiptare po. Sidoqoftë, FDH-Kosovë ka evidentuar se numri i serbëve të cilët i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës po rritet.¹³³

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UNICEF-in ka përgaditur dy complete të material që përmbajnë informacione mi përkujdesin shëndetësor në gjuhën Rome. Këto informata gjithashtu janë përmbledhur në spote televizive të cilat janë transmetuar në televizionin public. MSH gjithashtu ka organizuar trajnime mbi shëndetin reprodutiv dhe rëndësinë e të ushqyerit me gji të dedikuar për gratë të cilat jetojnë në kampin Osterode në Mitrovicën Veriore/Severna Mitrovica. Përveç këtij aktiviteti, MSH ka organizuar një seminar mbi pasojat dhe rreziqet e helmimit me plumb për banorët e kampit Osterode. Ministria ka mbështetur edhe përkthimin e librit “Fakte mbi Jetën” në gjuhën rome, publikim i cili u është shpërndarë pjesëtarëve të këtij komuniteti pa pagesë. Në bashkëpunim me organizatën Care International dhe OBSH, ministria ka organizuar trajnime edukuese mbi shëndetin reprodutiv dhe parandalimin e sëmundjeve infektive siq janë TBC, HIV/AIDS atc. Në këto programe arsimore janë trajnuar trajnerët në mënyrë që të ofrojnë arsimim të vzhdueshëm për popullatën e kësaj ane. Instituti për shëndet public ka marrë pjesë në hartimin e pjesës së përkujdesit shëndetësor të strategjisë për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Në përgjithësi, Instituti bashkëpunon me të gjithë partnerët ndërkombëtar në edukimin e pjesëtarëve romë, ashkali dhe egjiptas në lidhje me qështjet e përkujdesit shëndetësor të rëndësishme për ta. Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndarë buxhet të veçantë për të përmirësuar pozitëne e këtyre komuniteteve.

¹³³ FHP Izveštaj, Pitanja bezbednosti, zapošljavanje i primena Zakona o upotrebi jezika i Zakona protiv diskriminacije na Kosovu, septembar 2008.

2.3. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT

Romët arsimohen në institucionet që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë, megjithatë, asnjë shkollë nuk e ka organizuar mësimin në gjuhën rome. Në shkollat fillore ku shkollohen romët, e të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Serbisë, gjuha rome është lëndë fakultative. Nuk ka pasur iniciativë të ngjashme në shkollat që janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës.

Ekipi i ekspertëve të MASHT-it të Kosovës, ka filluar, në korrik të vitit 2008, përgatitjen e programeve mësimore për mësim, për shkollat fillore, në gjuhën rome. Sipas deklaratës së përfaqësuesit të ministrisë, romët do të kenë mundësi që ta mësojnë lëndën *Gjuha rome me elemente të historisë dhe kulturës* në shkollat, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë së Kosovës, deri në përgatitjen e programit. Është planifikuar që kjo lëndë mësimore të futet në mësim të rregullt më së largu deri në nëntor të vitit 2008. MASHT-i i Kosovës në bashkëpunim me organizata të ndryshme ndërkombëtare, siç është UNICEF-i apo OSBE-ja, ka organizuar kurse për mësimin e shkrimit e leximit dhe shkollimin e përsheptuar për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Nga këto projekte ishin kurset e quajtura *Dituria Jonë/Naše znanje*¹³⁴, dhe projektet tjera të ngjashme me to. Vijuesit e këtyre programeve, kryesisht janë fëmijët e larguar nga Kosova gjatë ose pas luftës. Megjithatë, këto projekte, për mësimin e shkrim-leximit dhe shkollimin e përsheptuar, janë mbajtur dhe vazhdojnë të organizohen në gjuhën shqipe, dhe kanë pasur për qëllim inkadrimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve në sistemin arsimor të Kosovës, ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe, gjë që ka pasur ndikim negativ në ruajtjen e identitetit etnik të romëve.¹³⁵

MASHT-i i Kosovës e ka miratuar strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, e cila do të realizohet gjatë viteve 2007-2017. Buxheti i paraparë është 14 milionë euro: 55 -për qind të mjeteve do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, kurse 45-përqind nga donacionet.

MASHT ka ndarë një buxhet në vlerë të 13 milion Euro për implementimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas për vitet 2007-2017. MASHT ka bërë një vlerësim të nevojave për arsim për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe partnerët tjerë ministria ka organizuar trajnime për të gjithë arsimtarët e të gjitha niveleve të shkollimit mbi praktikën dhe metodologjitë e reja të arsimit. Janë organizuar këto trajnime të vazhdueshme “ Nxënësi në Qendër”, “ Të drejta e Fëmijut”, “Mendimi Kritik” etj. Procesi i trajnimit ka filluar në vitin 2002 dhe ende po vazhdon. Deri më tani më shumë se 80% e mësuesve nga të gjitha nivelet kanë qenë të përfshirë në këto programe trajnuese. MASHT gjithashtu ka themeluar agjencinë për akreditim dhe licencim të mësuesve. Universiteti i Prishtinës/ Priština dhe MASHT kanë mbështetur të gjithë studentët nga rradhët e komuniteteve pakicë të cilët kanë përfunduar studimet universitare dhe janë të interesuar për doktoraturë apo magjistraturë. MASHT ka bërë rezervimin e vendeve të lira në universitet dhe konvikte për studentët e interesuar. MASHT gjithashtu ka vendosur kuotën e punësimit të personelit kadrovik nga rradhët e minoriteteve në të gjitha profilet. Që nga viti 2002 në MASHT janë të punësuar 62 pjestarë nga rradhët e grupeve komunitare që jetojnë në Kosovë.

¹³⁴ Dituria Jonë/Naše znanje ,është tekst shkollor për shkollë fillore.

¹³⁵ Një qasje e tillë nuk ndikon negativisht në ashkalinjtë dhe egjiptasit, të cilët, ashtu siç është thënë, gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare.

Në Kosovë ende nuk ekziston ndonjë shkollë ku mësimi zhvillohet në gjuhën Rome. Të gjithë nxënësit rom janë të integruar dhe vijnë në mësimin bashkë me nxënësit shqiptar në shkolla në gjuhën shqipe. MASHT, gjatë vitit 2009 do të realizojë një hulumtim për të parë nëse fëmijët rom që vijnë në mësimin në këto shkolla janë të segreguar në ndonjë mënyrë.

“MASHT ka ofruar mundësi për të gjithë donatorët që janë të interesuar të mbështesin sistemin arsimor. Donorët e ndryshëm, siq janë KFOS dhe UNDP kanë ofruar bursa të ndryshme për të mbështetur studentët të cilët kanë gjendje të keqe ekonomike. Për vitet 2009-2010 MASHT ka marrë vendimin që të përfshijë në studime të gjithë nxënësit nga rradhët e minoriteteve të cilët dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin pa marrë parasysh suksesin e tyre. Kuota e vendosur për studentët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas është 38. Në përputhje me kërkesat e strategjisë ne do të ofrojmë bursa shkollare për të stimuluar studimet e këtyre studentëve.”

E.K, zyrtare e lartë në MASHT
Intervistë e FDH-Kosovë, 21 qershor 2009

MASHT ka filluar trajnimin e mësuesve nga rradhët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas duke organizuar shkolla verore dhe duke përgaditur planprogramin në gjuhën Rome. Këto ligjerata mbahen në gjuhën Rome.

MASHT do të përfshijë lëndën mësimore “Gjuha Rome me elementet e historisë dhe kultures” në planprogram si lëndë zgjedhore në shkollat fillore në vitin 2009. Përveq gjuhës rome si lëndë mësimore, MEST duhet të përgadisë planprogramin për lëndët tjera që do të mbahen në gjuhën rome. MASHT ka formuar një grup punues që është duke rishikuar të gjitha tekstet dhe materialet shkollare në lidhje me gjuhën diskriminuese apo inflamatore. MASHT gjithashtu ka rishikuar planprogramet mësimore për shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë duke shtuar elementet e tolerancës, barazisë gjinore dhe të drejtat e fëmijut.

2.4. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS)

MKRS-ja është përgjegjëse për implementimin e nenit 5 të Ligjit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Thelbi i këtij neni është kultivimi i traditës dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore të komuniteteve etnike që jetojnë në Kosovë.

Kjo ministri përbëhet nga tri departamente të cilat mbulojnë sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit. Departamenti i kulturës është ai i cili drejtpërdrejt merret me implementimin e nenit 5 të këtij ligji. Ky departament përbëhet nga dy njësi: njësi për promovim (promovimi i diversitetit kulturor, dialogut ndëretnik dhe integritit të komuniteteve) dhe njësi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Buxheti i departamentit të kulturës për vitin 2009 ishte 70.000 Euro. Njëzet për qind (20%) e këtij buxheti është ndarë për njësinë e promovimit.

Për vitin 2009, për departamentin e rinisë janë ndarë 32.700 euro. Në këtë mënyrë ministria dëshiron që klubet sportive të komuniteteve etnike të përfshihen në shoqatat sportive të Kosovës si dhe të inkuadrojnë rininë e komuniteteve etnike në jetën kulturore të Kosovës, me qëllim të integritit të tyre në shoqërinë e re kosovare.

Një nga kushtet për licencimin e federatave sportive të Kosovës është përmbushja e përqindjes së pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë në Komitetin e federatës sportive. Në federatat e licencuara, nënkryetari i federatës është pjesëtar i komunitetit pakicë. Në kuadër të federatës janë regjistruar edhe 27 klube sportive të komuniteteve etnike, të cilave u është ofruar mbështetje financiare për pajisje sportive. Shumica e përfituesve të këtyre projekteve janë të rinj nga radhët e komunitetit serb nga Graçanica, Priluzhja, Zubin Potoku, Recani dhe Rahoveci.

F.S. koordinatorë zyrës për të drejtat e njeriut në MKRS

Intervistë e FDH-së, 5 nëntor 2008

MKRS ka identifikuar qështjet në të cilat do të jetë e involvuar drejt implementimit të strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. Gjatë kohës së përgaditjes së këtij raporti kjo ministri ende nuk ka ndarë buxhetin përkatës. Në vitin 2008, departamenti i kulturës ka mbështetur dhjetë projekte të implementuara nga organizata të ndryshme nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Këto projekte kanë përfshirë botimin e librave, realizimin e shfaqjeve teatrale në gjuhën rome dhe pjesëmarrje në ngjarje të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare siq është Kongresi Botëror i Romëve që është mbajtur në Zagreb/Zagreb- Kroaci.

“MKRS në mënyrë të vazhdueshme ka mbështetur ngjarjet kulturore “Javën e Kulturës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas” ne gjithashtu kemi sponsorizuar publikimin e albumit (CD-së) me këngë rome. Përpos kësaj ne kemi organizuar fushata informuese me qëllim të promovimit të vlerave kulturore të këtyre komuniteteve”

F.S. Koordiantor e zyrës për të drejtat e njeriut në MKRS

Intervistë e FDH- Kosovë , 17 qershor 2009

2.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale -MPMS

MPMS ende nuk ke hartuar strategjinë e punësimit. Në mungesë të strategjisë ata kanë miratuar masa lehtësuese për të ndihmuar punësimin e pjestarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas. MPMS, ofron kurse aftësimi për pjestarët e këtyre komuniteteve. Masë tjetër lehtësuese që ka aplikuar kjo ministri është mos ndërprerja e ndihmës sociale kur pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë qenë të punësuar përkohësisht. MPMS ka organizuar fushata informative për Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptasit në vendet ku ata jetojnë mbi kushtet dhe procedurat për marrjen e ndihmës sociale. Ligji mbi ndihmën sociale ka vendosur kriteret dhe kushtet për marrjen e ndihmës sociale ndërsa ministria siguron implementimin e tij. Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare MPMS ka implementuar projekte të ndryshme duke mbështetur viktimat e dhunës familjare. Pjestarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas gjithashtu kanë qenë pjesë e këtyre projekteve.

2.6. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)

Shumica e projekteve dhe aktiviteteve të MKK që janë të fokusuara drejt përmirësimit të drejtave të pakicave dhe iniciativat në lidhje me pozitën e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas janë realizuar në bashkëpunim me ministrinë e shëndetësisë dhe atë të arsimit.

Me qëllim që të identifikohen hapat që duhet të ndërmerren drejt implementimit të strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas, ministria ka themeluar një grup punues. Përfaqësuesit e këtyre komuniteteve gjithashtu janë anëtarë të këtij grupi punues. Projektet në mbështetje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas kanë qenë të fokusuara në fushën e infrastrukturës, ndërtimin e rrugëve dhe objekteve të banimit, legalizimin e vendbanive jo formale, arsim dhe shëndetësi.

Për vitin 2009, ministria ka ndarë 50 bursa shkollimi për nxënësit e shkollave të mesme dhe dhjetë bursa për studentet në universitet. Përveç këtyre projekteve, zyrtarët e ministrisë pohojnë se ata kanë mbështetur projekte të ndryshme kulturore dhe kanë realizuar fushata vetëdijësuese.

3. MEDIET

Mediat e mëposhtme në Kosovë transmetojnë program në gjuhën rome:

Nr.	Rajoni	Lokacioni	Mediumi	Kohëzgjatja e programit që transmetohet në gjuhën rome
1	Pejë/Peja	Pejë/Peja	Radio Peja	30 minuta /në javë
2	Prizren/Prizren	Prizren/Prizren	Radio Yeni Donem	1orë /ditë
3	Prizren/Prizren	Prizren/Prizren	Radio Romano Avazo	24 orë
4	Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/Urosevac	RTV TEMA	15 min/ditë
5	Gjilan/Gnjilane	Kamenicë/Kamenica	Radio Kamenica	60 min/ditë
6	Gjilan/Gnjilane	Novoberdë/Novobrdë	Radio Youth Voice	60 min/ditë
7	Prishtinë/Prishtina	Gracanica/Gracanica	Radio Gracanica	60 min/javë
8	Prishtinë/Prishtina	Fushe Kosovë/Kosovo Polje	Radio K	150 min /ditë
9	Prishtinë/Prishtina	Cagllavice/Cagllavica	Radio Kim	3 hours/ javë
10	Prishtinë/Prishtina	Preoce/Preoce	Radio Vitez	-----
11	Prishtinë/Prishtina	Podujevë/Podujevo	Radio Vizioni	5 min/ditë

12	Prishtinë/Prishtina	Obiliq/Obilic	Radio Evropa	30 min/ditë
13	Prishtinë/Prishtina	Prishtinë/Prishtina	Radio Kosova	6 orë/ javë
14	Prishtinë/Prishtina	Prishtinë/Prishtina	RTK	1orë/javë
15	Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/Mitrovica	Radio Contact Plus	45 min/javë
16				
17				

PART –III- Institutional Framework for Communities ¹³⁶

I. Hyrje mbi komunitetet në Kosovë

1.1 ‘Komunitetet’ në Kosovë

Termi ‘komunitet’ në Kosovë përdoret në dy nivele. Në njërin anë, ai e ka kuptimin standard të një grupi njerëzish që ndajnë një vetëdije mbi karakteristika të përbashkëta, siç është etniciteti, gjuha ose feja. Sipas këtij kuptimi, ‘komunitetet’ do t’i referohej të gjitha grupeve etnike në Kosovë, pa marrë parasysh nëse janë numerikisht shumicë apo pakicë. Në anën tjetër, termi ‘komunitet’ përdoret edhe për t’iu referuar minoriteteve të Kosovës – komuniteteve etnikisht jo-shqiptare, përfshirë serbët, turqit, boshnjakët, goranët, si dhe romët, ashkalit dhe egjiptasit (RAE).

II. Evoluimi i institucioneve përgjegjëse për komunitetet

2.1 Institucionet përgjegjëse për komunitetet gjatë qeverisjes së UNMIK-ut

Kosova hyri nën administrimin e UNMIK-ut më 1999, pas *Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së*. UNMIK-u e kishte mandatin e gjerë për të siguruar “administrimin e përkohshëm duke themeluar dhe mbikëqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushtet për një jetë paqësore dhe normale të të gjithë banorëve në Kosovë.”¹³⁷ Për arritjen e këtij qëllimi, UNMIK-u vendosi më 2001 *Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Kornizën Kushtetuese)*, e cila hapi rrugën për transferimin gradual të përgjegjësisë nga UNMIK-u te IPVQ-të. Në kuadër të *Kornizës Kushtetuese*, Kapitulli 3 mbi *Të Drejtat e Njeriut* vendosi standardet universale të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën e kthimit, bazuar në normat evropiane dhe ndërkombëtare. Më tej, Kapitulli 4 mbi *Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre* siguroi, specifikisht për komunitetet, një sërë të drejtash sociale dhe kulturore. *Korniza Kushtetuese* dhe rregulloret pasuese gjithashtu përvijuan struktura shtesë në kuadër të IPVQ-ve, përfshirë disa institucione kyçe për të drejtat e njeriut (the ZKQM

¹³⁶ This chapter of the report is taken mainly from Policy Briefing Paper on the Governmental Institutional Framework for Communities in Kosovo- ECMI Report, November 2008

¹³⁷ *Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999)*, KSOKB, qershor 1999. (Shtojca II, Neni 5)
<http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf>

dhe Institucioni i Ombudspersonit) dhe komunitetet (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre dhe për Kthim në kuadër të Kuvendit të Kosovës (KDIKK), Zyra Këshillëdhënëse për Çështje të Komuniteteve (ZKÇK) dhe, më 2005, MKK-ja).

2.1 Institucionet përgjegjëse për komunitetet gjatë qeverisjes së UNMIK-ut

Kosova hyri nën administrimin e UNMI-ut më 1999, pas *Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së*. UNMIK-u e kishte mandatin e gjerë për të siguruar “administrimin e përkohshëm duke themeluar dhe mbikëqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushtet për një jetë paqësore dhe normale të të gjithë banorëve në Kosovë.”¹³⁸ Për arritjen e këtij qëllimi, UNMIK-u vendosi më 2001 *Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Kornizën Kushtetuese)*, e cila hapi rrugën për transferimin gradual të përgjegjësisë nga UNMIK-u te IPVQ-të. Në kuadër të *Kornizës Kushtetuese*, Kapitulli 3 mbi *Të Drejtat e Njeriut* vendosi standardet universale të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën e kthimit, bazuar në normat evropiane dhe ndërkombëtare. Më tej, Kapitulli 4 mbi *Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre* siguroi, specifikisht për komunitetet, një sërë të drejtash sociale dhe kulturore. *Korniza Kushtetuese* dhe rregulloret pasuese gjithashtu përvijuan struktura shtesë në kuadër të IPVQ-ve, përfshirë disa institucione kyçe për të drejtat e njeriut (the ZKQM dhe Institucioni i Ombudspersonit) dhe komunitetet (Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre dhe për Kthim në kuadër të Kuvendit të Kosovës (KDIKK), Zyra Këshillëdhënëse për Çështje të Komuniteteve (ZKÇK) dhe, më 2005, MKK-ja).

Më 2003, UNMIK-u futi në përdorim politikën e *Standardeve për Kosovën*, e cila u dha prioritet masave që do të krijonin një Kosovë të qëndrueshme, shumë-etnike.¹³⁹ Standardet kishin për synim ngritjen e kapaciteteve të IPVQ-ve të Kosovës, duke siguruar në të njëjtën kohë komunitetet e Kosovës, sidomos Serbët, se interesat e tyre janë prioritet i bashkësisë ndërkombëtare dhe kusht për më shumë vetë-qeverisje.¹⁴⁰ Standardi IV mbi *Kthimin e Qëndrueshëm dhe të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre* kishte të bënte specifikisht me komunitetet në Kosovë, me një fokus të veçantë në çështjen e kthimit dhe mbrojtje të bazuar në të drejta për minoritetet. Përmbushja e standardeve ishte vënë si kusht për fillimin e diskutimeve mbi statusin e ardhshëm të Kosovës dhe, si të tilla, IPVQ-të bënë përpjekje të mëdha për t’i përmbushur ato. Sidoqoftë, implementimi i Standardit IV dhe mbrojtja e komuniteteve në përgjithësi praktikisht ishin përfshirë në masë të madhe në kuadër të të drejtave të njeriut dhe procesit të demokratizimit. Ndërsa shumë të drejta ligjore u ishin dhënë komuniteteve përmes legjislacionit, implementimi i këtyre të drejtave ishte shpesh i parregullt dhe nuk ishte vendosur një qasje gjithëpërfshirëse ndaj të drejtave të njeriut. Struktura institucionale ishte zhvilluar kryesisht në mënyrë *ad hoc*, si përgjigje ndaj kërkesave politike, institucionet ishin krijuar shpejt pa planifikim ose integrim të mjaftueshëm në kuadër të strukturave ekzistuese. Për më tepër, institucionet ishin krijuar para alokimit të resurseve. Në të njëjtën kohë, politika e Standardeve ishte e suksesshme në përmirësimin e kapaciteteve të IPVQ-ve dhe hapën rrugën që negociatat për status të nisin zyrtarisht më 2006, të cilat do të rezultojnë në një zgjidhje politike që do të përcaktonte statusin e ardhshëm të Kosovës. Gjatë negociatave

¹³⁸ *Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999)*, KSOKB, qershor 1999. (Shtojca II, Neni 5)

<http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf>

¹³⁹ *Standardet për Kosovën* (versioni anglisht), UNMIK, mars 2003, Prishtinë.

<http://www.unmikonline.org/standards/priorities.htm>

¹⁴⁰ Poaty.

për status, i Dërguari Special i OKB-së për Kosovën, Z. Maarti Ahtisaari, zhvilloi *Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës*. Ai iu kumtua Këshillit të Sigurimit të OKB-së nga Sekretari i Përgjithshëm më 26 mars 2007, bashkë me raportin e Ahtisaarit mbi statusin e ardhshëm. Ky raport rekomandoi pavarësinë, të mbikëqyrur bashkërisht nga bashkësia ndërkombëtare, si zgjidhjen e vetme të zbatueshme. Kjo do të siguronte më shumë përgjegjësi dhe llogaridhënie nga ana e institucioneve të Kosovës duke siguruar mbikëqyrje ndërkombëtare mbi mbrojtjen e komuniteteve dhe çështje të tjera vitale.¹⁴¹ Propozimi për status definoi dispozitat e domosdoshme për një Kosovë të ardhshme demokratike, përfshirë masa të detajuara për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

2.2 Institucionet përgjegjëse për komunitetet në Kosovën e pas-statusit

Më 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë, të pasuar nga një periudhë transitore 120-ditore derisa IPVQ-të përgatiteshin për të marrë pushtet të plotë ekzekutiv. Përgjatë këtij tranzicioni, mbrojtja e të drejtave dhe interesave të komuniteteve të Kosovës ka qenë preokupim kryesor. Kuvendi miratoi 41 ligje të reja për të arritur pajtim me *Propozimin e Ahtisaarit* dhe vendosi kornizën ligjore që nevojitej për hyrjen në fuqi të Kushtetutës. Kjo përfshinte legjislacionin që ka të bëjë me komunitetet që do të mundësonte decentralizimin dhe krijimin e zonave të veçanta të mbrojtura (p.sh. *Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës*, prej këtu e tutje *Ligji mbi Komunitetet*). Të drejtat dhe mbrojtja e komuniteteve garantohen qëndrueshëm me *Kushtetutë*, e cila gjithashtu siguron kornizën për themelimin e institucioneve përgjegjëse për adresimin e nevojave të komuniteteve. Për më tepër, Qeveria e Kosovës ka përgjegjësi specifike sa i përket mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve përmes obligimeve ndërkombëtare për zbatimin e të cilave obligohen IPVQ-të (përkatesisht në lidhje me *Konventën Kornizë*) dhe si kusht për integrim evropian.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, i cila u miratua më 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008, ka inkorporuar shumë nga dispozitat e Shtojcës XII të *Propozimit të Ahtisaarit*. Ajo ofron garancitë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe vendos një sistem shumë-nivelësh dhe reciprokisht bllokues të mbrojtjeve për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre. Specifikisht, Neni 58, Kapitulli III, i *Kushtetutës* përcakton përgjegjësitë e Shtetit ndaj komuniteteve. Sipas këtyre dispozitave, Qeveria duhet të:

1. Sigurojë kushtet e duhura që do t'u mundësonin komuniteve dhe pjesëtarëve të tyre të ruajnë, mbrojnë dhe zhvillojnë identitetet e tyre.
2. Promovojë një frymë tolerance e dialogu, dhe të mbështesë pajtimin në mes të komuniteteve.
3. Marrë të gjitha masat e domosdoshme për të mbrojtur individët të cilët mund tu nënshtrohen akteve të diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës për shkak të identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.
4. Marrë masa të duhura që mund të jenë të domosdoshme për të promovuar barazi të plotë dhe efektive në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha sferat e jetës.
5. Promovojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare.¹⁴²

¹⁴¹ Raporti in të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Statusin e Ardhshëm të Kosovës, 26 mars 2007, <http://www.unosek.org>

¹⁴² *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, shkurt 2008, Prishtinë. (Kapitulli III, Neni 78)

Dispozitat e *Kushtetutës* mbi komunitetet janë përpunuar më tej në *Ligjin mbi Komunitetet*, i cili ka hyrë në fuqi bashkë me *Kushtetutën*. *Ligji mbi Komunitetet* ka përcaktuar se ‘Kosova do të marrë masa speciale për të siguruar barazinë e plotë dhe efektive në mes të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre’.¹⁴³ Nenet e ligjit sigurojnë një sërë të drejtash kundër diskriminimit dhe të bazuara në promovimin e komuniteteve, të cilat mbulojnë: identitetin, barazinë e plotë dhe efektive, gjuhën, kulturën, mediat, religjionin, arsimimin, mundësitë ekonomike dhe sociale, shëndetësinë dhe pjesëmarrjen politike. Këto ligje, dhe *Kushtetuta*, kanë vendosur një sistem të mbrojtjes së komuniteteve i cili duhet t’i përmbush zotimet ndërkombëtare të Kosovës dhe kërkesat e saj për integrim evropian, për aq sa ato mund të zbatohen efektivisht. Në përputhje me këtë, fokusi gradualisht është zhvendosur në zhvillimin e institucioneve të ngarkuara me implementimin e të drejtave të komuniteteve dhe integritit të tyre në një strukturë të gjithëmbarshme institucionale efektive në Kosovë.

Bashkë me përgjegjësitë e shtuara të institucioneve të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë, dy institucione të reja, që merren pikërisht dhe vetëm me të drejtat dhe interesat e komuniteteve, janë në themelimin e sipër. Neni 60 i *Kushtetutës* përcakton themelimin e KKK-së në kuadër të Zyrës së Presidentit (ZP). KKK-ja ka për synim të jetë mekanizmi primar për konsultim me komunitetet, përfshirë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarët e qeverisë. Mandati i KKK-së përvijohet më tej në Nenin 12 të *Ligjit mbi Komunitetet*, përfshirë konsultimet në lidhje me legjislacionin, ndarjen e fondeve dhe ngritjen e vetëdijes. KKK-ja është themeluar formalisht më 15 shtator 2008 përmes një Dekreti Presidential dhe tani po bëhet operacional. Institucioni i dytë i ri, ZÇK-ja në kuadër të ZKM-së, shkon përtej kërkesave kushtetuese. ZÇK-ja ka për synim, mbi të gjitha, të koordinojë të gjitha iniciativat brenda qeverisë në lidhje me komunitetet. Themelimi i këtij institucioni po udhëhiqet nga ZKM-ja, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, me qëllim që të plotësojë një hendek të rëndësishëm në qasjen e qeverisë ndaj komuniteteve. Tashmë janë hartuar Termat e Referencës për ZÇK-në dhe zyra do të funksionalizohet së shpejti. Sapo që KKK dhe ZÇK të jenë plotësisht funksionale, qeveria duhet të ketë themeluar një strukturë institucionale për të adresuar nevojat e komuniteteve në mënyrë gjithëpërfshirëse. Më pas qeveria duhet ta zhvendosë vëmendjen në atë që të sigurohet se secili institucion përgjegjës për komunitetet po përmbush në mënyrë të efektshme mandatin e tij të veçantë, dhe se të gjithë institucionet po bashkëpunojnë suksesshëm.

III. Mekanizmat institucionalë ekzistues

Ky kapitull synon të shqyrtojë institucionet që merren gjerësisht me të drejtat e njeriut, si dhe ato që fokusohen veçanërisht në çështjet e komuniteteve, të cilat janë themeluar gjatë ekzistimit të IPVQ-ve dhe vazhdojnë të funksionojnë si institucione të Kosovës. Përmes vlerësimit të mandatit dhe aktiviteteve të secilit institucion, ky kapitull do të analizojë shkallën deri ku secili institucion i adreson nevojat e komuniteteve. Bazuar në këtë vlerësim do të jepen rekomandime mbi atë se si të përshtaten mandatet e tyre për të përmbushur më së miri nevojat e komuniteteve në kushtet e reja të krijuara në Kosovë.

¹⁴³ *Ligji për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës*, shkurt 2008, Prishtinë. (Neni 1, Paragrafët 1.1 dhe 1.2)

3.1 Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore

ZKQM është operacionale në kuadër të ZKM-së që nga marsi 2002. Sipas legjislacionit, funksionet kryesore të ZKQM-së përfshijnë:

- Të mbikëqyr dhe këshillojë ministrinë në fushat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe barazisë gjinore.
- Të zhvillojë udhëzues për politika dhe çështje të veçanta në fushën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe barazisë gjinore.¹⁴⁴

ZKQM është përgjegjëse për shqyrtimin e legjislacionit, si dhe të politikave, procedurave dhe praktikave, për pajtueshmërinë e tij me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut dhe praktikave të qeverisjes së mirë, dhe, në përputhje me këtë, për t'i dhënë rekomandime Kryeministrit dhe ministrive relevante.¹⁴⁵ Mandati i saj është i formuluar gjerësisht dhe ZKQM nuk është institucion që u përkushtohet pikërisht dhe vetëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Sidoqoftë, ajo ka është mandatar shprehimisht që “të konsultohet me përfaqësuesit e komuniteteve dhe të zhvillojë organe konsultative për të adresuar qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, mundësitë e barabarta dhe çështjet gjinore”.¹⁴⁶ Kjo nënkupton që, ndonëse nuk është specifikisht e obliguar të mbrojë të drejtat e komuniteteve, ZKQM mund të merret me çështje të komuniteteve në kontekstin e obligimeve të saj për të mbrojtur të drejtat e njeriut, inkurajuar mundësitë e barabarta, adresuar çështjet gjinore dhe për të mirëmbajtur qeverisjen e mirë.

Për më tepër, ZKQM fillimisht ka mbështetur punën e ZKÇK-së në kuadër të ZKM-së, të cilat të dyja ishin themeluar duke u bazuar në *Rregulloren 2001/19*. ZKÇK kishte mandatin për “të monitoruar gjendjen rreth të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe t'i rekomandonte Qeverisë masat për të adresuar çështjet e komuniteteve”.¹⁴⁷ Akoma më tej, ky organ ishte mandatar për të shqyrtuar draftet e legjislacionit dhe politikat e degës ekzekutive për pajtueshmërinë e tyre me të drejtat e komuniteteve, për të asistuar në shpërndarjen e informacionit publik mbi komunitetet dhe për të bashkërenduar punën me komunat dhe organizatat jo-qeveritare në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtave të komuniteteve.¹⁴⁸ Ndonëse ZKÇK kishte filluar së funksionuari dhe po luante rol aktiv në kuadër të ZKQM-së, ajo u zhvendos më pas në MKK me themelimin e kësaj të fundit më 2005, pasi që mandati i saj që lidhej me komunitetet dukej se binte në kuadër të përgjegjësisë të kësaj ministrie (Shikoni nën §3.4 në këtë raport). Me këtë ZKQM-së dhe ZKM-së iu hoq çfarëdo përgjegjësie e e qartë dhe precize për komunitetet. Megjithatë, detyra e sipërpërmendur e ZKQM-së për t'u konsultuar me komunitetet, së bashku me mandatin e gjerë të ZKQM-së në fushën e të drejtave të njeriut, e vë mbrojtjen e komuniteteve në kuadër të përgjegjësisë të ZKQM-së.

¹⁴⁴ *Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19* (versioni anglisht), UNMIK, shtator 2001, Prishtinë. (Shtojca I, seksioni C) http://www.unmikonline.org/regulations/2005/RE2005_15.pdf

¹⁴⁵ Poaty.

¹⁴⁶ Poaty.

¹⁴⁷ *Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19* (versioni anglisht), UNMIK, shtator 2001, Prishtinë. (Shtojca I, seksioni D) <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg19-01.pdf>

¹⁴⁸ Poaty.

Praktikisht perceptimi nga vetë ZKQM-ja i mandatit të saj thekson çështjet e të drejtave të njeriut më tepër sesa ato që lidhen pikërisht dhe në mënyrë precize me komunitetet. Sipas deklaratës së qëllimeve të saj, të publikuar në sajtin e saj në nëntor 2007, përgjegjësitë e ZKQM-së përfshijnë:

- Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, me theks të veçantë në të drejtat e grave, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.
- Vetëdijesimin e zyrtarëve qeveritarë për të respektuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- Luftimin e keqpërdorimeve dhe korrupsionit.
- Inicimin, hartimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të politikave, planeve të veprimit dhe strategjive në sferën e Qeverisjes së Mirë, të Drejtave të Njeriut, Mundësive të Barabarta dhe Çështjeve Gjinore.¹⁴⁹

Përqendrimi i punës së ZKQM-së rreth të drejtave të njeriut u përforcua në qershor 2007 kur Qeveria miratoi *Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit të Kosovës për të Drejtat e Njeriut: 2007-2010 (SPKKVDNj)*.¹⁵⁰ ZKQM-ja ka qenë agjencia udhëheqëse qeveritare në zhvillimin e SPKKVDNj-së, e cila skematizon një strategji gjithëpërfshirëse dhe të integruar për të adresuar të gjitha aspektet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e komuniteteve. Për më tepër, SPKKVDNj përvijon hapa konkretë dhe masa programatike për zbatimin e mbrojtjeve për të drejtat e njeriut. Ndonëse të përfshira në planin e gjithëmbarshtëm, të drejtat e komuniteteve përbëjnë vetëm një kapitull të Strategjisë si tërësi.

3.2 Njësitë ministrore për të Drejtat e Njeriut

NjDNj-të¹⁵¹ janë themeluar zyrtarisht në mars 2007 për të monitoruar pajtueshmërinë e politikave, legjislacionit dhe aktiviteteve të secilës ministri me standardet e të drejtave të njeriut.¹⁵² Ndonëse kjo nuk i mandaton shprehimisht NjDNj-të për të adresuar të drejtat e komuniteteve, këto të drejta praktikisht konsiderohen pjesë e standardeve të të drejtave të njeriut. Për më tepër, secila NjDNj obligohet të ketë të punësuar një specialist të politikave të komuniteteve, i cili duhet të monitorojë efektin e politikave, legjislacionit dhe aktiviteteve të ministrive të komunitetet.

Në terma ligjorë, secila NjDNj ka një mandatin nga niveli i lartë për të monitoruar punën e ministrisë përkatëse dhe për t'i dhënë këshilla ministrisë në lidhje me politikat e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve. Në praktikë, NjDNj-të kanë tendencë të fokusohen më ngushtë në çështjet e brendshme të pajtueshmërisë me standardet e të drejtave të njeriut, siç është niveli i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve brenda secilës ministri. Ngurrimi i NjDNj-ve për të marrë rol proaktiv dhe udhëheqës në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve buron nga një numër problemesh.

Pikë së pari, të gjitha NjDNj-të përballen me mungesë resursesh, si buxhetore ashtu edhe humane. Në disa raste, kjo nënkupton se NjDNj-të nuk disponojnë me fonde të mjaftueshme për

¹⁴⁹ *Ëëb-sajti i ZKQM-së*, <http://www.ks-gov.net/pm/?menuid=3&subid=1&subs=81&lingo=2> [i vizituar më 21 nëntor 2007]

¹⁵⁰ SPKKVDNj bazohet në dy dokumente ligjore: në *Standardet për Kosovën*, të vitit 2003 dhe në *Vendimin e Kryeministrit*, të korrikut 2005, për themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në të gjitha ministrinë e Qeverisë së Kosovës. *Strategjia dhe Planin Kombëtar Kosovar i Veprimit për të Drejtat e Njeriut 2007-2010*, Qeveria e Kosovës, Prishtinë (f. 8).

¹⁵¹ NjDNj-të nganjëherë quhen Celula për të Drejtat e Njeriut (Shikoni *Raportin e ZKQM-së janar – korrik 2007*).

¹⁵² *Urdhëresa Administrative 8/2005*, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, 2007, Prishtinë. (Neni 7.1, Paragrafi III)

të punësuar staf me orar të plotë. Për shembull, NjDNj-ja në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka vetëm një koordinator dhe tre zyrtarë me gjysmë orari, të cilët ia kushtojnë NjDNj-së vetëm 30% të kohës së tyre të punës.¹⁵³ Së dyti, duket se NjDNj-të përballen me një nivel të ulët të të kuptuarit të mandatit të tyre dhe janë të izoluar nga njëra-tjetra, gjë që çon në mungesën e të kuptuarit më të gjerë, kontekstual të vetë rolit të tyre. Së treti, ndërsa NjDNj-të kanë një shkallë pavarësie, pasi që i raportojnë drejtpërdrejt Sekretarit të Përhershëm, kjo gjithashtu çon në marginalizimin e tyre nga puna e gjithëmbarshme e vetë ministrisë. Kjo e kufizon kapacitetin e NjDNj-ve për të dhënë këshilla mbi politikat, legjislacionin dhe aktivitetet e ministrisë, dhe implikimet e tyre për të drejtat e njeriut. Si rezultat, aty ku NjDNj-të nuk funksionojnë, ato kanë tendencë të vënë theksin më tepër në monitorimin e pajtueshmërisë së brendshme me standardet e të drejtave sesa në efektin më të gjerë të ministrisë mbi të drejtat e njeriut.

Për më tepër, stafi i NjDNj-ve përballen me të kuptuar të pamjaftueshëm të çështjeve të komuniteteve, gjë që rezultojnë në një mungesë të përgjithshme të vetëdijes mbi veçantitë dhe natyrën speciale të të drejtave të njeriut dhe në një tendencë për ta përfshirë mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në kuadër të problemeve rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi. Kjo nënkupton se praktikisht NjDNj-të kanë tendencë që t'i konsiderojnë masat kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të një rëndësie të njëjtë. Për shembull, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka nënvizuar faktin se qendrat për punë sociale janë në dispozicion dhe të obliguara që t'u ndihmojnë pjesëtarëve të komuniteteve. Sidoqoftë, përtej kësaj deklarate për mos-diskriminim nuk merren parasysh çështjet si qasshmëria e pjesëtarëve të komuniteteve në këto qendra. Kjo mungesë e të kuptuarit sa i përket kushteve me të cilat përballen komunitetet dhe pjesëtarët e tyre mbizotëron në të gjitha NjDNj-të. Megjithatë, vërehen përjashtime në disa raste, si për shembull te stafi i MKK-së dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Këto dy ministri kanë mandat më të qartë sa i përket mbrojtjes së komuniteteve, dhe si të tilla, NjDNj-a e MKK-së dhe Departamenti për Komunitete dhe Mundësi të Barabarta në kuadër të MASHT-it demonstrojnë njëfarë të kuptuari më të mirë të çështjeve të komuniteteve. Megjithatë, ka nevojë të madhe për përmirësimin e njohurive të stafit të NjDNj-ve mbi të drejtat e komuniteteve për të siguruar që nevojat e komuniteteve të pasqyrohen në zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut nga ana e tyre.

3.3 Koordinator për të Drejtat e Njeriut

Në maj 2007, Kryeministri ka krijuar pozitën e Koordinatorit për të Drejtat e Njeriut brenda Qeverisë së Kosovës (KDNJ) dhe ka emëruar Z. Habit Hajredinin, i cili është edhe Drejtor i ZKQM-së. KDNJ, në kuadër të ZKM-së, ka mandatin për të:

- Koordinuar punën e NjDNj-ve në ministritë e Qeverisë së Kosovës, me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë (shikoni nën §3.2).
- Koordinimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me raportimin të mekanizmat e Qeverisë së Kosovës për të Drejtat e Njeriut.¹⁵⁴

Fushëveprimi i KDNJ-së është përkufizuar shumë gjerë. Në përputhje me tendencën për të trajtuar të drejtat e komuniteteve si pjesë e të drejtave të njeriut, në mandatin e KDNJ-së nuk ka

¹⁵³ Intervistë me Z. Armend Rugovën, Koordinator i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 12 shtator 2007, Prishtinë.

¹⁵⁴ *Vendimi nr. 131 i Kryeministrit*, Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës, maj 2007, Prishtinë.

as referencë konkrete të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe të çështjeve relevante për ta. Megjithatë, sikurse edhe në rastin e ZKQM-së, mbrojtja e komuniteteve konsiderohet vetvetiu pjesë e mandatit të KDNj-së.¹⁵⁵

3.4 Ministria për Komunitete dhe Kthim

MKK-ja është themeluar më 2005.¹⁵⁶ Ajo është ministria që i është dhënë detyra e mbrojtjes dhe promovimit të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Shtojca XII e *Rregullores së UNMIK-ut 2005/15* e përcakton mandatin e MKK-së, i cili përfshin:

- Zhvillimin e politikave, dhe promovimin dhe implementimin e legjislacionit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë të drejtën për kthim.
- Promovimin e krijimit të kushteve të favorshme për kthim dhe sigurimin e një qasjeje të bazuar në të drejta sa i përket kthimit.
- Luajtjen e një roli udhëheqës në aktivitetet për ndërtimin e mirëbesimit, dialog dhe pajtim në mes të komuniteteve, dhe në mbështetjen e implementimit të këtyre aktiviteteve.
- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të strategjive të Qeverisë për zbatim praktik në terren sa i përket komuniteteve dhe kthimit, si dhe mbështetjen në zhvillimin dhe implementimin e strategjive të tilla në të gjitha komunat.¹⁵⁷

Njëra nga sfidat kryesore me të cilën përballlet MKK-ja është legjitimiteti i saj në mesin e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Kjo është pjesërisht për shkakun se ekziston njëfarë ndjenje dyshimi dhe droje në mes të qeverisë së mbizotëruar nga shqiptarët dhe komuniteteve, gjë që kufizon mundësinë e ministrisë për të ndërvepruar drejtpërdrejt me komunitetet. Për më tepër, komunitetet jo-serbe e perceptojnë MKK-në si institucion që u ndihmon vetëm serbëve, gjë që buron pjesërisht nga fakti se udhëheqja e MKK-së mbizotërohet nga serbë. Kjo kufizon efektshmërinë e ministrisë në punën e saj me komunitetet, gjë që parqet një sfidë të dukshme ndaj qasjes së gjithëmbarshme të qeverisë ndaj komuniteteve për shkak të rolit qendror të MKK-së.

3.5 Ombudspersoni

Institucioni i Ombudspersonit, i themeluar në qershor të vitit 2000, është organ i pavarur i mandatuar për të adresuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut ose keqpërdorimin e nga ana e institucioneve publike në Kosovë.¹⁵⁸ Megjithëse i zhvilluar gjatë kohës së qeverisjes së UNMIK-ut, roli dhe kompetencat e Ombudspersonit janë ri-konfirmuar në *Kushtetutën e Kosovës*. Sipas Nenit 132, “Ombudspersoni monitoron, mbron dhe ruan të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet e gabuara të autoriteteve publike ose nga dështimi i tyre për të vepruar.”¹⁵⁹ Ombudspersoni ka qene fillimisht nën udhëheqjen ndërkombëtare, por institucioni është ristrukturuar në vitin 2006 për të marrë rol më të madh vendor, përfshirë transferimin e

¹⁵⁵ Punëtoritë me Koordinatorin për të Drejtat e Njeriut/ZKM dhe Njësitë për të Drejtat e Njeriut, ECMI Kosovo, gusht 2007, Prishtinë.

¹⁵⁶ *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/15* (versioni anglisht), UNMIK, mars 2005, Prishtinë. (Shtojca II) http://www.unmikonline.org/regulations/2005/RE2005_15.pdf

¹⁵⁷ Poaty .

¹⁵⁸ *Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/38* (versioni anglisht), UNMIK, qershor 2000, Prishtinë, <http://www.unmikonline.org/reg/2000/reg38-00.htm>

¹⁵⁹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Kuvendi i Kosovës, shkurt 2008, Prishtinë (Neni 132, Paragrafi 1).

pozitës së Ombudspersonit nga një pozitë ndërkombëtare në një pozitë me emërim vendor. Pas këtij transferimi, njëri nga Zëvendësit e Ombudspersonit, Z. Hilmi Jashari, u emërua Ushtrues Detyre i Ombudspersonit derisa Kuvendi i Kosovës të përzgjidhte dhe emëronte Ombudspersonin e ri. Ndonëse janë bërë disa emërimë, procedurat e emërimit janë shtyrë disa herë nga ana e Kuvendit dhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit do të vazhdojë të mbetet në këtë pozitë derisa të emërohet Ombudspersoni tjetër.¹⁶⁰

Ombudspersoni është i mandatuar të “pranojë dhe hetojë ankesat nga cilido në Kosovë që beson se të drejtat e saj/tij të njeriut janë shkelur nga ndonjë autoritet publik vendor në Kosovë”.¹⁶¹ Ai kryen hetime, nxjerr raporte dhe ofron shërbime ligjore dhe aso të mbrojtjes së publikut. Nëse Ombudspersoni konstaton se nëse një praktikë ose situatë e caktuar që ndikon mbi publikun në tërësi ka shkelur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (jo mbi vetëm një person ose grup personash, por, për shembull, mbi një komunitet të tërë), ai mund të nxjerrë një raport special, me rekomandime, për Kuvendin e Kosovës. Në kuadër të Institucionit të Ombudspersonit janë themeluar tri ekipe të cilat përqendrohen në problemet e veçanta të grupeve të cënueshme: Ekipi për të Drejtat e Fëmijëve, Ekipi për Barazi Gjinore dhe Ekipi për Jo-Diskriminim (EJD).

Përbrenda Institucionit të Ombudspersonit, çështjet e komuniteteve janë pjesë e punës së EJD-së. Ndonëse jo-diskriminimi ka bazë të fortë ligjore në Kosovë, diskriminimi është i përhapur kudo dhe pak ankesa i janë dorëzuar Ombudspersonit.¹⁶² Për të adresuar këtë, EJD ka bërë fushata vetëdijesimi në mbarë Kosovën, në të cilat zyrtarët e Ombudspersonit i kanë informuar qytetarët e Kosovës mbi diskriminimin dhe procedurat e dorëzimit të ankesave. Për më tepër, ndonëse puna e Ombudspersonit nuk i adreson përjashtimisht të drejtat e komuniteteve, ai përfshin në raportin e tij vjetor një pjesë e cila adreson specifikisht problemet e të drejtave të njeriut që kanë ndikim te komunitetet minoritare. Për shembull, në raportin e tij të vitit 2008, Ombudspersoni ka identifikuar, në mes të tjerash, probleme në lidhje me: incidente të dhunës në mes të shqiptarëve dhe serbëve, përdorimin e gjuhës në te komunitetet, arsimimin, mungesën e transportit të sigurt për komunitetet, mungesën e vazhdueshme të punësimit dhe qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe sulme në monumentet fetare dhe kulturore të komuniteteve.

Zyra kryesore e Ombudspersonit gjendet në Prishtinë, dhe mbështetet nga pesë zyra në terren dhe dy nën-zyra në mbarë Kosovën. Për më tepër, juristët e Ombudspersonit rregullisht vizitojnë komunat, enklavat dhe hapësirat me popullatë substanciale jo-shqiptare të cilat e kanë të vështirë ta arrijnë vetë Ombudspersonin. Megjithatë, Ombudspersoni nuk ka ndërmarrë ndonjë fushatë të publicitetit ose për rritjen e vetëdijes drejtuar specifikisht komuniteteve dhe në mesin e komuniteteve vazhdon të ekzistojë një nivel i pamjaftueshëm vetëdijeje në lidhje me Ombudspersonin dhe zyrat e tij në terren. Për shembull, komunitetet boshnjake, gorane dhe turke kanë ngritur shqetësimet e tyre te ECMI-ja për qasshmërinë në zyrën e Ombudspersonit dhe efektshmërinë e saj në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve.¹⁶³ Në këtë gjendje siç është aktualisht, mundësia e Ombudspersonit për të përkrahur të drejtat e njeriut për komunitetet është e kufizuar si pasojë e mungesa e qasjes së tyre, si dhe mungesa e besimit te institucioni.

¹⁶⁰ *Raporti i Tetë Vjetor 2007-2008*, Institucioni i Ombudspersonit i Republikës së Kosovës, July 2008, Prishtinë, <http://www.ombudspersonkosovo.org/?cid=2,74>

¹⁶¹ Poaty.

¹⁶² Poaty.

¹⁶³ *Raporti i Punëtorive për Vlerësimin e Nevojave të Komuniteteve me Organizatat Jo-qeveritare Serbe, Boshnjake/Gorane, Turke dhe RAE*, ECMI Kosovo, nëntor 2007, Prishtinë.

3.6 Komisioni parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

KDIKK është komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës, institucionit ligjdhënës të Republikës së Kosovës. Themelimi i këtij Komisionit në kuadër të Kuvendit kërkohet me *Kushtetutë*, gjë që konfirmon rolin e tij jashtëzakonisht të veçantë në procesin ligjvënës.

Sipas Nenit 65 të *Kushtetutës*, Kuvendi:

- Miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
- Miraton buxhetin e Republikës së Kosovës;
- Zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës, në pajtim me *Kushtetutën*;
- Mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike të cilat i raportojnë Kuvendit, në pajtim me *Kushtetutën*; dhe
- Mbikëqyr politikën e jashtme dhe atë të sigurisë.¹⁶⁴

Kuvendi përbëhet njëqind e njëzet (120) deputetë, me përfaqësim të garantuar për komunitetet jo-shumicë, përfshirë së paku dhjetë (10) vende të rezervuar për komunitetin serb të Kosovës, një (1) vend për komunitetin rom, një (1) vend për komunitetin ashkali, një (1) vend për komunitetin egjiptas, plus një (1) vend shtesë për komunitetin me numrin më të madh nga tërësia e votave, (3) vende për komunitetin boshnjak, dy (2) vende për komunitetin turk, dhe një (1) vend për komunitetin goran. Kjo siguron së paku një përfaqësues të komuniteteve të Kosovës në Kuvend, megjithëse numri i tyre mund të rritet bazuar në rezultatet e zgjedhjeve. Për më tepër, neni 81 i *Kushtetutës* mbi Legjislacionin për Interesat Vitale kërkon që miratimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i disa ligjeve, sic janë ato mbi gjuhët, trashëgiminë kulturore, dhe arsimin, si dhe ai mbi ndryshimin e kufijve komunalë, kërkojnë jo vetëm shumicën e votave të Kuvendit, por edhe shumicën e votave përbrenda vendeve të garantuara për komunitetet jo-shumicë. Kjo dispozitë rrit fuqinë e shprehjes së opinionëve të komuniteteve përbrenda Kuvendit dhe siguron që ata të kenë ndikim në legjislacionin që ka më së shumti efekt te ta.

IV. Mekanizmat institucionalë në zhvillim e sipër

Ky kapitull synon të shqyrtojë institucionet e tjera që janë në krijim e sipër për të adresuar në mënyrë specifike nevojat e komuniteteve përbrenda strukturës institucionale të pas-statusit.

4.1 Këshilli Konsultativ për Komunitetet

KKK është institucion i ri i obliguar me *Kushtetutë* për të lehtësuar pjesëmarrjen politike të komuniteteve në nivelin qendror. Formalisht i themeluar përmes Dekretit Presidential të 15 shtatorit 2008, KKK aktualisht po operacionalizohen brenda ZP-së. Ai do të përfshijë në vete përfaqësues të komuniteteve të Kosovës dhe të qeverisë, dhe do të jetë mekanizmi kryesor për konsultim me komunitetet rreth politikave, legjislacionit dhe programeve që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Në mungesë të mekanizmave të tillë konsultues në operim e sipër në nivelin qendror, KKK-ja do të përmbushë një hendek të madh në qasjen e qeverisë ndaj komuniteteve.

¹⁶⁴ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Kuvendi i Kosovës, shkurt 2008, Prishtinë (Neni 65).

Mandati dhe aktivitetet e planifikuara për KKK-në janë përcaktuar në masën më të madhe me legjislacion. Neni 60 o *Kushtetutës* përvijon mandatin e KKK-së si në vijim:

- (1) Të vendosë një mekanizëm të rregullt të shkëmbimit të opinioneve në mes të Komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës.
- (2) T'u japë Komuniteteve mundësinë që të komentojnë në fazat e hershme të nismave legjislative dhe të politikave që do të mund të përgatiteshin nga Qeveria, të propozojë nisma të tilla, dhe të kërkojë që pikëpamjet e tij të inkorporohen në projekte dhe programe relevante.¹⁶⁵

Ligji mbi Komunitetet, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në shkurt 2008 dhe i dekretuar në Ligj më 15 qershor 2008, i shpjegon më në hollësi funksionet e KKK-së. Këto përfshijnë:

- Të asistojë në organizimin dhe artikulin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat publike dhe programet me relevante të veçantë për ta.
- Të vendosë një forum për koordinim dhe konsultim në mes të komuniteteve.
- Të veprojë si mekanizëm për shkëmbimin e rregullt të pikëpamjeve në mes të komuniteteve dhe institucioneve shtetërore.
- T'u mundësojë komuniteteve të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, dizajnimin, monitorimin dhe vlerësimi e implementimit të programeve dedikuar pjesëtarëve të tyre.
- Të ngrit vetëdijen rreth problemeve të komuniteteve në mbarë Kosovën dhe të kontribuojë një zhvillimin e marrëdhënieve harmonike në mes të komuniteteve.¹⁶⁶

KKK-ja do të mbështetet nga organizatat ombrellë që përfaqësojnë komunitetet, të cilat do të koordinohen me organizatat e komuniteteve përkatëse që operojnë nëpër Kosovë në procesin e emërimit kandidatëve përfaqësues. Aktualisht është në rrjedhë e sipër rrethi i parë i përzgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit, të cilët do të përbëjnë dy të tretën e anëtarësisë së Këshillit. Kjo do të përfshijë: pesë përfaqësues nga komuniteti serb, nga tre prej komunitetit boshnjak dhe turk, dhe nga dy përfaqësues që vinë prej komuniteti rom, ashkali, egjiptas dhe goran. Përveç kësaj, komunitete të tjera mund të kërkojnë t'i bashkohen Këshillit me nga një përfaqësues. Pjesa e mbetur e anëtarësisë së Këshillit do të përbëhet nga pjesëtarë të qeverisë ose të agjencive relevante publike që adresojnë çështje me interes të veçantë për minoritetet.

Pikëpamjet e shoqërisë civile në lidhje me KKK¹⁶⁷

Romët

Komuniteti rom përgjithësisht e sheh me optimizëm punën e ardhshme të Këshillit Konsultativ, duke shprehur shpresën se do të kenë mundësi që t'i paraqesin publikisht problemet e tyre, në radhë të parë ato që kanë të bëjnë me asimilimin dhe diskriminimin. Romët janë të kënaqur me kandidatët e propozuar dhe, sipas tyre, gjithë procesi i zgjedhjes ishte transparent dhe demokratik. Posaçërisht janë të kënaqur me faktin se gjatë këtij procesi, romët ishin të ndarë nga ashkalinjtë dhe egjiptianët dhe janë trajtuar si komunitet i veçantë etnik.

¹⁶⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Kuvendi i Kosovës, shkurt 2008, Prishtinë (Neni 60).

¹⁶⁶ *Ligji për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë*, Kuvendi i Kosovës, shkurt 2008, Prishtinë (Neni 12).

¹⁶⁷ HLC report- Begging of the Implementation of the Laë on the Promotion of the Rights of Communities and their members in Kosovo- December 2008.

Pjesëmarrja e politikanëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile njëri pranë tjetrit, sipas mendimit tim do të ketë ndikim negativ, sepse shumica e përfaqësuesve të partive politike vijnë nga shoqëria civile, që mund të ketë për pasojë fërkime dhe konflikt interesash. Mendoj se kandidatët e shoqërisë civile e meritojnë t'i përfaqësojnë interesat e komunitetit. Është mirë që romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët nuk janë futur në të njëjtin thes; por, nuk mund ta kuptojmë se si është marrë vendimi që numri i përfaqësuesve të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të jetë i ndryshëm nga ai i përfaqësuesve të komunitetit serb, turk dhe boshnjak.

K.P. përfaqësues i OJQ-ve të romëve

Intervistë e FDH-së, 1 dhjetor 2008.

Ashkalinjtë

Në fillim të procesit të konsultimeve ashkalinjtë ishin shumë të rezervuar në lidhje me Këshillin, sepse konsideronin që dihej paraprakisht se kush do t'i përfaqësojë ata në Këshillin Konsultues. Megjithatë, më pas e ndryshuan mendjen dhe kanë shprehur kënaqësinë që do ta kenë mundësinë të flasin për problemet e tyre, siç janë varfëria dhe pozita e rëndës e ashkalinjëve të cilët po kthehen nga vendet e Unionit Evropian. Megjithatë, ashkalinjtë mendojnë se komunitetet nuk janë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale në këtë Këshill.

Para mbledhjes kam dëgjuar se përfaqësuesi i komunitetit tonë tashmë ishte zgjedhur. Kjo më tronditi, por pas mbledhjes së parë dhe të dytë ne vet e zgjodhëm përfaqësuesi tanë. Megjithatë, ECMI mendonte se një mbledhje ishte e mjaftueshme, por nuk ishte kështu. Problemi ishte se përfaqësuesit e Kryetarit dhe ECMI në mbledhje nuk kanë qëndruar më shumë se një orë. Nuk kishim kujt t'i parashtrojmë pyetje. Njerëzit në fillim nuk e kuptonin mandatin e këtij Këshilli. Problemi më i madh për funksionimin e tij do të jetë përfaqësimi jo proporcional i komuniteteve.

B.S. përfaqësues i OJQ-ve të ashkalinjëve

Intervistë e FDH-së, 9 dhjetor 2008.

Egjiptianët

Egjiptianët janë të kënaqur me mënyrën se si ka rrjedhur procesi i deritanishëm i nominimit të kandidatëve për pozitë në Këshillin Konsultativ. Ky institucion për egjiptianët mund të jetë shumë i dobishëm dhe mund t'u ndihmojë atyre në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen, e këto janë papunësia, problemet që kanë të bëjnë me arsimin dhe varfërinë.

Këshilli Konsultativ duhet të punojë për komunitete dhe jo për zyrën e Kryetarit. Komunitetet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve i kanë problemet e përbashkëta, por kanë edhe probleme të cilat janë specifike për secilin komunitet. Për komunitetin rom ky problem specifik është pamundësia që të arsimohen në gjuhën e tyre amtare. Egjiptianët nuk e kanë këtë problem. Këshilli Konsultues paraqet një hap të madh përpara, ku komunitetet mund t'i shqyrtojnë dhe t'i zgjidhin problemet ... Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët duhet të vështrohen si tre komunitete të ndryshme, e jo si një, sepse ne jemi të ndryshëm.

B.V. përfaqësues i OJQ-ve egjiptiane

Intervistë e FDH-së, 3 dhjetor 2008.

4.2 Zyra për Çështje të Komuniteteve

ZÇK-ja aktualisht është aktualisht në themelim e sipër, në kuadër të ZKM-së, për të koordinuar qasjen e qeverisë ndaj komuniteteve. Ndërsa një organ i ngjashëm ekzistonte si ZKÇK duke filluar nga viti 2002 (shikoni nën §3.1, 3.4), vendimi për ta zhvendosur këtë zyrë në MKK ka minuar punën e tij. ZKÇK-ja, e cila u bë Departament për Komunitete në MKK, më nuk mori një rol aktiv në koordinimin e qasjes së Qeverisë ndaj komuniteteve, në pjesën më të madhe për shkak të qasjes së saj të kufizuar në strukturën e gjithëmbarshme qeveritare derisa ishte pjesë e ministrisë. Ndonëse ideja për themelimin e një organi të tillë koordinues ri-doli në sipërfaqe në vitin 2006 në draftet fillestare të *Dokumentit Kornizë të Kosovës për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve*, ajo u hoq nga versioni përfundimtar i *Dokumentit Kornizë* që iu dorëzua Maarti Ahtisaarit. Si pasojë, ZÇK-ja mungon në *Propozimin e Ahtisaarit* dhe në *Kushtetutën e Kosovës*. Megjithatë, kjo mungesë koordinimi vazhdoi të mbetej një pamjaftueshmëri në mbrojtjen e komuniteteve nga ana e qeverisë dhe ECMI ka vazhduar të inkurajojë themelimin e një organi të tillë në kuadër të ZKM-së. Më 16 shkurt, ditën para Shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, Kryeministri Thaçi u zotua për të themeluar një zyrë dedikuar ekskluzivisht çështjeve të komuniteteve. Ky njoftim e ri-aktivizoi propozimin për të themeluar një zyrë koordinuese në kuadër të ZKM-së, e cila udhëheq me themelimin e ZÇK-së.

ZÇK-ja ka për synim të korrigjojë një mungesë serioze të koordinimit në qasjen e qeverisë ndaj mbrojtjes së komuniteteve. Që nga themelimi i IPVQ-ve, secila ministri, agjenci e pavarur dhe institut ka ndjekur strategjinë e tij të ndryshme mbi komunitetet. Kjo shpesh ka krijuar konfuzione dhe ka lënë hendeqe në ofrimin shërbimeve, duke krijuar kështu zhgënjim në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve. ZÇK-ja duhet ta adresojë këtë problem në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes mbikëqyrjes së të gjitha aktiviteteve të nivelit qendror që lidhen me komunitetet, në mënyrë që të sigurohet se qeveria ka vendosur një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv të mbrojtjes së komuniteteve.

Deri më sot, mandati i ZÇK-së është akoma duke u negociuar, dhe planifikohet që ajo të jetë operacionale kah fundi i vitit 2008. Drafti aktual i mandatit të saj përfshin përgjegjësi si në vijim:

1. Të këshillojë Kryeministrin për të gjitha çështjet që lidhen me komunitetet.
2. Të koordinojë në çështjet që lidhen me komunitetet, përfshirë:
 - a. Koordinimin e organeve qeveritare, agjencive të pavarura dhe institucioneve/ministrive në nivel qendror dhe komunal.
 - b. Koordinimin e donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare për të siguruar se çështjet e minoriteteve po adresohen efektivisht në mbarë Kosovën.
3. Të ndjekë politikat që lidhen me çështjet e komuniteteve, përfshirë:
 - a. Kontributin në, analizimin dhe dhënien e këshillave në lidhje me politikat e qeverisë që ndikojnë në të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - b. Zhvillimin dhe monitorimin e zbatimit të strategjive qeveritare që lidhen me komunitetet.
 - c. Monitorimin e implementimit të ligjeve dhe politikave në nivel të komuniteteve.
4. Të adresojë nevojat praktike të komuniteteve, përfshirë:
 - a. Përdorimin e fondeve në dispozicion në mënyrë strategjike për të ndikuar pozitivisht dhe ndryshuar jetën e përditshme të njerëzve.

- b. Të përfshihet drejtpërdrejt, sipas nevojës, në zgjidhjen e problemeve të mëdha dhe të lidhura me minoritetet.¹⁶⁸

Procesi i përcaktimit të mandatit të ZÇK-së është shënuar nga konkurrencë dhe rivalitet në mes të zyrave ekzistuese. Për shembull, ZKÇK-ja ka argumentuar se ZÇK-ja do të duhej të funksiononte si nën-zyrë në kuadër të strukturës së saj. Siç përmendet nën §3.1, ZKÇK-ja aktualisht koordinon punën e NjDNj-ve ministrore, secila prej të cilave posedojnë me specialistë për komunitetet. Megjithatë, ZÇKM-ja është tashmë e mbingarkuar për shkak të mandatit të saj të gjerë dhe ambicioz, dhe nuk është e përgatitur të marrë përsipër përgjegjësitë e ZÇM-së. Duke qenë kështu, është vendosur që ZÇK-ja të funksionojë pavarësisht në kuadër të ZKM-së, e cila duhet të lejojë zhvendosjen e fokusit për të bërë të mundur operacionalizimin e plotë të këtij organi dhe zhvillimin e bashkëpunimit me institucione të tjera të përfshira në çështjet e komuniteteve. Megjithatë, edhe pse e formuar afërsisht një vit më parë, kjo zyrë është jofunksionale dhe ka pasur vetëm disa aktivitete. Këto aktivitete kishin natyrë administrative dhe kishin të bëjnë me zgjidhjen e çështjeve të kompetencave, para së gjithash në mes të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, të cilat kanë rol kryesor në realizimin e aktivisteve që kanë të bëjnë me pakicat. Gjithashtu, as koordinimi me ministrinë tjera nuk dha rezultat sa i përket përmirësimit të pozitës së pakicave. Kryeministri e ka iniciuar hartimin e Strategjisë për të drejta e pakicave. Qëllimi i këtij dokumenti duhet të jetë harmonizimi i aktivimeve mes ministrive. Megjithatë, deri më sot nuk ka filluar përgatitja e këtij dokumenti.

Zyra për komunitete kryesisht është marrë me definimin e mandatit dhe funksionit, prandaj nuk është treguar e suksesshme dhe nuk ka komunikuar me ministrinë tjera me qëllim të zgjedhjes së problemeve të ndryshme të komuniteteve pakicë në Kosovë.

F.M. këshilltar i Kryeministrit të Kosovës

Intervistë e FDH-së, 6 nëntor 2008.

Kemi shpenzuar shumë kohë në koordinimin e përpjekjeve me këtë ministri dhe të gjithë partnerët tjerë relevantë për përkufizimin e mandatit të zyrës sonë. Gjithashtu, kemi pasur vështirësi për ta përcaktuar pozitën institucionale të kësaj zyre, si dhe planet dhe aktivitete në të ardhmen. Tash është emërtuar drejtori i zyrës. Jam i vetëdijshëm se na presin shumë punë dhe shpresoj se do të jemi më efikas.

B.I, zëvendës shef i zyrës së Kryeministrit të Kosovës për komunitete

Intervistë e FDH-së, 21 nëntor 2008.

Zyra e kryeministrit për komunitete, siç është paraparë me *Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre* dhe statutin e Këshillit Konsultativ, gjithashtu është anëtar i përhershëm i Këshillit Konsultativ për komunitete. Shefi i zyrës së Kryeministrit për komunitete nuk pajtohet me këtë vendim.

Unë mendoj se nuk është e nevojshme që zyra jonë të ketë karrige të përhershme në këtë organ, meqenëse Qeveria duhet të jetë ajo që implementon politikën dhe vendimet e Këshillit. Unë e shoh rolin e kësaj zyre më tepër në procesin e monitorimit të Këshillit Konsultativ, sesa të përfshihemi në proces si anëtar të përhershëm.

S.S. shef i zyrës së Kryeministrit të Kosovës për komunitete

Intervistë e FDH-së, 3 dhjetor 2008)

¹⁶⁸ Dokumenti i Shkurtër Informues mbi Zyrën e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve, korrik 2008, Prishtinë.